

Raport Studimor
Performanca e Shërbimeve Publike
të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
2020

Nëntor 2021

Raporti u përgatit nga:

Mirsa Titka, Lindita Oshafi, Monika Brahim

Shoqata Për Autonominë Vendore (SHAV)

Adelina Farrici, Alisa Limaj

Me kontributin e Ornela Shapo dhe Denalda Kuzumi

Mirënjohje

Ky studim u realizua me mbështetjen e projektit Bashki të Forta (BtF), Helvetas, një projekt i financuar nga SDC. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetem e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Tabela e përmbajtjes

| | |
|---|------------|
| 1. Hyrje | 5 |
| 1.1 Përmbledhje ekzekutive | 6 |
| 2. Metodologjia | 17 |
| 3. Rezultatet e performancës në ofrimin e funksioneve / shërbimeve | 20 |
| 3.1 Menaxhim dhe Administrim | 20 |
| 3.2 Gjendja Civile | 26 |
| 3.3 Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm | 27 |
| 3.4 Shërbimet e Policisë Vendore | 29 |
| 3.5 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile | 32 |
| 3.6 Marrëdhëniet në Komunitet | 37 |
| 3.7 Mbështetja për Zhvillim Ekonomik | 38 |
| 3.8 Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi dhe Inspektimi | 44 |
| 3.9 Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve | 45 |
| 3.10 Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | 49 |
| 3.11 Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 55 |
| 3.12 Ndërtimi, Rehabilitimi dhe Mirëmbajtja e Rrugëve Lokale dhe Transporti Publik | 62 |
| 3.13 Menaxhimi i Mbetjeve | 68 |
| 3.14 Planifikimi Urban | 75 |
| 3.15 Administrimi dhe Menaxhimi i Parqeve dhe Hapësirave Publike (shërbime publike vendore) | 79 |
| 3.16 Furnizimi me Ujë | 80 |
| 3.17 Ndriçimi i Hapësirave Publike | 85 |
| 3.18 Arsimi parauniversitar | 90 |
| 3.19 Funksionet e Bashkive në fushën e shërbimeve sociale | 100 |
| 3.20 Shërbimi i punësimit | 110 |
| 3.21 Strehimi Social | 113 |
| 3.22 Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese | 116 |
| 3.23 Programi Çështje Financiare dhe Fiskale | 121 |
| 3.24 Analiza buxhetore për shërbime të tjera | 126 |
| 4. Gjetje dhe Rekomandime të Përgjithshme | 128 |
| 5. Bibliografi dhe raporte burimore | 131 |

Shkurtime

| | |
|---------------|--|
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| AKPA | Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi |
| AKM | Agjencia Kombëtare e Mjedisit |
| AK | Aftësi e Kufizuar |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BtF | Bashki të Forta |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| IPF | Instrument i Planifikimit Financiar |
| KK | Këshilli Konsultativ për vetë-Qeverisjen Vendore |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KE | Komisioni Evropian |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit |
| MFP | Menaxhimi i Financave Publike |
| MFP | Menaxhimi i Financave Publike |
| MIM | Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve |
| NJA | Njësi Administrative |
| NjQV | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore |
| OSHC | Organizata të Shoqërisë Civile |
| PAK | Person me Aftësi të Kufizuara |
| PB | Program Buxheti |
| PBA | Programi Buxhetor Afatmesëm |
| PFA | Planifikimi Financiar Afatmesëm |
| PPV | Plani i Përgjithshëm Vendor |
| PKVIRE | Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2016-2020 |
| PKVEE | Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë |
| PKMIM | Plan Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve |
| PVMIM | Plan Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve |
| QQ | Qeveria Qendrore |
| QV | Qeveria Vendore |
| RAT | Reforma Administrative Territoriale |
| RM | Raport Monitorimi |
| RMZB | Raport i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit |
| SNKDQV | Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020, PV 2020-2022 |
| SNRAP | Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020, PV 2019-2022 |
| SZHAP | Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026 |
| SKEE | Strategjia Kombëtare për Efiçencën Energjisë |
| SKPA | Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2019-2022 |
| SHAV | Shoqata për Autonominë Vendore |
| SHBSH | Shoqata e Bashkive të Shqipërisë |

1. Hyrje

Shqipëria ka bërë progress në zbatimin e reformës së decentralizimit dhe vetëqeverisjes vendore (SKNDQV), 2015-2020 dhe PV 2020-2022 dhe realizimin e një sërë masash në drejtimet strategjike: (i) Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, (ii) Forcimi i financave vendore, (iii) Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor, dhe (iv) Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin vendor. Një Plan Veprimi i zgjeruar i SKNDQV 2020-2022¹ ofron afate të rishikuara për disa masa prioritare /aktivitete me qëllim arritjen e rezultateve të synuara dhe objektivave strategjike. Transferimi i gjashtë funksioneve në vitin 2015 nga qeverisja qendrore tek bashkitë zgjeroi shkallën e decentralizimit dhe mundësitë e përgjegjësitë e NJVV për një rritje cilësore të shërbimeve më pranë qytetarit.

Ministria e Brendshme hartoi Raportin e tretë të Monitorimit të zbatimit të SKNDQV (Qershor 2021)², i cili evidenton progresin në zbatimin e aktiviteteve/masave sipas objektivave strategjike dhe objektivave specifike, si dhe problemet e mungesën e progresit për masa/aktivitete të tjera. Ndër të tjera, progres është arritur në drejtim të fuqizimit të rolit të Këshillit Konsultativ si forum dialogu midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, gjithsej 37 projekt akte janë diskutuar dhe konsultuar në KK gjatë vitit 2020. Gjithashtu, përmirësim është bërë për fuqizimin e rolit të Këshillit Bashkiak (KB) dhe rregullimit të funksionimit të brendshëm të tij në disa pjesë të bashkive, ristrukturimit të Drejtorisë së Çështjeve Vendore në Ministrinë e Brendshme dhe AMVV për tju përgjigjur më mirë sfidave të zbatimit të reformës së decentralizimit dhe qeverisjes vendore, përmirësimit të procesit të planifikimit të programeve strategjike (48 bashki kanë aprovuar Planin e Zhvillimit të Territorit), harmonizimit ligjor për funksionet e NJVV³ bazuar në studimin mbi matricën e kompetencave të vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, ngritjes së zyrave me një ndalesë në pjesën më të madhe të bashkive (59 bashki kanë zyra me një ndalesë/të paktën 70 shërbime ofrohen nga pjesa më e madhe e ZNjN (OSSH), përmirësimit të menaxhimit të disa funksioneve/shërbimeve dhe rezultate të tjera të rëndësishme⁴.

Komisioni Evropian në raportin vjetor për Shqipërinë (2020) ka cituar që reforma territoriale administrative duhet të konsolidohet më tej si pjesë e agjendës së zgjeruar të decentralizimit. Kjo është e nevojshme për të garantuar autonomi fiskale vendore dhe për ofrimin me cilësi dhe standarte të shërbimeve publike.

Lidhur me forcimin e Financave Vendore dhe autonomisë fiskale, buxheti i vetëqeverisjes vendore ishte 3.28% i PBB në vitin 2020 (nga 4% vlera e planifikuar). Përmirësim është arritur në realizimin e reformave të drejtuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe me mbështetjen e donatorëve për të përmirësuar kuadrin rregullator për burimet e financimit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, rritjen e autonomisë fiskale dhe të kapaciteteve të përgjithshme në fushën e menaxhimit financiar për konsolidimin e procesit të buxhetimit (hartimi i PBA në të gjitha NJVV sipas formatit të kërkuar), unifikimit të klasifikimit të shpenzimeve buxhetore me sistemin COFOG dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit. Ky i fundit është unifikuar me miratimin e Udhëzimit për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të NJVV (Udhëzim nr. 22/2018 i MFE⁵). Rreth 36 bashki kanë hartuar Raportin e Performancës të zbatimit të buxhetit për vitin 2020.

MFE ka hartuar Raportin e Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel bashkie për vitin 2019

- 1 Vendim nr. 783, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020"
- 2 Dy raportet e para të monitorimit, 2016 dhe 2017 janë hartuar me mbështetje të programit dldp, Helvetas, SDC
- 3 Urdhri i Kryeministrit nr.101, datë 03.07.2019 "Për miratimin e akteve nënligjore nga Ministrinë e Linjës, sipas fushës së përgjegjësisë së shtetit, për funksionet e deleguara të Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore"
- 4 Për më shumë shiko Raportin e Monitorimit të zbatimit të SKNDQV (2021)
- 5 Udhëzimi standard nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" (mbështetur nga projekti "Bashki të Forta")

dhe 2018, ndërsa raporti për vitin 2020 është në proces hartimi. Metodologjia e raportit bazohet në vlerësimin sasior dhe cilësor të tre dimensioneve dhe kriterëve për dimension, si: (i) kërkesat e përputhshmërisë (12 kritere vlerësimi), (ii) Përdorimi i raportit nga këshilli bashkiak dhe komuniteti (2 kritere vlerësimi), dhe (iii) renditja e bashkive mbi bazën e pikëzimit (kampioni 61 bashki).⁶

Shoqata për Autonominë Vendore (SHAV), me mbështetje të projektit Bashki të Forta (BtF), për të plotësuar kuadrin e zbatimit të reformës së decentralizimit dhe qeverisjes vendore për vitin 2020 ndërmorri iniciativën e hartimit të një raporti studimor (sintezë) mbi performancën e bashkive në zbatim të buxhetit për vitin 2020 për programet buxhetore të NJVV. Studimi u krye në periudhën Korrik – Nëntor 2021.

Qëllimi i raportit është:

- Të ofrojë një model raportimi koherent lidhur me përdorimin e fondeve publike nga NJVV në pikëpamje të realizimit të shërbimeve dhe të lidhur ngushtë me raportimin mbi bazën e rezultateve të evidentuara nëpërmjet treguesve financiarë dhe jo financiarë në nivel produkti dhe impakti mbi bazën e rezultateve të sondazhit (për më shumë, shiko seksionin 3);
- Të fotografojë ofrimin e shërbimit në nivel vendor gjatë vitit 2020, në bazë të treguesve të raportuar dhe të kontribojë në përpjekjet e përmirësimit të metodologjisë së analizës krahasuese (benchmark) ndërmjet bashkive dhe përkundrejt kërkesave të legjislacionit sektorial dhe/ose kërkesave të përcaktuara në dokumentat e politikave në ofrimin e funksioneve / shërbimeve;
- Të identifikojë mangësitë e raportimit nga NJVV dhe të japë rekomandime për përmirësim lidhur me raportimin e rradhës të performancës së zbatimit të buxhetit;
- Të kontribuojë në informimin dhe dialogun me organet drejtuese të bashkive dhe institucionet qendrore (MB dhe AMVV, MFE, ministritë e linjës) me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit të NJVV lidhur me zbatimin e buxhetit bashkiak bazuar në rezultate (performancë) dhe në zbatim të kërkesave ligjore.

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Menaxhimi, Planifikimi dhe Administrimi

Progres është bërë gjatë vitit 2020 në plotësimin e kuadrit ligjor për përdorimin e platformës së bashkëpunimit “administrata.al” dhe për përmirësimin e ndërveprimit midis institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe unifikimin e praktikave administrative edhe nga NJVV7. Për bashkitë ka qënë në përdorim Manuali i delegimit të kompetencave (2020) dhe Manuali Praktik për zbatimin e Legjislacionit të Shërbimit civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore8. Synim i politikës, për periudhën 2021-2022, është shtrirja e sistemit të menaxhimit informacionit për Burimet Njerëzore (HRMIS) në njësitë e vetëqeverisjes vendore (në vitin 2020, HRMIS ka patur një shkallë përdorimi nga rreth 56% e bashkive9).

Në vitin 2020, më shumë nëpunës vendor kanë marrë trajnime në krahasim me vitin 2019. Norma mesatare e punonjësve të trajnuar ka qënë 21% e numrit total të punonjësve ose +5 p.p. krahasuar me vitin 2019. Më pak largime të punonjësve vendorë janë raportuar për vitin 2020 kundrejt 2019, me normë mesatare të largimeve 10% (ose – 1 p.p. krahasuar me vitin 2019). Gjithashtu, më pak masa disiplinore janë marrë nga autoritetet vendore në vitin 2020 (norma mesatare 12%) krahasuar me 42% në vitin 2019.

6 Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel bashkie (MFE, BtF/Helvetas/SDC Mars 2021)

7 Vendim Nr.833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”

8 Burim: DAP; <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhëzime-manuale/446-manual-praktik-mbi-zbatimin-e-legjislacionit-të-shërbimit-civil-dhe-menaxhimit-të-burimeve-njerëzore>

9 Draft Raport mbi performancën e bashkive në procesin e integritet evropian (BpE, 2021)

Rezultatet e sondazhit me qytetarët evidentojnë se 33% e të anketuarve (ose 2,985 persona) janë të kënaqur me performancën e shërbimit 'planifikimi dhe administrimi', 44% e të anketuarve (ose 4,121 persona), shprehet dakort lidhur me shpenzimet e kryera nga ana e bashkive për vitin 2020, dhe vetëm 20% e të anketuarve (ose 1,831 persona) shprehet dakort për rritjen e shpenzimeve nga ana e bashkive lidhur me këtë program.

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në lidhje me zbatimin e reformës në administratën publike; Zbatimi i ligjit për Nëpunësin Civil mbetet i paplotë në nivelin vendor¹⁰.

Marrëdhëniet në Komunitet

Kuadri ligjor është i mirëzhvilluar lidhur me konsultimin me qytetarët dhe grupet e interesit në procesin e hartimit të buxhetit, si dhe sigurimin e transparencës për financat vendore dhe vendimmarrjen e organeve të NJVV¹¹. Progres është bërë në vitin 2020 nga NJVV për organizimin online të konsultimeve me qytetarët. Disa bashki kanë vendosur në funksionim platformën digjitale 'e-pjesëmarrja' për konsultimin e buxhetit vendor dhe PBA, si dhe për takimet e Këshillit Bashkiak (online). Në vitin 2020, më shumë vendime janë marrë nga bashkitë pas konsultimeve publike – gjithsej 645 vendime ose mesatarisht 129 vendime më shumë në 2020 kundrejt 2019.

Shkalla e publikimit të akteve të organeve vendimmarrëse në 2020 rezulton më e lartë krahasuar me periudhën 2017-2019. Në vitin 2020, norma mesatare ka qënë 70% ose +6 p.p krahasuar me 2019¹².

Ndonëse, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe të buxhetimit në nivel vendor ekziston, konsultimi publik ka nevojë për përmirësim cilësor¹³.

Rekomandohet, të shtohen tregues të tjerë për performancën e programit buxhetor vendor të ngritura në workshop-et me bashkitë të zhvilluar gjatë muajit Nëntor 2021, si: (i) "numri i projekteve të publikuara në rregjistrin elektronik/façen zyrtare të bashkisë në raport me numrin total të akteve të miratuara nga bashkia në vitin e raportimit, dhe (ii) numri i rekomandimeve të qytetarëve të reflektuara në dokumentin e buxhetit vendor / PBA dhe vendimmarrjen vendore.

Funksionet e transferuara në NJVV (2016)

Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi

Progres është bërë në periudhën 2019-2020, për plotësimin e bazës ligjore në vijim të miratimit të ligjit 152/2015 "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi".

Më shumë stacione të MZSH për bashkitë, si dhe burime njerëzore dhe paisje e mjete për ofrimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në 2020, në krahasim me vitin 2016, vit në të cilin efektivisht bashkitë ishin përgjegjëse për menaxhimin e këtij funksioni¹⁴.

10 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)


11 Ligji 139/2015 dhe Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

12 Draft Raporti i Performancës së Bashkive në procesin IE (BpE, 2021)

13 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)

14 Urdhër i Kryeministrit nr.127, datë 16.09.2015 "Mbi masat për decentralizimin e funksioneve të reja"

Punonjës dhe asete për MBZSH, 2016 – 2020



Në 2020, janë raportuar rreth 93 raste më shumë të menaxhuara për shuarjen e zjarrit në krahasim me vitin 2019. Bashkitë ofrojnë mbulim të plotë të territorit të tyre me SHMZSH. Performanca e shërbimit në drejtim të dimensionit 'Koha e daljes nga stacioni të mjeteve' është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2015-2016. Shpenzimet e programit janë rritur me 10% krahasuar me vitin e kaluar, dhe mesatarisht, zënë 4% të shpenzimeve totale të bashkive. Rezultatet e sondazhit kanë evidentuar se rreth 50% (1,684 persona) janë dakord me nivelin e financimit të programit "Mbrojtja nga zjarri" nga ana e bashkive, 33% (1,130 persona) kërkojnë rritjen e shpenzimeve për këtë program

Administrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Në nivel kombëtar, në periudhën 2020-2021, investimi në ujitje është realizuar nëpërmjet 67 projekteve, gjithsej 3.6 miliard lekë; 59 projekte i përkasin bashkive, me impakt – 10,000 ha tokë më infrastrukturë ujitëse të përmirësuar, ndërsa për vitin 2021 parashikohet një përmirësim në 8,000 ha. Në mbrojtje nga përmbytjet, është ndërhyrë me mbështetjen e 15 projekteve¹⁵ (2020-2021), në segmentet më të rrezikuara në lumenjtë Vjosë, Seman, Drinos, Drin i Zi, Shkumbin, Osum.¹⁶

Në vitin 2020, **shkalla e mirëmbajtjes të rrjetit kullues** të bashkive kundrejt totalit të rrjetit që i përket bashkisë ndryshon midis bashkive të kampionit, por mesatarisht ka qënë në nivelin **31%** krahasuar me 33% në vitin 2019, ndërsa **norma mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit vaditës** ka qënë **36%** në 2020 kundrejt 37% në 2019. *Duke krahasuar shërbimin para RAT, konkludohet se bashkitë kanë rritur nga vit në vit performancën lidhur me administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit krahasuar me vitin 2015 (11% shkalla mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit të kullimit dhe 10% e rrjetit të vaditjes¹⁷).*


Për shkak të situatës së jashëtzakonshme të vitit 2020 për arsye të Covid-19, bashkitë kanë ulur shpenzimet për disa programe buxhetore (shërbime). Rezulton se, shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 11% krahasuar me v.2019, të cilat zënë mesatarisht 3% të shpenzimeve totale të bashkisë. Në analizën buxhetore nuk është përfshirë transferta e kushtëzuar.

15 Zonat ku janë realizuar ndërhyrjet i përkasin bashkive Dibër, Durrës, Lushnje, Gjirokastrë, Mallakastër, Fier, Tepelen, Berat, Elbasan dhe Kurbin

16 Burim: Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020 (MBZHR)

17 Raport mbi Performancën e Funkcioneve të reja të transferuara në NJVV (O.Shapo, 2018, dldl, Helvetas (SDC))

Rrjet kullues i mirëmbajtur (ndryshimi 2020/2019)




Rreth 47% e të anketuarve (ose 1,477 persona) shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për shërbimin e administrimit të ujitjes dhe kullimit, ndërsa 41% e tyre (1,285 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimeve. Rreth 37% e të anketuarve (1,120 persona) shprehen ‘të kënaqur’ me performancën e shërbimit, ndërsa 26% (796 persona) e vlerësojnë ‘jo mirë performancën’, dhe 37% ‘neutralë’. Referuar treguesit kosto-efiçencë për mirëmbajtje të 1 km rrjet vaditës dhe kullimi, disa bashki kanë shpenzuar 400 mijë lek/km kanal të pastruar, ndërsa rreth 50% e bashkive kanë patur nën 100 mijë lek/km, krahasuar me 136 mijë lekë në vitin 2017¹⁸.

Rekomandohet nga MBZHR që Drejtoritë Rajonale të U&K dhe bashkitë, në bashkëpunim me OPU-të, të hartojnë buxhetin vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të përshkruara në Planin e Shërbimit të Ujitjes, i cili hartohet sipas një performance standarde, e cila garanton funksionimin normal të skemës ujitëse. Çdo skemë ujitëse duhet të menaxhohet si një njësi e pandarë financiare, e cila ka koston e saj dhe buxhetin e saj, në varësi të specifikave të veta. Pritshmëria është që për të gjitha skemat ujitëse të hartohen dhe zbatohen buxhete “bazuar mbi nevoja” ose buxhete “bazuar në performancë”¹⁹.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore

NJVV kanë performuar më mirë në drejtim të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor në 2020 krahasuar me 2016 (viti i parë i ushtrimit të funksionit të transferuar). Progres është bërë gjatë vitit 2020, për ndërtimin e rrugëve të reja nga NJVV dhe përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve.

Norma e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor (2020/2016)



Rrjeti rrugor i ndërtuar nga NJVV gjatë 2020 në nivelin 159 km rrugë urbane/ rurale në krahasim me vitin 2019, ndërsa **norma mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor ekzistues ka qënë 50.4%** në vitin 2020, krahasuar me 32% në vitin 2016 (viti i parë mbas transferimit të funksionit në NJVV).

Është përmirësuar rrjeti rrugor sekondar dhe tercial kundrejt standarteve - **Norma mesatare e përmbushjes së standarteve të rrugëve të rrjetit urban ka qënë 59%** në 2020 ose + 6p.p. krahasuar me vitin 2019, ndërsa

norma mesatare e përputhshmërisë të rrjetit rrugor rural (të fshatrave) me standartet ka qënë 35%, që evidenton përmirësim kundrejt vitit 2019 (32.2%)²⁰.

18 Raport mbi Performancën e Funksioneve të reja të transferuara në NJVV (O.Shapo, 2018, dldl, Helvetas (SDC))

19 Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit, 2019-2031

20 Draft raporti i Performancës së Bashkive në procesin e IE (BpE 2, projekt IPA, 2021)

Numri i linjave interurbane për rreth 78% të bashkive të kampionit ka qënë në të njëjtin nivel kundrejt 2019.


Shpenzimet e programit për mirëmbajtjen e rrugëve zënë 12% të totalit të shpenzimeve të bashkive (rezulton me rritje krahasuar me 8.56%²¹ të raportuar nga bashkitë). Ka Njësi Administrative që miratojnë linja interurbane të reja por numri i subjekteve që licensohen është më i vogël se numri i linjave, si rrjedhim disa zona të territorit nuk mbulohen me shërbimin e transportit publik ndërrurban.

Rreth 56% e të anketuarve (2,487 persona) shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa 33% e tyre (1,441 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit nga ana e bashkisë për këtë shërbim.

Rekomandohet përmirësimi i të dhënave financiare për të mundësuar analizën kosto-eficencë të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor sekondar dhe tercial të administruar nga bashkitë.

Pyjet

Progres është bërë më hartimin dhe miratimin e ligjit 57/2020 “Mbi pyjet”. Në 2020, disa bashki kanë patur më shumë burime njerëzore për administrimin e funksionit të menaxhimit të pyjeve. Ndonëse numri i punonjësve për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve nga NJVV, mesatarisht ka qënë 1.9 punonjës për 1 ha pyje (më i lartë kundrejt vitit 2019), po ashtu krahasuar me nivelin e vitit 2016 (0.39 punonjës / 1000 m² pyje)²², përsëri 69% e bashkive të kampionit (20 nga 29 bashki) kanë numër më të vogël të punonjësve specialistë për pyjet kundrejt kërkesave të ligjit.



Numri i inspektimeve për ha është rritur nga 13.8 mesatarisht në 2019 në 14.58 inspektime/ha të realizuara nga bashkitë gjatë vitit 2020, ndërsa shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 18% krahasuar me v.2019, të cilat zënë rreth 1% të totalit të buxhetit të bashkisë.

Sfida në të ardhmen është krijimi i Regjistrimit Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP) dhe inventarizimi kombëtar i pyjeve (grumbullimi dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar brenda ciklit 8 vjeçar), dhe hartimi i planit vendor të mbarështimit të pyjeve nga bashkitë në harmoni me dokumentin e politikave/dhe Programin Kombëtar të Pyjeve.

Arsimi parashkollor

Progresi është bërë në drejtim të regjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor dhe uljen e numrit të fëmijëve për grup (shkalla e regjistrimit ka qënë 81% në vitin shkollor 2019-

21 Draft raporti i Performancës së Bashkive në procesin e IE (BpE 2, projekt IPA, 2021)

22 Raport mbi Performancën e Bashkive në administrimin e funksioneve të transferuara (dldp, O.Shapo, 2018)

2020 kundrejt 80% të raportuar për 2018-2019 dhe numri i fëmijëve për grup është ulur në 12 nga 15 që ka qënë një vit shkollor të mëparshëm).

Numri i nxënësve për klasë në sistemin e arsimit bazë dhe në arsimin e mesëm të përgjithshëm (për zonat urbane dhe rurale), për bashkitë raportuese, rezultojnë të jetë më i vogël se synimi i politikës që është jo më shumë se 28-30 nxënës për klasë në zonat urbane (shkak mund të jetë migracioni i popullsisë dhe ndërtimi i shkollave të reja).

Meqënëse bashkitë, në fushën e arsimit parauniversitar kanë funksion administrimin dhe mirëmbajtjen e godinave të infrastrukturës shkollore, duhet të konsidererohen disa tregues që evidentojnë performancën e bashkive në përmirësimin e godinave përkundrejt standarteve të tyre, duke bërë dallimin kopsht /shkolla në zonat urbane dhe rurale. Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit të arsimit bazë dhe parashkollor, mesatarisht 73%, ndërsa shpenzimet e tjera korrente dhe investimet përkatësisht 13% dhe 14% të shpenzimeve të programit.

Funksione të tjera të NJVV

Policia bashkiake

Progres është bërë në hartimin e një projektligji “Për Policinë Bashkiake”, i cili ka filluar në 2019 por vijon procesi i rishikimit nga MB dhe AMVV (projektligji parashikohet të miratohet në 2021)²³.

Në vitin 2020, Policia bashkiake ka zgjidhur një numër rastesh më të larta të konflikteve - *norma mesatare e konflikteve të zgjidhura kundrejt rasteve të ardhura në policinë bashkiake nga qytetarët ka qënë 173%*, krahasuar me 103% për vitin 2019. Mesatarisht, 51 raste janë adresuar nga qytetarët në policinë bashkiake gjatë vitit 2020, kundrejt 89 rasteve, mesatarisht, të rregjistruara në vitin 2019. Rreth 16% ka qënë norma mesatare e punonjësve të policisë bashkiake me status oficeri (ose – 5 p.p. krahasuar me 2019).

Shpenzimet e programit janë rritur me 14% krahasuar me vitin 2019, dhe përbëjnë rreth 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë. Për këtë shërbim, rekomandohet të shtohen dy tregues të tjerë të performancës: (i) Raporti mes punonjësve të policisë dhe numrit të banorëve të bashkisë²⁴, (ii) Hartimi dhe miratimi i Planeve vendore të komunikimit për sigurinë në komunitet²⁵.

Mbështetja për Zhvillimin e Turizmit

Disa masa të planit të veprimit 2020-2022 të SNDQV, lidhur me forcimin e funksionit të zhvillimit ekonomik vendor²⁶, si hartimi i ndryshimeve ligjore sektoriale që fuqizojnë rolin e NJVV për investimet strategjike, partneritetin publik-privat, menaxhimin e aseteve vendore dhe lehtësimin e procedurave të menaxhimit të pronës publike nga bashkia, për shkak të natyrës komplekse dhe nevojës për studime të thelluara sektoriale janë zhvendosur në periudhën 2021-2022. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) ka miratuar të gjitha kërkesat të ardhura nga bashkitë në 2020²⁷.

Performanca e shërbimeve të QKB në ofrimin e dokumentave të kërkuara nga qytetarët dhe bizneset është në një nivel pothuajse të njëjtë me vitin 2019 (ndryshimi mesatar në kohë për lëshimin e një dokumenti nga QKB është 1 orë)²⁸.

23 Burim: Raporti i Monitorimit SNDQV (2021), C1.9

24 Strategjia e Rendit Publik 2015–2020, Obj. III/1.2: Formim dhe kualifikim i punonjësve të policisë. Punonjës të certifikuar

25 Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në komunitet 2021-2026, Obj.1: Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet

26 PV SNDQV (C2.1)

27 Raporti i Monitorimit SNDQV PV 2020-2022 (MB, 2021)

28 Për treguesin “Të ardhurat nga taksa e qëndrimit në hotel kundrejt të ardhurave vendore” nuk ka patur të dhëna të mjaftueshme në raportet e performancës

Në 2020, në fushën e turizmit, ka patur ulje të numrit të vizitorëve rezidentë dhe jo rezidentë dhe ulje të numrit të qëndrimeve në hotele dhe në struktura të tjera akomoduese (43,746 turistë më pak kundrejt vitit 2019) nga bashkitë e kampionit. Shpenzimet e programit për zhvillimin e turizmit janë ulur mesatarisht me 5% krahasuar me v.2019, të cilat zënë 0.2% të totalit të shpenzimeve të bashkisë.

Për qëllim të analizës së performancës për zhvillimin ekonomik, mund të konsiderohet shtimi i treguesve të tjerë në raportet e performancës, si numri i shërbimeve të bashkisë që mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të reja (të krijuara në vitin e raportimit), dhe numri total i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që operojnë në territorin e bashkisë²⁹. Kryesisht bashkitë e zonave verilindje e juglindje kanë nevojë për personel këshillues për subjektet.

Shërbimi i Tregjeve

Në vitin 2020, rreth 84% e bashkive nuk kanë patur ndryshime në numrin e tregjeve publike krahasuar me vitin 2019. Bashki të tjera kanë raportuar shtim dhe mbyllje të tregjeve në 2020 kundrejt 2019.

Sfidë për bashkitë është kryerja e investimeve për riskonstruksionin e tregjeve për të siguruar përputhshmëri me standartet higjeno-sanitare, dhe çertifikimi i tregjeve³⁰.

Rekomandohet të shtohet treguesi: (i) numri i njësive në tregje/1000 banorë, (ii) numri i tregjeve të aprovuara për t'u ndërtuar në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (PZHT).

Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përafrimi me legjislacionin e BE, përfundimi i reformës të sistemit të këshillimit në bujqësi janë disa nga synimet afatmesme të politikave në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. Progres është bërë gjatë 2020 për përmirësimin e bazës ligjore për masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (VKM dhe udhëzimi), për disbursimin e fondeve për 5496 përfitues nga të cilët 18% gra, si dhe për zhvillimin e Sistemit të Informacionit për Tokën (LIS) dhe integrimin në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) në disa NJA në bashkitë Durrës, Këlcyrë, Përmet, Lezhë, Malësi e Madhe dhe Tiranë (Kavajë/Golem). Ka vijuar puna për *digjitalizimin e regjistrit të tokës bujqësore* gjatë 2020 në bashkinë Bulqizë (NJA Gjoricë), Klos (NJA Suç) dhe Bashkinë Rrëshen (NJA Selitë dhe Kthellë).

Në vitin 2020, janë lëshuar më pak çertifikata të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP) krahasuar me vitin 2019. Shkalla mesatare e numrit kumulativ të titujve në fund të 2020 ka qënë 41%³¹ (n=53) nga 35% që ka qënë në vitin 2019.

Me miratimin e ligjit nr. 20/2020³² "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", i cili i kaloi kompetencat për trajtimin e AMTP-ve, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës pritet që të përshpejtohet dhe të përfundojë përditësimi i inventarëve të pronave të paluajtshme të pushtetit qendror dhe atyre të transferuara njësive të vetëqeverisjes vendore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe përmbyllja e regjistrimit të AMTP.

Për *sigurinë ushqimore*, strukturat e bashkive bashkëpunojnë me strukturat e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve (ARSHVMB) dhe 12 drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të

29 Projekti Bashkitë për Evropë (BpE (BE/IPA, 2021)

30 Draft Raport mbi Performancën e Bashkive në procesin e IE (BpE, 2021)

31 Projekti Bashkitë për Evropë (BpE (BE/IPA, 2021)


32 "Aktet ligjore e nënligjore për pronësinë mbi tokën bujqësore" janë ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore", i ndryshuar; ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar; ligji nr. 57/2012, "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore"; ligji nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, që kanë rregulluar marrëdhëniet juridike të ndarjes apo dhënies në përdorim të tokës bujqësore pas vitit 1991.

Ushqimit (AKU) për të siguruar zbatimin e duhur të masave për sigurinë ushqimore të produkteve. Në 2020, në nivel kombëtar, janë kryer rreth 164,260 kontrolle dhe monitorime në fermat e kafshëve të gjalla dhe 93,701 inspektime nga Drejtoritë Rajonale të AKU në të gjithë territorin e vendit³³.

Menaxhimi i mbetjeve

Shkalla mesatare e mbulimit të popullatës nga bashkitë e kampionit ka qënë **67%** në vitin 2020 (rritje me 1 p.p krahasuar me vitin 2019), kundrejt standartit **90%** të mbulimit të popullatës (synim politikës), ndërsa shkalla mesatare e mbulimit të territorit në vitin 2020 ka qënë 32%³⁴.

Në vitin 2020, nuk ka patur ndryshim të performancës së shërbimit përsa i përket frekuencës ditore në javë të grumbullimit të mbetjeve, por ka patur rritje të sasisë së grumbulluar dhe transportuar në 2020 kundrejt vitit 2019.



Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 7% krahasuar me vitin 2019 dhe përbëjnë mesatarisht 6% të shpenzimeve totalë të bashkisë. Bashkitë me shpenzime me të larta të programit ndaj totalit janë bashkitë Durrës (16%) dhe Himarë (18%). Rezultatet e sondazhit me qytetarët, evidentojnë se 35% (911 persona) shprehen ‘të pakënaqur’ me performancën e shërbimit, ndërsa 31% (825 persona) ‘të kënaqur’ me shërbimin e ofruar.

Rekomandohet rishikimi i planeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, bazuar në objektivat e PKMIM deri në vitin 2025 nga bashkitë. Për të mundësuar një analizë më të plotë të shërbimit, është e nevojshme që bashkitë të ofrojnë të dhëna të tjera, si (i) të ardhura të mbledhura nga tarifa kundrejt kosto totale të shërbimit (mbullimi i kosto të shërbimit), (ii) tarifa e mbledhur kundrejt shumës së planifikuar / faturimit (në %), dhe kosto totale e programit të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të bashkisë (nga të ardhurat e veta + fonde të tjera).

Furnizimi me ujë

Progres është bërë në hartimin e (i) draftit final të projekt-ligjit për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimin e Ujrave të Ndotura Urbane, (ii) draft Strategjia Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030, (iii) kontratat e performancës, programi kombëtar i trajnimit & çertifikimi; (iv) ngritjen e platformës për regjistrimin dhe menaxhimin online, në kohë reale të asetëve të sha UK, e cila po pilotohet në 12 bashki, përkatësisht Bashkitë Sarandë, Shkodër, Cërrik, Peqin, Vlorë, Berat, Kavajë, Durrës, Himarë, Elbasan, Përmet dhe Gramsh.

Mbulimi i popullatës me shërbimin e furnizimit me ujë ka qënë mesatarisht në nivelin **59%** në vitin 2020, (ose 11 p.p më i ulët) sipas të dhënave nga RP³⁵. Mesatarisht, bashkitë e kampionit kanë ofruar një shërbim me ujë për

33 Raporti vjetor (MBZHR, 2021)

34 Nuk ka të dhëna për vitin 2019

35 Koment: Bashkitë që kanë raportuar ulje të mbulimit të popullatës në 2020 kundrejt 2019 kanë qënë bashkia Elbasan (-9 p.p.), Bashkia Cërrik (-29 p.p.)

qytetarët për **16.7 orë në ditë** ose +0,37 orë në 2020 kundrejt 2019 (në nivel kombëtar, shërbimi është mbi standartin por nën standartin e synuar për zonat urbane³⁶). Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 42% krahasuar me vitin 2019, të cilat zënë 2% ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë.

Duke ju referuar të dhënave të performancës së sektorit nga ERRU për vitin 2020, **kohëzgjatja e furnizimit me ujë në nivel kombëtar** ka qënë mesatarisht **13.79 orë/ditë** në 2020 nga 13.3 orë/ditë në vitin 2019 (përkeqësim i lehtë), ndërsa **mbulimi i popullatës me FU** ka qënë **75.8%** në 2020 nga 76.8% në 2019. **Mbulimi me kanalizime** ka qënë në nivelin **50.8%** në 2020 nga 51% në 2019. Përkeqësimi i performancës për FU në 2020 vjen edhe si pasojë e pandemisë dhe vazhdimësisë së gjendjes nga tërmeti i vitit 2019. Gjendja në sektor, në krahasim me vitin 2019, paraqet një përkeqësim në drejtim të treguesve të ujit pa të ardhura, mbulimit të kostove direkte dhe normës së arkëtimit³⁷.

Sfidë mbetet përmirësimi i performancës së shërbimit, mbulimi i kostove dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe asetëve të sektorit, i cili nuk ka të integruar ujësjellësat në fshatra në sistemin e Sha³⁸.

Shërbimet në fushën sociale

Në 2020, progres është arritur në hartimin e standarteve të shërbimit të emergjencës së sigurt, standartet për ri-integrimin e viktimave të trafikimit, si dhe të shërbimit lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Janë ofruar trajnime për administratorët shoqërorë dhe stafin e strukturave përkatëse lidhur me Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore, mbi menaxhimin e rastit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në 2020, nga fondi 6%, më shumë familje në nevojë kanë përfituar mbështetje sociale nga bashkitë në krahasim me 2019. Gjithashtu është rritur numri i individëve të mbështetur më pagesën e aftësisë së kufizuar (2,887 persona më shumë kundrejt vitit 2019). Nga 28 institucione publike të kujdesit social, 17 prej tyre janë në varësi të pushtetit vendor. Në nivel kombëtar, në 2020, numri i personave të moshuar në IPSh ka qënë pak më i ulët kundrejt 2019.

Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale ka qënë në të njëjtin nivel me vitin 2019. Shpenzimet e programit për kujdesin social për familjet dhe fëmijët janë rritur mesatarisht me 28% krahasuar me v.2019, dhe që përbëjnë 2% të totalit të buxhetit të bashkisë. Shpenzimet e programit për invalidët dhe PAK zënë mesatarisht 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë. Rreth 53% e bashkive nuk kanë planifikuar fare buxhet për programin për PAK dhe invalidët.

Për *strehimin social*, Qeveria ka miratuar Deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Proçesin e Zgjerimit të BE (Deklarata e Poznanit), dhe ka filluar hartëzimi i shtëpive rome. Më shumë pagesa janë dhënë nga NJVV për përfituesit e programeve të strehimit social (për bonus qiraje) nga NJVV. Rreth 30% e përfituesve të projekteve kanë qënë familje të pakicave rome dhe egjiptiane. Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 0.3%, ndërsa shpenzimet e investimit zënë pjesën më të rëndësishme të programit, mesatarisht 67%.

Sfidë mbetet krijimi i fondit social nga bashkitë për ngritjen e qendrave të përkrahjes sociale, dhe plotësimi i standarteve (kërkesave ligjore për shërbimin) për administratorin social në NJA, rritjen e numrit të punonjësve sociale (ligj 121/2016³⁹), ngritjen e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave pranë çdo NJA dhe rritjen e numrit të punonjësve PMF në NJVV⁴⁰.

36 Furnizimi me Ujë, Nivel Kombëtar 15.1 (orë/ditë); Furnizimi me Ujë, Zona Urbane 18 (orë/ditë)

37 Burim: ERRU (Raporti Vjetor 2020)

38 Shoqata e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (SHUKALB) dhe ERRU (Raporti Vjetor 2020)

39 Një (1) punonjës social / 10,000 banorë

40 Një (1) punonjës për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve (PMF) për 3000 fëmijë (Ligj 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve")

Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm

Detyrimet e prapambetura të bashkive në fund të vitit 2020 ishin **6.9 miliard lekë** (ose 1.2 miliard lekë më pak krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2019). Norma mesatare e ndryshimit të stokut të bashkive ka qënë 26.8% në 2020 kundrejt normës mestare të ndryshimit me 27% në 2019. Rreth 14 bashki raportojnë se nuk kanë detyrime të prapambetura. Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 54.4%, kategoria “Të tjera” 17.3%, “Shërbime” 10.3%, dhe “Vendime Gjyqësore” 10%⁴¹.

Rekomandohet të përfshihet në analizën e performancës së shërbimit treguesi “*Shërbimi vjetor i borxhit*⁴² për huanë (interes plus principal) të marrë nuk tejkalon shumën 25% të bilancit primar” (diferencës midis totalit të të ardhurave nga burimet e veta dhe shpenzimeve korrente të bashkisë). Treguesi buron nga referenca me Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike, 2019-2022, ligj 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Ligj nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligj nr. 9869/2008 “Për huamarrjen vendore”.

Programi Çështje Financiare dhe Fiskale

Në vitin 2020, ka patur një ulje mesatare prej 16% të të ardhurave të veta të bashkive të studimit krahasuar me vitin 2019, e shpjeguar kjo me situatën e jashtëzakonshme të krijuar nga Covid-19. Me normë më lartë të rënies të të ardhurave të veta janë bashkia Lezhë (-57%), Kamëz dhe Skrapar (-37%), Kurbin (-36%), Fushë-Arrëz dhe Vau i Dejës (-32%), ndërsa me normën më lartë të rritjes janë Bashkitë Pukë (93%), Kukës (36%), Patos (33%).

Ndryshimi i të ardhurave vendore sipas bashkive (2020/2019)




Të ardhurat nga tarifat për bashkitë e kampionit përbëjnë **43% të të ardhurave të veta të bashkisë**, ndërsa shpenzimet e realizuara në vitin 2020 janë financiar nga burime qendrore, mesatarisht në masën 70%, dhe nga të ardhurat e veta në masën 30%.

41 Raporti i Financave Publike Vendore (MFE, 2021)

42 Është pagesa, që duhet kryer në çdo vit fiskal për principalin, interesat, zbritjet dhe pagesat e tjera, që rrjedhin nga huatë, përfshirë edhe shpenzimet e lidhura me të.

Tek 36 bashkitë e studimit, peshë të konsiderueshme ndaj totalit të shpenzimeve e zë programi Planifikim, menaxhim administrim (21.2%), arsimit bazë, i cili përfshin arsimin parashkollor (17.5%), rrjeti rrugor (11.9%) dhe shërbimet publike vendore (10.1%). Ndërsa nën 1% të totalit të shpenzimeve zë shumica e programeve, rreth 20 programe buxhetore ose 56% e programeve. Sipas klasifikimit ekonomik, mesatarisht pagesat e personelit zënë 51% të shpenzimeve totale për 36 bashkitë e studimit, shpenzimet korrente (operative) 29% dhe investimet 20%.



2. Metodologjia


Burim parësor i të dhënave janë raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit (RMZB) për vitin 2020, si instrument kryesor për të raportuar zbatimin e buxhetit bashkiak, sipas kërkesave ligjore. RMZB japin një përmbledhje të shpenzimeve të planifikuara përkundrejt atyre faktike, ku elementi kryesor që i shërben këtij raporti janë treguesit e performancës të raportuar në RMZB për të gjitha programet buxhetore/shërbimet publike të ofruara nga NJVV. Gjithsej, 58 bashki kanë prodhuar RMZB për vitin 2020. Gjithashtu, burim parësor i të dhënave janë Raportet e Performancës së Bashkive (gjithsej 36 raporte për vitin 2020), të cilat janë versione miqësore të RMZB, që bashkitë kanë hartuar në kuadër të raportimit mbi zbatimin e buxhetit bashkiak për vitin 2020 sipas kërkesave ligjore (neni 54, Ligji 68). Këto formate ndërthurin kërkesat ligjore për të dhëna financiare dhe jo-financiare në një format më të shkurtër dhe të thjeshtë që ndihmojnë informimin dhe transparencën për Këshillin Bashkiak, institucionet qendrore (MFE, MB, AMVV), qytetarët dhe aktorë të tjerë.

Burim dytësor i të dhënave janë raportet e monitorimi të zbatimit të politikave sektoriale dhe të reformave të ndryshme të ndërmarra për vitin 2020, si draft Raporti i Monitorimit të zbatimit të strategjisë të decentralizimit dhe qeverisjes vendore dhe planit të veprimit 2020-2022 (MB, 2021), Raport i Monitorimit (vjetor) të financave publike vendore (MFE, 2021), Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020), Raporti i Monitorimit për zbatimin e Reformës për Administratën Publike, të dhëna nga INSTAT dhe raporte të tjera të publikuara nga ministritë e linjës (për më shumë detaje, shiko aneksin 2), si dhe ligje dhe strategji sektoriale për të evidentuar kërkesat ligjore dhe kërkesat e politikave për tregues të shërbimeve publike për fushat / sektorët respektive.

Gjithashtu, raporti ofron të dhëna të sintetizuara mbi bazën e rezultateve të një sondazhi, i cili u organizua nga Këshillat Bashkiakë, në kuadër të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2022 - 2024. Sondazhi është një instrument konsultimi për projekt buxhetin, i hartuar me mbështetjen e projektit “Bashki të Forta”. Qëllimi i sondazhit ishte të ndihmonte këshillat bashkiakë në mbledhjen e mendimit/opinionit të qytetarëve në lidhje me pritshmëritë e tyre për shpenzimet buxhetore të bashkisë për shërbimet publike dhe performancën në ofrimin e këtyre shërbimeve. Mekanizmi i këtij sondazhi dhe rezultatet e përfuara prej tij janë përdorur në konsultimet dhe trajnimet me anëtarët e komisioneve të financës dhe buxhetit të këshillave bashkiakë (nëntor të vitit 2020). Gjithsej, në sondazh morrën pjesë 9442 qytetarë.

Metodologjia e përdorur për realizimin e sondazhit ishte një pyetësor online, duke targetuar banorët e secilës bashki. Pyetësori ka qënë lehtësisht i aksesueshëm nëpërmjet një linku, si dhe ka ofruar mundësinë e shkarkimit të Raportit të Performancës të bashkisë për vitin parardhës. Duke qënë se pyetësori bazohet në të dhënat e Raportit të Performancës, përfshirja e programeve të përmendura në pyetësor varion sipas bashkive. Pyetësori përmbante 12 pyetje gjithsej për katër çështje kryesore: (1) Dakortësinë / mosdakortësinë lidhur me shpenzimet e kryera për secilin program buxhetor; (2) Performancën e perceptuar nga qytetarët për programet; (3) Gadishmërinë e tyre për të paguar më shumë taksa; (4) Prioritetet e publikut lidhur me pyetjen mbi programet të cilat kanë patur nivele më të ulëta të financimit nga ana e bashkive (2% ose më pak kundrejt buxhetit të bashkisë).

Proçesi i mbledhjes së të dhënave dhe analiza e tyre ka filluar me rishikimin e raporteve të performancës (RP) dhe RMZB. Është kryer filtrimi dhe ndërtimi i databazës për të dhënat financiare dhe treguesit e performancës për vitin 2019 dhe vitin 2020, për shërbimet publike sipas programeve buxhetore të NJVV.



Përveç hulumtimit të RMZB dhe Raporteve të Performancës janë rishikuar raporte të ndryshme monitorimi sektoriale për të kapur progresin në zbatimin e reformave që impaktojnë qeverisjen vendore. Raporti trajton dhe rezultatet e sondazhit të qytëtarëve të shpjeguar në seksionin më lart. Raporti i performancës evidenton progresin ose tendencën në ulje mbi bazën e 70 treguesve me frekuencë nga 10 – 36 për 29 programe. Treguesit me frekuencë më të vogël se 10, nuk janë marrë në konsideratë në këtë analizë (kampioni ka qënë 61 bashki).

Dimension i rëndësishëm në këtë studim ishte përfshirja e Shoqatës për Autonomi Vendore, e cila drejtoi këtë studim të vlerësimit të performancës së shërbimeve dhe procesin e konsultimeve me institucionet qendrore (MB dhe AMVV), MFE, ministritë e linjës, Këshillin Konsultativ (KK), bashkitë dhe Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë me mbështetjen e projektit Bashki të Forta. Gjithsej u organizuan 6 takime rajonale, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, Shkodër dhe Korçë, gjithsej 80 pjesëmarrës nga bashkitë dhe institucione të tjera.

Raporti ka kufizimet e veta që burojnë nga (i) Mungesa e formulimit të saktë të standartit ligjor të shërbimit publik në disa raste, (ii) Ndërlidhja e pa konsoliduar funksion – shërbim publik, mungesa e një sistemi unik treguesish të performancës së shërbimeve për të gjitha bashkitë, (iii) burime të limituara njerëzore dhe teknike në bashki për të siguruar një raportim të plotë për të gjithë treguesit e shërbimeve publike të bashkive.

Të dhënat për performancën e shërbimeve janë ofruar nga bashkitë si pjesë e raportimit në kuadër të raporteve të performancës. Disa tregues nuk janë marrë parasysh në analizën e performancës sepse kanë pasur frekuencë të ulët (n<10). Duhet të përmendet fakti, se të dhënat financiare për buxhetin për programe buxhetore të NJVV nuk përfshijnë transfertën e kushtëzuar.

Shpjegimi i termave kryesore

- ◇ *Programe buxhetor* është një grup veprimtarish të NjVV-së që administrohen efektivisht dhe kontribuojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme, të cilat ndihmojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në arritjen e objektivave dhe të qëllimeve të politikës buxhetore/janë ato zëra të shpenzimeve të buxhetit të cilat financojnë funksionet ligjore të bashkisë të cilat janë funksione të veta ose funksione të deleguara nga qeveria qendrore.
- ◇ *Buxhetimi mbi bazë Programi dhe Performance (BPP)* tregon lidhjet midis burimeve publike (inputeve), produkteve dhe rezultateve të arritura për secilën ndërhyrje të politikave të qeverisë (shpesh lidhen me shërbimet publike specifike që i ofrohen popullsisë, ose shërbime të ndërmjetme, të cilat i mbështesin këto shërbime publike).
- ◇ *Tregues i performancës* nënkupton njësinë e matjes së impaktit, rezultatit dhe produktit. Vlerat e synuara pasqyrojnë nivelin sasior që vendoset për treguesin e performancës në nivel rezultati ose të produktit. Gjatë ekzekutimit të buxhetit, treguesit maten kundrejt vlerës së synuar dhe raportohen si pjesë e proceseve të monitorimit dhe raportimit të buxhetit.
- ◇ *Standart/ose kërkesë ligjore* - normë e përcaktuar nga një autoritet, ligj ose akt n.ligjor ose program politik (strategji).
- ◇ *Të ardhura buxhetore* prej burimeve të veta tregojnë kapacitetin financiar të bashkisë dhe përfshijnë përveç taksave, tarifave, të ardhurave të tjera nga asetet dhe donacionet edhe të ardhurat e trashëguara nga një vit më parë.

- ◇ Të ardhurat nga QQ përfshijnë transfertat e pakushtëzuara të ministrisë së financave, transfertat e kushtëzuara për projekte të caktuara të ministrive të linjës dhe FZSHH si edhe transfertat të qeverisë qendrore për funksione të deleguara apo specifike.
- ◇ Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve = Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- ◇ Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve = Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- ◇ Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave = Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.

3. Rezultatet e performancës në ofrimin e funksioneve / shërbimeve

3.1 Menaxhim dhe Administrim

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin; Shërbimet e përgjithshme publike; administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e NJVV-së, për këshillin dhe komisionet e këshillit; shërbimet statistikore dhe bazën e të dhënave vendore; Prodhimin dhe përhapje të informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Marrëdhënia juridike ndërmjet NJVV-së dhe nëpunësit civil dhe rregullat për administrimin e shërbimit civil përcaktohen në **ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil"**, i cili është një hap i rëndësishëm në plotësimin e reformës ligjore në shërbimin civil dhe mundësimin e një administrate të depolitizuar dhe profesionale, zhvillimin e sistemit të karrierës bazuar në meritë; Marrëdhëniet midis bashkive dhe punonjësit e shërbimeve dhe punonjësve të institucioneve të tjera të bashkisë rregullohen në bazë të Kodit të Punës. Ligje të tjera të rëndësishme janë ligj 139/2015, Ligj 68/2017 "Për financat vendore", Ligji Nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"⁴³, Udhëzim mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në njësitë publike, për menaxhimin e aktiveve, për përgatitjen PBA-së (struktura menaxhimi për çdo program), koordinatorët e riskut, Nëpunës zbatues të të gjitha niveleve; zbatimin e buxhetit (Përdorim të sistemit informatik financiar të thesarit), Ligji: Nr. 9508, datë 3.4.2006 "Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit", neni 8 mbi ngritjen e strukturës për denocimin dhe trajtimin e veprimeve korruptive. Për më shumë informacion, shiko aneksin 1.

Në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore dhe PV 2020-2022 janë parashikuar disa masa prioritare të cilat synojnë konsolidimin e kapaciteteve të strukturave administrative që lidhen me bashkëpunimin ndërbashkiak për tipe të ndryshme shërbimesh, përmirësimin e sistemeve të monitorimit të zbatimit të politikave në nivel vendor dhe krijimin e strukturave të menaxhimit të performancës në bashki", të cilat nuk kanë patur progres të rëndësishëm gjatë vitit 2020.

Prioritetet kryesore për forcimin e funksionimit të NJVV-ve dhe të kapaciteteve profesionale dhe zbatuese të administratës vendore, si pjesë integrale Reformës në Administratën Publike synojnë (i) forcimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore mbi politikat dhe praktikat në nivel vendor, (ii) zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe vlerësimit dhe rishikimi i përshtimeve të punës bazuar në formatin e ri të miratuar nga DAP, (iii) përmirësimin e menaxhimit të arkivimit fizik të dokumentacionit në bashki, (iv) rritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale e administrative të nëpunësve në fusha të ndryshme të funksioneve/shërbimeve, si dhe përfshirjen dhe konsultimin e publikut, (v) përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet miratimit të kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe monitorimi i cilësisë⁴⁴.

Arritje gjatë vitit 2020 ishte miratimi i bazës ligjore për përdorimin e platformës së bashkëpunimit "administrata.

43 Neni 1: Përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të RSH; Neni 3/4, "Praktikë korruptive" është çdo veprim ose mosveprim, i kryer duke abuzuar me autoritetin publik, për sigurimin e përfitimeve të paligjshme për interesa private në dëm të interesave të shtetit apo të shtetasve.

44 PV 2018-2022 Strategjia Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike

al” për përmirësimin e ndërveprimit midis institucioneve dhe unifikimin e praktikave administrative⁴⁵. Gjithashtu për NJVV, do të jetë në përdorim Manuali i delegimit të kompetencave (hartuar në 2020), për të cilin janë parashikuar trajnime për nëpunësit e burimeve njerëzore të administratës shtetërore dhe të NJVV në vitin 2021 dhe Manual Praktik për zbatimin Legjislacionit të Shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore⁴⁶. Objektiv në vijim është shtrirja e sistemit të menaxhimit informacionit për Burimet Njerëzore (HRMIS) në njësitë e vetëqeverisjes vendore⁴⁷.

Në kuadër të agjendës së integritit evropian, vlerësimi i progresit të administratës vendore është pjesë e kriterit politik dhe vlerësohet nga 16 tregues të performancës për administratën vendore përfshirë informacionin mbi trajnime në fusha të ndryshme dhe kapacitetin e bashkive për të organizuar dëgjesat publike (konsultimin publik) dhe llogaridhënien, si dhe adresimin e rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit dhe OSHC⁴⁸; bashkitë raportojnë për treguesit të kuadruar në matricën e treguesve.

Rezultatet e performancës së shërbimit


Treguesit e performancës së shërbimit për këtë program buxhetor burojnë nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, Ligj 152/2013 “Për Shërbimin civil”, qëllimi i të cilit është krijimi i një shërbimi civil të qendrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike (neni 1) dhe treguesit për zbatimin e Reformës në Administratën publike.

Programi është vlerësuar nga Bashkia përkundrejt 5 treguesve të performancës (1) ditë trajnimi për punonjës, (2) Numri i punonjësve të trajnuar kundrejt numrit total të punonjësve, (3) masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar); (4) shkalla e largimit të punonjësve nga bashkia (ndryshimi vjetor) dhe (5) buxheti i programit në raport me buxhetin e bashkisë (në %).

Treguesi: Ditë trajnimi për punonjës në vitin 2020

Në vitin 2020, vlera mesatare e ditëve të trajnimit për punonjës në vit ka qënë përafërsisht 2.5 ditë (N=24). Rezultoni që bashkitë e kategorisë të dytë kanë organizuar ditë trajnimi më shumë për stafin e tyre, si Bashkia Himarë (8 ditë), Bashkia Tepelenë (6 ditë), Bashkia Librazhd (5 ditë).

Grafik 1: Ditë trajnimi për punonjës në vitin 2020



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=23 nga 36)

45 Vendim Nr.833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe administrimin e dosjeve të personelit e te regjistrit qendror të personelit.


46 Burim: DAP; <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/446-manual-praktik-mbi-zbatimin-e-legjislacionit-te-sherbimit-civil-dhe-menaxhimit-te-burimeve-njerezore>

47 Burim: Raporti i Monitorimit të DAP (2020)

48 Raporti i Performancës së Bashkive në procesin e IE (2020), projekt i financuar nga IPA (BE)

NJVV në bashkëpunim me ASPA identifikojnë nevojat për trajnim dhe mundësojnë pjesëmarrjen e nëpunësve dhe punonjësve vendore në programet e trajnimit të organizuar nga ASPA. Në 2020, **norma mesatare e punonjësve vendorë të trajnuar ka qënë 21% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkive**, krahasuar me 16% në vitin 2019.

Grafik 2: Punonjës të trajnuar (në % ndaj numrit total të punonjësve), 2020




Treguesi: Punonjës të larguar ndaj punonjësve gjithsej

Treguesi i rëndësishëm që shpreh shkallën e lëvizshmërisë / qëndrueshmërisë së administratës publike është shkalla e largimeve të punonjësve. Në vitin 2020, norma mesatare e largimeve të punonjësve të bashkisë⁴⁹, ka qënë **10%** (n=30), krahasuar me nivelin 11% në vitin 2019 (n=31/36).

Bashkia Kolonjë kë patur shkallë shumë të lartë të largimeve (90%), Bashkia Cërrik (31%), Bashkia Lezhë (16%) dhe Bashkia Belsh (12%); bashkitë e tjera kanë patur më pak largime të punonjësve. Për të analizuar në mënyrë më të plotë këtë aspekt, kërkohen të dhëna të një serie kohore më të gjatë (disa vjeçare) dhe të dhëna më shumë për shkaqet e largimeve (p.sh. migracioni, pushimet nga puna, ndryshimet e strukturave të bashkive, largimet për arye të mos përputhjes së kërkesave të punësimit në një pozicion, largime për shkak të daljes në pension dhe arsye të tjera).

Grafik 3: Largimet nga administrata (në % të numrit gjithsej), 2020




Treguesi: Ndryshimi vjetor i masave disiplinore

Në 2020, **norma mesatare e masave disiplinore** ka qënë rreth **12%** krahasuar me 42% në vitin 2019 (ose -30 p.p), n=17.

⁴⁹ Numri total përfshin nëpunës të administratës vendore dhe punonjës të shërbimeve (institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë)

Grafik 4: Ndryshimi vjetor i masave disiplinore (numër 2020 / 2019)



Si edhe me treguesin largimet e punonjësve nga bashkia, kërkohen më shumë të dhëna për të arritur në një përfundim të përgjithësuar të natyrës dhe shkaqeve të masave disiplinore të ndërmarra nga autoritetet e bashkive.

Shpenzimet e programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim” (01110)

Programi përfshin në përgjithësi shpenzimet për personelin që konsiderohet politik, pra në mbështetje të kryetarit, këshillit të bashkisë dhe komisioneve të saj. Përfshihet gjithashtu personeli i drejtorive kryesore që ushqejnë me të dhëna bazë të gjithë drejtoritë e tjera të strukturës menaxhuese për hartimin e politikave të programeve buxhetore si: burime njerëzore, shërbime statistikore; informacion publik, statistika për çështjet, prokurime, asete, arkiv, IT, zhvillimin e komunitetit etj. Janë drejtori harmonizuese të informacionit edhe në nivel qendror. Shpenzimet e këtij programi nuk janë plotësisht të pastra, sepse disa bashki përfshijnë gabimisht dhe shpenzime të programeve të tjera. Pra, dhe analiza, nuk ka saktësinë preçize të informacionit, sipas përshkrimit të programit.


Shpenzimet e programit në vitin 2020 paraqiten me ulje prej 7% krahasuar me vitin 2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Mesatarisht shpenzimet e programit zënë 21.2% të shpenzimeve total të bashkisë. Me rritje mbi mesataren e llogaritur janë 23 bashki ose 63% e tyre. Shpenzimet e programit vlerësohen në nivele të larta tek Bashkitë Finiq (51%), Memaliaj (46%), Tepelenë 43%, Libohovë dhe Kukës (42%).

Bashkia Elbasan ka vlerën më të lartë të shpenzimeve të programit , krahasuar me Durrësin dhe Shkodrën si bashki të kategorisë së parë, ndërsa në raport me totalin e shpenzimeve, programi zë përqindjen më të lartë nga bashkia Durrës (34%), megjithëse ka vlerën më të ulët të shpenzimeve se këto dy Bashki.

Grafik 5: Shpenzimet e programit ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë (në %)



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Në përgjithësi programi ka veçori se është strukturë punonjësish dhe pagesa këshilli, prandaj dhe shpenzimet e personelit zënë mesatarisht 61% të shpenzimeve të programit. Në disa bashki si Himarë, Delvinë, Patos, Librazhd, Cerrik ka vlera të ndjeshme investimesh, që me siguri nuk i përkasin këtij programi buxhetor.




Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim është një prej programeve më të financuar në nivel bashkish, dhe po ashtu edhe një nga më të votuarit nga ana qytetarëve, sa i takon dakortësisë së tyre me nivelin e financimit.


Për këtë program, nga rezultatet e sondazhit, vihet re se **44%** e të anketuarve (ose 4,121 persona), shprehet dakort lidhur me shpenzimet e kryera nga ana e bashkive për vitin 2020, dhe vetëm **20%** e të anketuarve (ose 1,831 persona) shprehet dakort për rritjen e shpenzimeve nga ana e bashkive lidhur me këtë program; 23.45% e popullsisë (2,197 persona) shpreh mendimin për uljen e shpenzimeve nga ana e bashkive të tyre lidhur me programin, ndërsa 13% “nuk e di”.

Grafik 6: Mendim i qytetarëve mbi shpenzimet për programin Menaxhim Administrim



Përsa i përket pyetjes “Sa janë të kënaqur me performancën e shërbimit” rezultojnë se **33%** e të anketuarve (ose 2,985 persona) është shprehur e kënaqur me performancën e këtij shërbimi dhe **19%** janë përgjigjur “nuk e di”. Bashkitë me nivelin më të lartë të qytetarëve që shprehen të kënaqur me performancën e këtij shërbimi janë: Malësia e madhe me 84% (70 persona), Mirditë me 80% (18 persona) dhe Dropulli me 71% (41 persona).

Grafik 7: Sa jeni të kënaqur me performancën e programit Administrim dhe Menaxhim?



Gjetje dhe rekomandime

| Treguesit e programit | Tendeca 2020/2019 | Koment sqarues |
|--|-------------------|----------------|
| Ditë trajnimi për punonjës në vit | ↑ | |
| Numri i punonjësve të trajnuar kundrejt numrit total të punonjësve | ↑ | |
| Masa disiplinore (ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar) | ↓ | |
| Shkalla e largimit të punonjësve nga bashkia | ↓ | |

- Treguesit e performancës së programit të lidhur me ngritjen e kapaciteteve të punonjësve vendor (2 tregues) kanë patur trend rritës në vitin 2020 kundrejt 2019, ndërsa treguesit mbi masat disiplinore dhe largimet e nëpunësve vendorë kanë pësuar ulje kundrejt 2019 (norma mesatare e largimeve 10% krahasuar me 11% në vitin 2019).
- Rreth 33% e të anketuarve shprehen të kënaqur me performancën e shërbimit të lidhur me programin menaxhim administrimi, pjesa tjetër ka qënë e pakënaqur ose neutral.
- Në funksion të detyrimeve ligjore dhe objektivave të politikave sektorale dhe detyrimeve që rrjedhin nga agjenda e integritit evropian, NJVV duhet të rrisin kapacitetet profesionale dhe administrative për të qënë të afta të zbatojnë me efektivitet dhe performancë të mirë shërbimet publike të ofruara nga bashkia dhe në drejtim të monitorimit dhe të raportimit të performancës së shërbimeve (të rritet shkalla e koordinimit të punës midis strukturave/shërbimeve të bashkisë lidhur më raportimin e treguesve të performancës së shërbimeve publike).
- Rekomandohet rishikimi i Pasaportës së treguesve të shërbimeve në konsultim me specialistë të ministrive të linjë si pjesë e një sistemi të unifikuar të dhënash për të gjitha bashkitë duke konsideruar edhe
 - T1. Punonjës me status nëpunës civil ndaj numrit total të punonjësve të administratës të bashkisë.
 - T2. Shkalla e largimeve të punonjësve me status të NC ndaj totalit të punonjësve të shërbimit civil (në %).

3.2 Gjendja Civile

Në këtë program buxhetor bashkia nuk planifikon shpenzime, financimi është plotësisht qendror⁵⁰. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Administrimi i shërbimit të gjendjes civile rregullohet me Ligjin Nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile”. Ndërsa administrimi i Rregjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, si një dokument unik shtetëror që pasqyron përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas shqiptar dhe shtetasit e huaj me banim të përkohshëm/të përhershëm në RSH bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, shërbimi i përditësimit të të dhënave të rregjistrit bëhet nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile në bashki.


Ngritja e Zyrave të SHGJC është kompetencë e QV. Emërtimi në detyrë sipas kriterëve dhe largimi i punonjësve të GJC⁵¹ behet nga kryetari i bashkisë me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të GJC (neni 68 i ligjit 10219/2009). Shërbimi i gjendjes civile aplikon disa tarifa për një pjesë të shërbimeve që ofron.

Referuar *Projektit të modernizimit të shërbimit të Gjendjes Civile* dhe ligjit specifik Nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile”, dy tregues standarti mund të analizohen (1) Shpenzime për 1 dokument të prodhuar nga Zyra e gjendjes civile, dhe (2) Lekë të arkëtuara në vit nga ZGJC (ndryshimi në %) kundrejt vitit të kaluar.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Në vitin 2020, zyrat e gjendjes civile kanë lëshuar rreth 143,707 dokumenta më pak në krahasim me vitin 2019, ose mesatarisht rreth 6,248 dokumenta më pak. Shkak mund të jetë situata e shkaktuar nga Covid-19 si dhe ofrimi i shërbimeve nga platforma e-Albania.

Grafik 8: Numri i dokumentave të prodhuar nga gjendja civile (numër, ndryshimi 2020/2019)



Shpenzimet e programit “Gjendje civile” (01170)

Gjendja civile si funksion i deleguar financohet nga transferata e kushtëzuar (nuk janë këto fonde objekt i kësaj analize). Por bashkitë mund të rrisin fondet nga burimet e veta edhe për këto funksione. Pra, referuar bashkive të studimit, kanë financuar nga burimet e veta vetëm Bashkitë Elbasan, Cërrik, Klos, Kamëz, Korçë dhe Kolonjë. Bile Bashkia Kolonjë ka financuar për pagat e punonjësve dhe Bashkia Kamëz edhe për investime të gjendjes civile.

⁵⁰ Bashkitë mund të parashikojnë dhe kryejnë shpenzime, operative ose kapitale, shtesë për GJC (neni 63/3 i ligjit 10129/2009 “Për gjendjen civile”)

⁵¹ Vendimi Nr.1299, datë 16.12.2009 “Për numrin e punonjësve të GJC në Bashki”

Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Gjetje dhe rekomandime

- Në vitin 2020, më pak dokumenta janë prodhuar nga zyrat e gjendjes të bashkive kundrejt vitit 2019.
- Bashkitë që kanë financuar me burimet e veta këtë program, në 2020, kanë qënë Bashkitë Elbasan, Cerrik, Klos, Kamëz, Korçë dhe Kolonjë. Bashkia Kolonjë ka financuar për pagat e punonjësve ndërsa Bashkia Kamëz ka financuar edhe për investime të zyrave të gjendjes civile.

3.3 Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; Amortizimi i huave të marra etj.


Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Huamarrja vendore përcaktohet në Ligjin 139/2015, neni 39. Rritja e kapaciteteve të NJVV që të përdorin huamarrjen për financimin e projekteve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik, është pjesë e Plan Veprimit, 2020-2023, të SNDQV. Nga dy masa/aktivitete të planifikuara në PV, ka progres aktiviteti për hartimin e kuadrit nënligjor për parandalimin dhe menaxhimin e problemeve dhe vështirësive financiare në nivel vendor. Në këtë kuadër, është hartuar nga MFE një udhëzim për ngritjen e një sistem monitorimi për identifikimin e njësisë të cilat kanë probleme financiare. Gjithashtu, është përgatitur një raport për situatën financiare të NJVV si dhe mbi vështirësitë që hasin disa bashki sipas nivelit të riskut⁵².

Rezultatet e performancës së shërbimit

Performanca e shërbimit analizohet me treguesin 'ndryshimi i detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve'

Grafik 9: Ndryshimi i detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve



Në 2020, nga 9 bashki të kampionit që kanë ofruar të dhëna të vlefshme, bashkitë Durrës, Korçë, Diber dhe Librazhd kanë shlyer plotësisht detyrimet ndaj palëve të treta kundrejt 2019; Bashki të tjera që kanë ulur detyrimet në 2020/2019 janë Bashkia Kamëz (-30%), Kukës (-19%), Bashkia Kolonjë (-68%) dhe Bashkia Lezhë (-4%), ndërsa bashki që kanë rritur detyrimet ndaj palëve të treta janë Bashkia Kurbin (30%), Bashkia Klos (3%) dhe Bashkia Cërrik 42%.

52 Burim: Raporti i Monitorimit SNDQV (2021), (ref B4)

Detyrimet e prapambetura të bashkive në fund të vitit 2020 ishin **6.9 miliard lekë** (ose 1.2 miliard lekë më pak krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2019). Norma mesatare e ndryshimit të stokut të bashkive ka qënë 26.8% në 2020 kundrejt normës mestare të ndryshimit me 27% në 2019. Rreth 14 bashki raportojnë se nuk kanë detyrime të prapambetura. Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Tiranë në vlerën rreth 762 milion lekë, e cila përbën 11% të totalit të detyrimeve, bashkia Kavajë në vlerën rreth 728 milion lekë, e cila përbën 10.5% të totalit të detyrimeve, bashkia Vorë në vlerën rreth 703 milion lekë, e cila përbën 10.1% të totalit të detyrimeve, bashkia Pogradec në vlerën rreth 339 milion lekë, e cila përbën 4.9% të totalit të detyrimeve. Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 54.4%, kategoria “Të tjera” 17.3%, “Shërbime” 10.3%, dhe “Vendime Gjyqësore” 10%⁵³.


Shpenzimet e programit “Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm” (01710)

Programi përfshin kryesisht pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore dhe amortizimin e huave të marra. Sipas ligjit për menaxhimin financiar programi kërkon administrimin e tij nga një strukturë e veçantë e NjVV-së. Rezultati i këtij programi është administrimi i huamarrjes dhe ruajtja e stokut të borxhit në parametrat e duhura ligjore. Janë të pakta bashkitë që kanë marrë hua, pra nuk po trajtojmë krahasueshmërinë e treguesve financiar ndërmjet bashkive.

Rezultatet e sondazhit me qytetarët


Për programin Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm kemi të dhëna vetëm për 2 bashki: Elbasan dhe Korçë. Nga rezultatet e sondazhit, në total janë përfshirë **116 përgjigje nga qytetarët**, nga të cilat **34%** (40 persona) shprehen dakort me nivelin aktual të shpenzimeve për këtë program, 33% (38 persona) kanë përzgjedhur opsionin “nuk e di”, 22% (26 persona) janë të mendimit se duhen shpenzuar më pak ndërsa 10% janë të mendimit se duhet të shtohen shpenzimet për këtë program. Nëse shqyrtojmë preferencat e secilës bashki, vëmë re se bashkia me numrin më të lartë të përgjigjeve që shprehen dakort me nivelin aktual të financimit, është Elbasani në masën 38% (29 persona).

Grafik 10: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin “Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm”



Lidhur me performancën e këtij shërbimi, rezultatet e sondazhit na tregojnë se, rreth 38% e të anketuarve (44 persona) kanë përzgjedhur opsionin “neutral”, ndërsa 33% (38 persona) opsionin “nuk e di”.

Grafik 11: Mendimi i banorëve për performancën e programit “Shërbimi i borxhit të brendshëm”:



Gjetje dhe rekomandime

- Nga analiza e treguesve rezulton që 33% e bashkive (n=9) gjatë vitit 2020 kanë patur rritje të detyrimeve ndaj palëve të treta janë, ndërsa bashkitë e tjera ose kanë eliminuar borxhin ose e kanë ulur në krahasim me vitin e kaluar.
- Rezultatet e sondazhit me qytetarët, evidentojnë që 34% e të anketuarve janë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve për këtë program, ndërsa 22% mendojnë se duhet shpenzuar më pak ndërsa 10% e të anketuarve mendojnë që të shpenzohet më shumë (për të eliminuar borxhin).
- Rekomandohet të përfshihet në analizën e performancës së shërbimit treguesi “Shërbimi vjetor i borxhit⁵⁴ për huanë (interes plus principal) të marrë nuk tejkalon shumën 25% të bilancit primar” (diferencës midis totalit të të ardhurave nga burimet e veta dhe shpenzimeve korrente të bashkisë). Treguesi buron nga referenca me Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike, 2019-2022, ligj 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Ligj nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligj nr. 9869/2008 “Për huamarrjen vendore”.

3.4 Shërbimet e Policisë Vendore

Në këtë program buxhetor, bashkia planfikon shpenzimet kryesisht: Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Shërbimi për garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimi dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e konflikteve nga policia vendore e NJVV është përcaktuar në Ligjin 139/2015, neni 23, pika 3, Strategjia e Rendit Publik 2015–2020⁵⁵, Ligj Nr.8224/1997 “Për policinë bashkiake dhe rregulloret tip të policisë së bashkisë”.

Gjithashtu, forcimi i kompetencave të policisë bashkiake është pjesë e PV 2020-2022 të SNDQV (C1.9, pika c). Progres është bërë në hartimin e një projektligji “Për Policinë Bashkiake” (filluar në 2019) por vijon procesi i rishikimit nga MB dhe AMVV (parashikohet që projektligji të miratohet gjatë 2021)⁵⁶.

⁵⁴ Është pagesa, që duhet kryer në çdo vit fiskal për principalin, interesat, zbritjet dhe pagesat e tjera, që rrjedhin nga huatë, përfshirë edhe shpenzimet e lidhura me të.

⁵⁵ Miratuar me VKM nr. 702, datë 26.8.2015


⁵⁶ Burim: Raporti i Monitorimit SNDQV (2021), C1.9

Rezultatet e performancës së shërbimit

Performanca e shërbimit vlerësohet bazuar në dy tregues që janë: (i) Numri i rasteve problematike të zgjidhura kundrejt numrit të rasteve të raportuara nga popullata (në %) dhe (ii) raporti midis punonjësve me status të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë bashkiake.


Bazuar në analizën e të dhënave për vitin 2020, **norma mesatare e konflikteve të zgjidhura kundrejt rasteve të ardhura në policinë bashkiake ka qënë 173%**, krahasuar me 103% për vitin 2019. Mesatarisht 51 raste janë adresuar nga qytetarët në policinë bashkiake gjatë vitit 2020, kundrejt 89 rasteve, mesatarisht, të rregjistruara në vitin 2019. Numri më i madh i rasteve të ardhura nga qytetarët në policinë bashkiake evidentohej në Bashkinë Vau-Dejës (120 raste), pasuar nga Bashkia Finiq (113 raste), në vitin 2020 (n=30).

Grafik 12: Raporti i rasteve problematike të zgjidhura nga policia bashkiake kundrejt numrit të rasteve të raportuara nga qytetarët, në 2020 (në %)



Burim: Raportet e performancës të bashkive për vitin 2020

Grafik 13: Raporti i punonjësve me status oficeri kundrejt numrit gjithsej të policisë bashkiake, 2020 (në %)



Burim: Raportet e performancës të bashkive për vitin 2020

Në 2020, **niveli mesatar i raportit të numrit të punonjësve me status oficeri kundrejt numrit total të punonjësve të policisë bashkiake ka qënë 16%** (treguesi rezulton më i vogël kundrejt 21% të raportuar për vitin 2019). Nga bashkitë raportuese, rezulton që vetëm dy bashki kanë patur një numër më të madh punonjës me status oficeri - Bashkia Cërrik ka patur 50% të punonjësve me status oficeri dhe Bashkia Librazhd 38%, ndërsa

13 bashki ose **46%** të bashkive të kampionit që kanë ofruar të dhëna, nuk kanë patur punonjës me status oficeri në policinë bashkiake në 2020.


Shpenzimet e programit “Shërbimet e Policisë Vendore” (03140)

Ka rreth 12 bashki të cilat kanë patur zero fonde tek ky program (fondi mund të jetë raportuar tek programe të tjera), pra krahasueshmeria është bërë me 24 bashkitë që kanë të ndara kostot e këtij programi nga të tjerat.

Shpenzimet e programit janë rritur me 14% krahasuar me një vit më parë.


Shpenzimet sipas programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute.

Mesatarisht, shpenzimet e programit zënë 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë. Mbi mesataren janë 7 bashki ose 29% e tyre. Programi zë përqindje të lartë tek bashkia Has (3%).



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Tek bashkitë e kampionit, shpenzimet për paga zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve. Bashkitë shpenzojnë pak lek për plotesimin e standartit ligjor për kompletimin e policisë me mjetet standart të punës/policisë (mjet transporti, komunikimi dhe mjete individuale). Bashkitë që kanë investuar janë vetëm bashkitë Shkodër, Elbasan, Malësi e Madhe dhe Mat. Kanë vetëm kosto personeli të policisë 9 bashki ose 38% e tyre.



Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Gjtje dhe rekomandime

- Mesatarisht rreth 16% të punonjësve të policisë bashkiake kanë patur status oficeri në raport me numrin total të punonjësve të policisë bashkiake (ose – 5 p.p. në krahasim me vitin 2019).
- Në 2020, policia ka qënë proaktive - shkalla mesatare e konflikteve të zgjidhura kundrejt ankesave të depozituara ka qënë 173% krahasuar me 103% për vitin 2019.
- Bazuar në ligjet specifike dhe politikat strategjike, rekomandohet të konsultohen disa tregues të tjerë:
 - Raporti mes punonjësve të policisë dhe numrit të banorëve të bashkisë⁵⁷
 - Hartimi dhe miratimi i Planeve vendore të komunikimit për sigurinë në komunitet⁵⁸.
- Shpenzimet e programit janë rritur me 14% krahasuar me vitin 2019, dhe përbëjnë rreth 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë. Shpenzimet për paga zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve.

3.5 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile


Në këtë program buxhetor bashkia planfikon shpenzimet, kryesisht: Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Funksioni për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi u transferua në NJVV në vitin 2015⁵⁹. Përveç fondit të transferuar për këtë shërbim në bashki, u realizua transferimi i 738 punonjësve të shërbimit dhe asetet nga data 1 Janar 2016. Nga 38 bashki me stacione të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në 2016, synimi i politikës ishte sigurimi i mbështetjes nga qeveria që çdo bashki të kishte stacionin e vet të mbrojtjes nga zjarri. Qartësimi i rregullimit të këtij funksioni është parashikuar edhe në PV 2020-2023 të SNDQV (C1.9).

Në 2017-2018, është kryer investim nga buxheti i shtetit për blerjen e 19 automjeteve të reja në shumën 70 milion lekë.

Grafik 14: Numri i stacioneve/mjeteve dhe punonjësit e SHMZSH, 2016-2020



Burim: AMVV

57 Strategjia e Rendit Publik 2015–2020. Obj. III/1.2: Formim dhe kualifikim i punonjësve të policisë. Punonjës të çertifikuar

58 Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në komunitet 2021-2026. Obj.1: Rritja e parametrevë të sigurisë në komunitet

59 Urdhër i Kryeministrit nr.127, datë 16.09.2015 «Mbi masat për decentralizimin e funksioneve të reja»

Në 2019-2020, progres është bërë në plotësimin e bazës ligjore në vijim të miratimit të ligjit 152/2015 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi”. Drejtoria e Përgjithëshme e MZSH, ka hartuar dhe miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkon ligji 152/2015, të cilat janë 19 VKM dhe 5 udhëzime të Ministrit të Brendshëm, përfshirë edhe rregulloren për shërbimin dhe Udhëzimin (nr. 81/6.03.2020) “Për Klasifikimin e Objekteve sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e çertifikatës së sigurisë nga zjarri”. Në 2020, vetëm Bashkia e Tiranës po ndërton një ndërtesë të re për stacion zjarrfikës në zonën e Kinostudios. Bashkitë e tjera, veçanërisht 23 bashkitë e reja, të cilat nuk kanë pasur stacione, kanë përshtatur ndërtesat ekzistuese në stacione zjarrfikëse.

Për realizimin e shërbimit, NJVV kanë përgjegjësi të sigurojnë infrastrukturën dhe personelin për shërbimin e mbrojtjes dhe shpëtimin nga zjarri, miraton leje zhvillimi/ndërtimi dhe akte shfrytëzimi ndërtimore vetëm pas plotësimit të rregullave të mbrojtjes nga zjarri (ligj nr. 152/2015 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi”), planifikon fonde financiare për mbrojtjen nga zjarri, kryen inspektimin, parandalimin dhe ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, si dhe krijimin e shërbimit vullnetar. Në vitin 2020, janë realizuar gjithsej 4 trainime nga Drejtoria e Përgjithëshme, për nivelin e mesëm (inspektorët e parandalimit dhe shefat e ndërhyrjes).

Rezultatet e performancës së shërbimit


Performanca e shërbimit matet nga disa tregues: (i) **dalja nga stacioni ditën** (ndryshimi në sekonda 2020/2019); (ii) **Dalja nga stacioni natën** (ndryshimi në sekonda); (iii) **Numri i rasteve të menaxhuara** për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në numer), (iv) **numri i stacioneve MZSH** dhe (v) **Sipërfaqe e mbuluar/ose mbulim shërbimi** (Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin ndaj sipërfaqes totale të bashkisë).

Në 2020, **mesatarisht koha e daljes nga stacioni është 83.9 sekonda** që evidenton përmirësim të performancës krahasuar me 2019 (ose 13.7 sekonda më pak). Rreth **70%** e bashkive kanë raportuar një **ndryshim zero të treguesit**, ndërsa 4 bashki kanë raportuar kohë të daljes së mjeteve nga stacioni me diferencë të konsiderueshme ndaj bashkive të tjera, si Bashkia Librazhd, Himarë dhe Memaliaj (180 sec), Bashkia Fushë-Arrëz (240 sec), Bashkia Dropull (540 sec).

Koha mesatare e daljes së mjeteve natën nga stacioni MZSH rezulton në nivelin 59.06 sec për 16 bashki të kampionit, ose **9.5 sec më pak kundrejt vitit 2019**. Rreth 81% e bashkive raportuese kanë patur zero ndryshim në 2020 kundrejt 2019; Bashkia Cërrik (-1 sec), Bashkia Kolonjë (+60, 120 sec / 60 sec), Bashkia Librazhd (-20 sec, 180 sec/200 sec). Treguesi rezulton të jetë në vlerë më të lartë referuar studimit të shërbimit për 15 bashki në 2016-2017 – 61 sekonda. Llogaritja nga të dhënat e raportuara, rezulton se koha për daljen e mjeteve nga stacionet, në 2020, është me lartë se vlera e treguesve në vitin 2016⁶⁰.

Në 2020, janë raportuar rreth **93 raste më shumë të menaxhuara për shuarjen e zjarrit kundrejt 2019** (n=25 nga 36 bashki të kampionit). Bashkitë raportojnë **mbulim të plotë të territorit** të tyre.


Grafik 15: Ndryshimi i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit 2020/2019 sipas bashkive



Shkalla mesatare e rasteve të zjarrit të menaxhuara nga shërbimet e bashkive ka qënë 110 gjatë vitit 2020.

60 Referuar Raportit të Performancës së Funksioneve të tranferuara në NJVV (dldp, 2018 O. Shapo)

Grafik 16: Numri i rasteve të zjarrit të menaxhuara, 2020




Shpenzimet e programit “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”- 03280

Burim financimi për “Mbrojtjen civile” është transferata specifike. Ky fond shpërndahet me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Pjesën tjetër të financimit bashkitë mund ta sigurojnë nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës ose/dhe pjesë nga buxhetet e tyre (transferata e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore).

Shpenzimet e programit janë rritur me 10% krahasuar me vitin e kaluar.


Shpenzimet sipas programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute.

Mesatarisht shpenzimet e programit zënë 4% të shpenzimeve total të bashkive. Janë 16 bashki ose 44% e tyre që shpenzimet e programit zënë mbi 4% të shpenzimeve të bashkisë. Përqindja më e lartë është tek bashkitë Libohovë (17%), Këlcyrë, Libohovë dhe Fushë Arrëz (9%) dhe Dropull (8%).



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Bashkia Delvinë dhe Finiq nuk kanë buxhet për këtë program (mbase nuk kanë strukture të MKZ-s). Sipas grafikut, vetëm 13 bashki ose 38% e tyre kanë investuar për mbrojtjen nga zjarri, pra për ngritjen e stacioneve të reja apo paisjen me bazën e nevojshme materiale për zjarrfikësit.




Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Rezultatet e sondazhit kanë evidentuar se rreth **50%** (1,684 persona) janë dakord me nivelin e financimit të programit “Mbrotjtja nga zjarri” nga ana e bashkive, **33%** (1,130 persona) kërkojnë rritjen e shpenzimeve për këtë program, 13% (431 persona) janë përgjigjur me “nuk e di” dhe vetëm 4% (137 persona) kërkojnë të ulen shpenzimet.

Bashkitë të cilat janë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve, nga përgjigjet e banorëve të tyre, janë: Dropulli me 76% (45 persona), Tepelena me 63% (52 persona), Këlcyra me 61% (51 persona), Patosi me 61% (71 persona), Puka me 59% (41 persona), Skrapari me 57% (27 persona), Delvina me 57% (106 persona), Berati me 57% (51 persona), Përrenjasi me 56% (25 persona), Lezha me 52% (81 persona), Gjirokastra me 47% (42 persona), Kukësi me 47% (929 persona), Roskoveci me 46% (48 persona), Memaliaj me 45% (25 persona) dhe Libohova me 43% (19 persona), Vau i Dejës në masën 61% (64 persona), Fushë Arrëz në masën 51% (39 persona).


Grafik 17: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin “Mbrotjtja nga zjarri & mbrotjtja civile”



Në përgjigje të pyetjes “Sa jeni të kënaqur me performancën e shërbimit?”, rezultatet e sondazhit tregojnë se, rreth **36%** (1,215 persona) kanë zgjedhur të përgjigjen “neutral”, **32%** (1,104 persona) kanë shprehur vlerësim “shumë mirë”, **21%** (710 persona) kanë zgjedhur të shprehen me “nuk e di” dhe **11%** (388 persona) kanë shprehur vlerësim të ulët.

Bashkitë, banorët e së cilave, kanë zgjedhur të shprehen në masë më të lartë “neutral” janë: Skrapari me 54% (15 persona), Përrenjasi me 49% (22 persona), Këlcyra me 44% (35 persona), Devolli me 42% (38 persona), Berati me 40% (35 persona), Delvina me 39% (72 persona) dhe Kukësi me 39% (760 persona). Bashkitë që vlerësojnë shumë shërbimin, kanë qënë bashkia Vau Dejës me 70% (60 persona), Dropulli me 69% (40 persona), Puka me 67% (47 persona), Tepelena me 56% (46 persona), Patosi me 54% (61 persona), Fushë Arrëzi me 52% (40 persona), Gjirokastra me 44% (39 persona), Roskoveci me 44% (45 persona), Lezha me 40% (62 persona), Libohova me 37% (16 persona) dhe Memaliaj me 33% (18 persona).

Grafik 17: Mendimi i banorëve për performancën e programit “Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile”



Gjetje dhe rekomandime

- Performanca e shërbimit nga analiza e treguesit të kohës së daljes së mjeteve nga stacioni më e vogël (mjetet dalin më shpejt) – ndryshimi mesatar është -1.62 sekonda kundrejt performancës në vitin 2019 (n=27)); **70%** e bashkive kanë raportuar një **ndryshim zero të treguesit 2020/2019**. Krahasuar me analizën e performancës në kuadër të raportit për funksionet e deleguara, koha e daljes rezultoi më e madhe⁶¹.
- **Koha mesatare e daljes së mjeteve natën nga stacioni MZSH rezultoi 65.7 sec për 16 bashki të kampionit, ose 2.4 sec më shumë kundrejt vitit 2019**. Rreth 81% e bashkive raportuese kanë patur zero ndryshim në 2020 kundrejt 2019. Treguesi rezultoi të jetë në vlerë më të lartë referuar analizës së treguesit në raportin për funksionet e deleguara, për 15 bashki që mbulonte periudhën 2016-2017, e cila ka qënë 61 sekonda⁶¹.
- Bashkitë raportojnë **mbulim të plotë të territorit** të tyre me shërbimin e mbrotjtjes nga zjarri.
- Shpenzimet e programit janë rritur me **10%** krahasuar me vitin 2019 dhe përbëjnë mesatarisht rreth 4% të shpenzimeve total të bashkisë.
- Rezultatet e sondazhit tregojnë se rreth **50%** e të anketuarve (1,684 persona) **janë dakord me nivelin e financimit** të programit “Mbrotjtja nga zjarri dhe shpëtimi/dhe mbrotjtja civile”, **33%** (1,130 persona) kërkojnë **rritjen e shpenzimeve** për këtë program.
- Për performancën e shërbimit, anketa tregon se **32% e të anketuarve** kanë dhënë **vlerësim shumë mirë**, **36%** kanë zgjedhur të përgjigjen “neutral”, **21%** ‘nuk e di’.
- Në zbatim të detyrimeve të ligjit 152/2015, mbetet sfida ngritja dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Trainimit Zjarrfikës pranë Akademisë së Sigurisë. Me Urdher nr. 12, datë 13.01.2021 të Kryeministrit është miratuar struktura e Drejtorisë së Qendrës Kombëtare e Trajnimit të Zjarrfikësve (QKTZ).
- Është e nevojshme planifikimi dhe alokimi i fondit të nevojshëm për plotësimin e bazës materiale për funksionimin e duhur dhe ofrimin cilësor të trajnimit profesional të punonjësve të shërbimit.
- Plotësimi i numrit të punonjësve të shërbimit në bashki, në zbatim të standartit (1 zjarrfikës për 1500-2000 banorë; miratimi i numrit nga MFE për punonjësit e bashkisë dhe të shërbimit.
- Tregues të tjerë për konsultim për performancën e shërbimit si: (1) Stacioni i shërbimit të MZSH-së i ngritur në bashki (PO/JO), (2) Numri total i punonjësve të shërbimit MZSH (1 stacion jo me pak se 14 punonjës zjarrfikës).
- Meqënëse ky program buxhetor, mbulon dhe mbrotjtjen civile, të merret në konsideratë mundësia e shtimit të treguesve specifikë të performancës për mbrotjtjen civile.

61 Referuar Raportit të Performancës së Funksioneve të transferuara në NJVV (dldp, 2018 O. Shapo)

3.6 Marrëdhëniet në Komunitet

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Aktivitete të NJVV-së për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë dhe ndjenjën e përkatësisë brenda njësisë, besimin dhe mbështetjen për autoritetet vendore; Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimarrje, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve për këtë qëllim.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimarrjen e NJVV përcaktohet në ligj Nr. 139/2015 Mbi Vetëqeverisjen Vendore (neni 15) dhe Ligj Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura dhe qytetarët mund të ndjekin ato.


Konsultimi me komunitetet dhe qytetarët para vendimarrjes është i detyrueshëm në mbledhjet e KB në rastet e zgjedhjes së komisioneve dhe miratimit të rregullores së brendshme, miratimit të buxhetit dhe ndryshimet e tij; tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve; vendimarrjen për taksat dhe tarifat vendore; miratimit të normave dhe standarteve e kriterëve për rregullimin e funksioneve që i janë dhënë me ligj (L. 139/2015, neni 54).

Përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe aplikacioneve ka mundësuar që shumë takime të KB dhe konsultime të realizoheshin online, në mënyrë të veçantë gjatë 2020 për shkak të situatës Covid-19.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Proçeset e konsultimit dhe transparencës në vendimarrje në nivel vendor, janë matur nga disa tregues: (i) numri i konsultimeve publike (takimeve) të parashikuara me ligj, (ii) vendime të KB të marra pas konsultimit publik; (iii) Numri i mbledhjeve të hapura kundrejt totalit të numrit të mbledhjeve të KB⁶².

Grafik 18: Numri i konsultimeve publike të parashikuara me ligj, 2020




Në 2020, mesatarisht numri i konsultimeve publike të parashikuara me ligj, sipas të dhënave të raportuara nga bashkitë në Raportet e Performancës, ka qënë 7 (n=22); Bashkia Belsh, Libohovë (2), Bashkia Kukës, Dropull (3) dhe Bashkia Elbasan, e cila ka raportuar numrin më të madh të konsultimeve (24).

62 Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore: Neni 16: Organet e VV-së janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në proçesin e vendimarrjes, Neni 17/1: Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun, Neni 20: 5: E drejta e iniciativës qytetare.

Në vitin 2020, më shumë vendime janë marrë nga bashkitë pas konsultimeve publike – gjithsej 645 vendime ose mesatarisht 129 vendime më shumë në 2020 kundrejt 2019.

Grafik 19: Vendime të Këshillit Bashkiak të marra pas konsultimeve publike, ndryshimi 2020/2019



Në 2020, bashkitë raportojnë që të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qënë të hapura për qytetarët, duke mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2019.

Shpenzimet e programit

Bashkitë nuk kanë raportuar buxhet në këtë program, me përjashtim të bashkive Kolonjë dhe Pukë. Pra, Bashkitë, ose këto shpenzimeve i kanë përfshirë në programe të tjera ose mungojnë pikërisht shpenzimet që nxitin pjesëmarrjen dhe besimin e qytetarëve për çështjet e vetëqeverisjes vendore dhe aktivitete që lidhen me organizimet në dëgjesa dhe konsultime.

Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Gjetje dhe rekomandime

- Mesatarisht, numri i konsultimeve publike të parashikuara me ligj, sipas të dhënave të raportuara nga bashkitë në Raportet e Performancës, ka qënë 7 (n=22) Vlera mesatare e treguesit në 2020, për bashkitë e kampionit, rezulton më e vogël kundrejt vitit 2019 (8 dëgjesa mesatarisht n=61), dhe 9 dëgjesa mesatarisht për vitin 2018²⁵.
- Referuar Ligjit 146/2014 (neni 5 dhe 6/3) Për konsultimin publik, të konsiderohet një tregues tjetër për analizën e programit “numri i projekteve të publikuara në regjistrin elektronik/façen zyrtare të bashkisë në raport me numrin total të akteve të miratuara nga bashkia në vitin e raportimit.
- Kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse të qytetarëve në proceset vendimmarrës dhe të buxhetimit në nivel vendor ka nevojë për forcim të mëtejshëm (rritje cilësore e organizimit të konsultimit publik).⁶³
- Bashkitë nuk kanë raportuar buxhet në këtë program, me përjashtim të bashkive Kolonjë dhe Pukë.

3.7 Mbështetja për Zhvillim Ekonomik

Në këtë program buxhetor bashkia planfikon shpenzimet kryesisht: Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve; Mbjajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore

63 Raporti i KE për Shqipërinë (2020)

dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik; Funksionimi ose mbështetje me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë; Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore; Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj.; Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj, grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Në fushën e zhvillimit ekonomik, NJVV janë përgjegjëse për hartimin e planeve strategjike të zhvillimit dhe të programeve për zhvillimin ekonomik vendor, ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë, mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet panairëve dhe reklamave, informacionit për bizneset, aktivitete promovuese, vënien në dispozicion të aseteve publike dhe dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor⁶⁴.

Aktivitetet e PV 2020-2022 SNDQV, lidhur me forcimin e funksionit të zhvillimit ekonomik vendor (C2.1), si hartimi i ndryshimeve ligjore sektoriale që fuqizojnë rolin e NJVV për investimet strategjike, partneritetin publik-privat dhe menaxhimi i aseteve vendore, dhe lehtësimi i procedurave të menaxhimit të pronës publike nga bashkia, për shkak të natyrës komplekse dhe nevojës për studime të thelluara sektoriale janë zhvendosur në 2021-2022. Gjithashtu, nuk ka patur progres në aktivitetet (C2.2) që lidhen me ngritjen e një task-force me pjesëmarrje të nivelit qendror dhe vendor për përshejtimin e procesit të transferimit të pronave. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) raporton se në vitin 2020 janë miratuar 100% e kërkesave të ardhura nga bashkitë.⁶⁵

Në kuadër të agjendës së integritit evropian dhe domosdoshmërisë për të krijuar një ekonomi tregu funksionale (plotësimi i kriterit II - Ekonomik për anëtarësimin në BE), performanca për fushën e zhvillimit ekonomik për NJVV vlerësohet mbi bazën e pesë treguesve⁶⁶.

Turizmi

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor; Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese e të një natyre të ngjashme; Përmirësim i hapësirave pamore urbane të bashkisë, përmes mirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore.

Kuadri ligjor për zhvillimin e turizmit: Ligj 139/2015, Strategjia Kombëtare për Zhvillim të qëndrueshëm të turizmit 2019-2023 dhe ligj nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i cili përcakton detyra për NJVV për (i) të ardhurat nga turizmi (neni 19/a) mbi Krijimin e inventarit të burimeve kryesore turistike⁶⁷ të NJVV-së dhe inventarin e sipërmarrjeve turistike në nivel vendor (çdo 6 muaj informacioni të dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit), dhe (neni 19/a.1 mbi numrin e strukturave akomoduese (hotele, bujtina, etj).

Objektivat e politikës së qeverisë për një turizëm të qëndrueshëm dhe të diversifikuar kanë synuar: (i)

64 Ligj 139/2015 Për Vetëqeverisjen vendore, neni 28

65 Raporti i Monitorimit SNDQV PV 2020-2022 (MB, 2021)

66 Burim: Projekti Bashkitë në Proçesin e Integritit Evropian (projekt i financuar nga IPA (BE)): (i) Plan (program) i Zhvillimit Strategjik, (ii) numri i aktiviteteve stimuluese sipas bashkive, (iii) shërbime në mbështetje të biznesit të vogël e të mesëm; (iv) numri i rekomandimeve të bashkive në mbështetje të biznesit të vogël e të mesëm, (v) numri i bizneseve të reja gjatë vitit raportues.

67 “Burim turistik” është tërësia e elementeve dhe/ose faktorëve, si potenciale që mundësojnë prodhimin e një eksperience turistike, duke përfshirë burimet e preqshme, burimet e paprekshme si edhe burimet njerëzore.

centralizmin e procesit të planifikimit në turizëm, reformimin e institucioneve, agjencive që merren me turizmin; (ii) rregullimin në treg të gjithë operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit; (iii) përmirësimin e legjislacionit dhe përmirësimin e të dhënave si mjeti kryesor për matjen ekonomike të turizmit, (iv) kontrollin e cilësisë dhe të standardeve në strukturat mikpritëse.

Alpet Shqiptare, Jugu i Ri, Portet e Marinat, Tirana janë konsideruar 4 destinacione turistike kombëtare dhe Turizmi kulturor me prioritet ruajtjen dhe përmirësimin e standardit të cilësisë në prodhimet kulturore, intensifikimin e investimeve në këtë sektor dhe shfrytëzimin e kulturës si burim ekonomie dhe turizmi⁶⁸.

Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit në nivelin vendor është pjesë e PV 2020-2022 SNDQV. Në 2020, ka patur bashkëpunim ndërmjet degëve territoriale dhe strukturave përkatëse në 40 bashki. Zhvillimi i agroturizmit vitit e fundit lind nevojën për rritjen e numrit të personave të kualifikuar për turizmin pranë çdo bashkie. Kryesisht bashkitë e zonave verilindje e juglindje kanë nevojë për personel këshillues për subjektet.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Treguesit: (i) Performanca e shërbimit në fushat e zhvillimit ekonomik matet me treguesin 'ndryshimi (në orë) për paisjen me dokumenta nga QKB' (lëshimi i certifikatës NIPT, leje, etj).

Analiza e të dhënave (n=12) evidenton që mesarisht, **ndryshimi në kohë i marrjes së shërbimit për paisjen me dokumenta nga QKB⁶⁹, ka qënë nga 1 orë** (Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Tepelenë, Vau i Dejës) deri 48 orë (Bashkia Kurbin dhe Cërrik).

Shpenzimet e programit “Mbështetje për zhvillimin ekonomik” (04130)

Tek ky program përfshihet aktiviteti QKB, i cili financohet nga transfertat e kushtëzuar, si funksion i deleguar NJVV-ve dhe që nuk është pjesë e analizës sonë. Por, bashkitë duhet të raportojnë në këtë program edhe shpenzime që lidhen me mbështetjen dhe promovimin e bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik, nëpërmjet aktiviteteve informuese, publikimit të broshurave, portaleve me profil ekonomik për bizneset etj. Faktikisht, bashkitë nuk raportojnë buxhet në këtë program, me përjashtim të bashkive Belsh, Korçë, Shkodër, Shijak, të cilat kanë raportuar kosto operative për programin.

Për programin e turizmit, treguesit e performancës të programit


- (i) numri i turistëve të akomoduar në hotele (ndryshimi 2020/2019)
- (ii) Të ardhurat nga taksa e qëndrimit në hotel kundrejt të ardhurave vendore

Në fushën e turizmit, në 2020, ka patur ulje të numrit të vizitorëve rezidentë dhe jo rezidentë dhe ulje të numrit të qëndrimeve në hotele dhe në struktura të tjera akomoduese.

68 Burim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

69 Referenca ligjore: Ligji nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (neni 3/1: QKB mban në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, Regjistrin Kombëtar të Liçencave, Autorizimeve dhe Lejeve; Neni 3/ë: Siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Liçencave, Autorizimeve dhe Lejeve, Neni 4: Ushtron funksione të saj drejtpërdrejt për publikun, nëpërmjet sportelit të saj. Ligji Nr. 8/2015, Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9723/2007 Për QKR, të ndryshuar, Neni 54: QKB lëshon vërtetimin e kryerjes së regjistrimeve të tjera brenda një afati prej një dite nga data e paraqitjes së aplikimit.


Grafik 20: Ndryshimi i numrit të vizitorëve 2018-2020



Burim: INSTAT; <http://instat.gov.al/media/8019/strukturat-akomoduese-t4-2020.pdf>

Performanca e shërbimeve në këtë fushë analizohet nëpërmjet dy treguesve

Grafik 21: Numri i turistëve të akomoduar në hotele (ndryshimi 2020/2019)



Në 2020, numri i turistëve për bashkitë e kampionit ka qënë 43,746 turistë më pak kundrejt vitit 2019.

Për treguesin “Të ardhurat nga taksa të hoteleve në mijë lekë në raport me të ardhurat nga taksat vendore” shumë pak bashki (vetëm 3) kanë ofruar të dhëna, si Bashkia Elbasan e cila ka siguruar 0.8% të të ardhurave nga taksa në hotele, Bashkia Kukës (3.9%) dhe Bashkia Lezhë (3.4%) në vitin 2020.

Shpenzimet e programit “Zhvillimi i turizmit” (04760)

Shpenzimet e programit adresohen në përgjithësi për aktivitete që këndë të bëjnë me nxitjen e turizmit në territor dhe mirëmbajtjen e objekteve të atraksionit turistik. Burim financimi janë të ardhurat e veta të bashkisë, si dhe të ardhurat nga taksa e shërbimit hotelier.

Për këtë program, kanë raportuar shpenzime vetëm 9 bashki ose 25% e bashkive të kampionit.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 5% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Mesatarisht shpenzimet e programit zënë 0.2% të totalit të shpenzimeve të bashkisë (n=9).


Grafik 22: Buxheti i programit "Zhvillimi i turizmit" (në % të buxhetit total)



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Mesatarisht, shpenzimet korente zënë 57% të shpenzimeve të programit, ku pagesat e punonjësve zënë 46%. Vetëm Bashkia Korçë, Shkodër dhe Vau i Dejës kanë investuar për turizmin.

Grafik 23: Struktura e shpenzimeve të programit sipas klasifikimit ekonomik




Rezultatet e sondazhit me qytetarët (projekte zhvillimi – 04740)

Për programin Projekte Zhvillimi të dhënat janë ofruar nga dy (2) bashki: Durrës dhe Patos.

Nga rezultatet e sondazhit, në total janë përftuar 285 përgjigje, nga të cilat 51% (144 persona) shprehen mendimin për të shpenzuar më shumë për këtë program nga ana e bashkive të tyre, ndërsa 38% (108 persona) paraqiten dakort shpenzimet që bashkitë e tyre kryejnë realisht për këtë program.


Nëse shqyrtojmë preferencat e secilës bashki, vëmë re se bashkia më numrin më të lartë të përgjigjeve që mbështesin rritjen e shpenzimeve, është Durrësi në masën 56% (94 persona).

Grafiku 24: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Projekte Zhvillimi



Mbi performancën e programit, rreth 36% e të anketuarve (103 persona) janë ‘të pakënaqur’, 28% (79 persona) shprehen ‘të kënaqur’ dhe 28% (79 persona) kanë mendim ‘neutral’.

Grafik 25: Mendimi i banorëve për performancën e programit “Projekte Zhvillimi”



Gjetje dhe rekomandime

- Ofrimi i shërbimit nga QKB për prodhim të ndonjë dokumenti të kërkuar nga qytetarët dhe bizneset është në nivel pothuasje të njëjtë (ndryshimi 2020/2019 në nivel mesatar është 1 orë).
- Shpenzimet e programit për zhvillimin e turizmit në vitin 2020 janë ulur mesatarisht me 5% krahasuar me v.2019 dhe përbëjnë rreth 0.2% të shpenzimeve totale të bashkisë.
- Institucionet shqiptare duhet të krijojnë mekanizma efektivë konsultimi me bizneset dhe partnerët socialë për të siguruar transparencë dhe parashikueshmëri të masave mbështetëse dhe legjislacionit⁷⁰.
- Për qëllim të analizës së performancës për zhvillimin ekonomik, mund të konsiderohet shtimi i treguesve të tjerë në raportet e performancës. Në kuadër të procesit të integritimit dhe raportimeve për performancën e bashkive⁷¹ lidhur me kriterin ekonomik (kriteri II), me objektiv specifik “Përmirësimi i mjedisit për biznesin”, performanca e bashkive vlerësohet lidhur me hartimin/miratimin e planit vendor të zhvillimit, numrin e shërbimeve që mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, numrin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të reja, dhe numrin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë mbyllur aktivitetin gjatë vitit të raportimit⁷².

70 Raport i Progresit i KE për Shqipërinë, 2020

71 Projekti Bashkitë për Evropë (BpE (BE/IPA), matrica e treguesve

72 Projekti Bashkitë për Evropë (BpE (BE/IPA), matrica e treguesve

3.8 Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi dhe Inspektimi

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve; Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë është pjesë e funksioneve të NJVV në fushën e zhvillimit ekonomik vendor (Ligj 139, neni 28, pika 2) dhe Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”.


Në kuadër të axhendës së integrimit evropian, menaxhimi i tregjeve dhe përmirësimi i kushteve sanitaro-veterinare është pjesë e kapitullit 12 “Politikat ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare”, nën kriterin III “Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë”. Performanca vlerësohet përkundëjt dy objektivave specifike: (i) përmirësimi i kushteve sanitaro-veterinare me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve (7 tregues), dhe (ii) funksionimi eficient i sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve (3 tregues që lidhen me ngritjen e zyrës së konsumatorit në bashki dhe numrin e ankesave të paraqitura nga qytetarët/dhe numri i ankesa për të cilat bashkia ka marrë masat e nevojshme⁷³.

Niveli mesatar i tregjeve të kafshëve të gjalla të liçensuara kundrejt numrit total të tregjeve në territorin e bashkisë është raportuar 19% (N=54) në vitin 2019, ndërsa mesatarja e tregjeve publike të shitjes me pakicë konform standardeve të higjenes kundrejt numrit total të tregjeve në territorin e bashkisë është raportuar rreth 40% (N=57)⁷⁴. Në vitin 2020, ka vijuar ndërtimi i tregut të peshkut në Vlorë dhe ka përfunduar ndërtimi i tregut të peshkut në Shëngjin⁷⁵.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Në vitin 2020, rreth **84% e bashkive të kampionit (n=23) nuk kanë patur ndryshime në numrin e tregjeve publike krahasuar me vitin 2019**; bashki të tjera kanë raportuar shtim dhe mbyllje të tregjeve në 2020 kundrejt 2019: Bashki Bulqizë (1 treg te ri);

Grafik 26: Numri i tregjeve funksionale (ndryshimi 2020/2019)




Burim: Raportet e performancës të bashkive (N=23)

73 Raporti Bashkitë për Evropë (projekt i financuar nga IPA/BE).

74 Burim Raporti i performancës së Bashkive në procesin e Integrimit Evropian (për vitin 2019)

75 Raport vjetor për vitin 2020 (MBZHR, 2021)

Grafik 27: Tregje të licensuar (ndryshimi 2019/2018)⁷⁶



Shpenzimet e programit “Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” (04160)

Në këtë program, raportojnë shpenzime vetëm 3 bashki, Bulqizë, Durrës dhe Shkodër, por patjetër që në territorin e bashkive funksionojnë tregje publike dhe nëse ato janë të formalizuara sipas PPV, duhet që bashkitë të raportojnë shpenzime për mirëmbajtjen e tyre. Nuk mund të jepet një gjetje e përgjithësuar për mungesë të të dhënave të raportuara për vitin 2020.

Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Gjetje dhe rekomandime

- (i) Në vitin 2020, rreth **84%** e bashkive nuk kanë patur ndryshime në numrin e tregjeve publike krahasuar me vitin 2019.
- (ii) Sfidë për bashkitë është kryerja e investimeve për riskonstruksionin e tregjeve për të siguruar përputhshmëri me standartet higjeno-sanitare, dhe çertifikimi i tregjeve.
- (iii) Rekomandohet të shtohet treguesi: *numri i njërive në tregje/1000 banorë, Nr i tregjeve të aprovuara për t’u ndërtuar në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (planin e rregullimit të territorit), si dhe në përputhje me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (neni 1/b), Vendimin Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 80/2. a: Kategoritë e përdorimit të tokës “Shërbime (S)” përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare.*
- (iv) Për arsye se një numër i vogël i bashkive kanë raportuar për shpenzimet për këtë program, nuk mund të formulohet një gjetje e përgjithësuar mbi ndryshimin e numrit të tregjeve funksionale.

3.9 Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore; Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe

⁷⁶ Raport i performancës BpE (IPA/BE, v.2019)

gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë; Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural. Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Përmirësimi i kuadrit ligjor, përafrimi me legjislacionin e BE dhe përfundimi i reformës të sistemit të këshillimit në bujqësi janë disa nga synimet afatmesme të politikave në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit, përfshirë hartimin dhe zbatimin e programeve të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, forcimin e monitorimit dhe inspektimit, forcimin e karantinës veterinarë dhe fitosanitare. Për të rritur eficiencën e shërbimeve vendore në bujqësi, dokumenti strategjik SNDQV dhe PV 2020-2023 ka të prioritetuar aktivitetet: (i) Rishikimin e ndarjes së kompetencave për mbrojtjen dhe administrimin e tokës mes qarkut dhe bashkive, (ii) Përcaktimin e kompetencave të NJVV-ve në informacionin dhe këshillimin bujqësor (PV 2020-2023, C1.7). Është organizuar konsultimi midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe NJVV mbi disa projektvendime lidhur me kompetencat e bashkive në fushën e informacionit dhe këshillimit bujqësor⁷⁷.

Në kuadër të programit “**Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor**”, janë organizuar 9 ditë trajnime për 290 gra fermere me synim zbutjen e parabarazisë dhe integrimin gjinor, si dhe janë mbështetur 4860 fermerë për aplikimet në skemat kombëtare të IPARD, nga të cilët rreth 18% gra fermerë. Në fund të vitit 2019, Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB) kanë qënë funksionale në 31 bashki⁷⁸. Në kuadër të agjendës së integritit evropian dhe monitorimit të performancës të NJVVT sipas matricës së treguesve, progresi për kapitullin 11 ‘Bujqësia dhe Zhvillimi Rural’ vlerësohet bazuar në shtatë tregues⁷⁹.

Në lidhje me **sigurinë ushqimore**, strukturat përkatëse të NJQV duhet të bashkëpunojnë me strukturat si Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve (ARSHVMB) dhe 12 drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) për të siguruar zbatimin e duhur të masave që lidhen me sigurinë ushqimore të produkteve. Në 2020, **në nivel kombëtar** janë kryer rreth 164,260 kontrolle dhe monitorime në fermat e kafshëve të gjalla dhe 93,701 inspektime nga Drejtoritë Rajonale të AKU në të gjithë territorin e vendit. Në kuadër të **reformës në shërbimin veterinar (miratuar në qershor 2020) “Veterinarë zyrtarë për çdo njësi”, u kontraktuan 293 veterinarë zyrtarë** (financimi për paga, sigurime dhe shërbime për veterinerët u mbulua nga buxheti i shtetit)⁸⁰. Është hartuar dokumenti Sektorial për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë.

Në 2020, është hartuar baza ligjore për masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (VKM dhe udhëzimi), disbursimi i fondeve për 5496 përfitues nga të cilët 963 gra (ose 18%); ka patur progres në zhvillimin e Sistemit të Informacionit për Tokën (LIS) dhe integrimin në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) për disa NJA në bashkine Durrës, Këlcyrë, Përmet, Lezhë, Malësi e Madhe dhe Tiranë (Kavajë/Golem), gjithsej një sipërfaqe 21,600 ha.

Dixhitalizimi i regjistrimit të tokës bujqësore ka vijuar gjatë 2020 në bashkinë Bulqizë (NJA Gjoricë), bashki Klos (NJA Suç), Bashkia Rrëshen (NJA Selitë dhe Kthellë).

77 Burim: Raporti i Monitorimit SNDQV (2021), MB;

78 Burim: Raporti Bashkitë në Proçesin e Integritit Evropian (2020)

79 Raporti Bashkitë në Proçesin e Integritit Evropian (projekt i financuar nga IPA (BE)): (i) trajnime të ndjekura nga punojnës vendore, (ii) % e alokimit të buxhetit për programin e bujqësisë (në % të buxhetit vjetor të bashkisë), (iii) numri i granteve të dhëna për fermerët nga buxheti i bashkisë, (iv) përmirësimi i sistemi të ujitjes dhe kullimit, (v) zbatimi i përfaqes LEADER për zbatimin e strategjisë së integruar të zhvillimit rural, (vi) tituj të pronësisë në bujqësi (AMTP) të rregjistruar (tregues kumulativ) në raport më totalin e titujve të pronësisë, (vii) ngritja e zyrave të këshillimit bujqësor në bashki, Sistemi ujitjes/kullimit i përmirësuar/mirëmbajtur kundrejt totalit të rrjetit ujitës / kullues të Bashkisë në vitin e raportimit (në %), ngritja e grupeve vendore “LAG” – local action group, me pjesëmarrje të bashkisë, fermerëve dhe organizatave civile.


80 Burim: Raporti i Monitorimit për vitin 2020 i MBZHR

Rezultatet e performancës së shërbimit

Performanca e shërbimit vlerësohet mbi treguesin 'ndryshimi në numër i çertifikatave të pronësisë të rregjistruara gjatë vitit të raportimit kundrejt vitit të mëparshëm.

Në vitin 2020, më pak aplikime janë kryer për rregjistrimin e çertifikatave të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP), në nivel mesatar 331 më pak krahasuar me vitin 2019.

Grafik 28: Çertifikata të pronësisë të rregjistruara (AMTP), 2020



Për treguesin, shtatë bashki kanë ofruar të dhëna të plota krahasuese për 2020 dhe 2019. Bashkia Elbasan ka lëshuar 2450 më pak çertifikata pronësie në 2020 kundrejt 2019, Bashkia Belsh (100 më pak kundrejt 2019), Bashkia Librazhd (178 më pak), Bashkia Bulqizë vetëm tre çertifikata, ndërsa Bashki Lezhë dhe Maliq kanë lëshuar një numër më të lartë të dokumentit të pronësisë (AMTP), përkatësisht Bashkia Lezhë 166 dhe Maliq 236.

Në nivel kombëtar, në vitin 2019, shkalla mesatare e rregjistrimit të akteve të titujve të pronësisë (tokë bujqësore) kundrejt numrit total të tyre ka qënë rreth **35.2%** (n=58).

Shpenzimet e programit “Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve” - 04220

Programi në fakt përfshin aktivitete të rëndësishme që lidhen me përditësimin e informacionit bazë të çdo parcele të tokës bujqësore, i cili furnizon edhe programet e tjera, por edhe me administrim dhe mbrojtjen e tokave bujqësore, kontrollin ushqimor, mbrojtjen e konsumatorit.

Por, vetëm 50% e bashkive raportojnë shpenzime për këtë program, pra kanë ngritur strukturat për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht më 19% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Shpenzimet e programit zënë mesatarisht 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë. Tek Bashkia Patos shpenzimet e programit paraqiten me përqindjen më të lartë (3%).

Grafik 29: Buxheti i programit (në % të buxhetit total)



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Peshë e rëndësishme në program janë pagesa e personelit (94%).



Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Për programin Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e kosnumatorëve, kemi të dhëna vetëm për bashkinë Kavajë.

Në sondazh, përgjigjet e marra nga banorët e kësaj bashkie, për këtë shërbim janë 87, nga të cilat **62%** (54 persona) shprehen se janë **dakort për rritjen e shpenzimeve**, **23%** (20 persona) janë **dakort me nivelin aktual të shpenzimeve** për këtë shërbim, **11%** (10 persona) kanë vendosur të përgjigjen me “nuk e di” dhe vetëm **3%** (3 persona) kanë votuar për uljen e shpenzimeve.

Lidhur me performancën e shërbimit, rreth **41%** e të anketuarve (36 persona) të tyre i përkasin kategorisë “neutral”, **30%** (26 persona) janë **të pakënaqur** me cilësinë e performancës së këtij shërbimi, **15%** (13 persona) janë përgjigjur me “nuk e di” dhe **14%** (12 persona) janë **të kënaqur** me cilësinë e ofruar të këtij shërbimi.

Gjetje dhe rekomandime

- Pak të dhëna janë ofruar nga bashkitë e kampionit (vetëm 7 bashki) dhe nuk mund të nxirren të dhëna përgjithësuëse. Referuar të dhënave të Raportit të Performancës Bashkitë në procesin e integritimit Evropian, shkalla mesatare e AMPT të rregjistruara ka qënë rreth 35%).

- ii. Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 19% krahasuar me v.2019 dhe përbëjnë mesatarisht rreth 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë. Pagat për personelin përbëjnë rreth 94% të fondit të programit.
- iii. Përshpejtimi i procesit të regjistrimit të AMTP është një detyrim dhe rekomandim në kuadër të reformave për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe në kuadër të integritimit evropian.
- iv. Treguesi për certifikatat e pronësisë së tokës bujqësore (AMTP), në këtë raport, evidenton ndryshimin/ rezultatet e procesit të regjistrimit (krahasim ndërmjet vitit të raportimit dhe vitin të mëparshëm), por nuk jep indicie të progresit të regjistrimit kundrejt numrit total të titujve të pronësisë. Përpos këtij evidentimi, *rekomandohet të shtohet treguesi: 'Numri kumulativ AMTP të regjistruar kundrejt numrit total të titujve të pronësisë', dhe krijimi i fondit për mbrojtjen e tokës bujqësore (Ligj nr. 20/2020 Për perfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH (Neni 10/1. e: Të krijojë në buxhetin e tij fondin për mbrojtjen e tokës bujqësore me burime nga tatimi për tokën bujqësore (fondi të jetë jo më pak se 40 për qind e fondit të krijuar).*

3.10 Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla; Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njërive të vetëqeverisjes vendore.

Referenca ligjore dhe politika sektoriale

Kuadri ligjor i shërbimit bazohet në Ligj 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligj nr. 111/2012, i datës 15.12.2012 “Për administrimin e integruar të burimeve ujore”, i ndyshuar, (Ligji 6/2018), Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”, i cili është hartuar në mbështetje të procesit të decentralizimit të përgjegjësisë të ujitjes midis qeverisë qendrore dhe bashkive/OPU dhe dokumenti i politikës Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019–2031 dhe Plani i Veprimit.

Funksioni për administrimin dhe menaxhimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit u transferua tek NJQV-të në vitin 2015⁸¹ nga Drejtoritë Rajonale të Ujitjes dhe Bordet e Kullimit në 61 bashkitë e vendit, i shoqëruar me transferimin e punonjësve dhe bazës materiale; Numri gjithsej i punonjësve të transferuar ishte 267 ose mesatarisht 4-5 punonjës për NJVV⁸². Synimi është sigurimi i administrimit më eficient të burimeve dhe mirëmbajtje më e mirë e rrjetit vaditës dhe kullues për të eliminuar përmytjet dhe për të rritur sipërfaqen e tokës më infrastrukturë të përshtatshme ujitëse.

Përmirësimi i efikasitetit në administrimin e rrjeteve të ujitjes dhe kullimit është prioritet i parashikuar edhe në PV 2020-2023 SNDQV (C1.8). Në këtë drejtim, në periudhën 2019-2020, progres është arritur me hartimin e dokumentit strategjik Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit (miratuar me VKM nr. 345, datë 22.5.2019⁸³) dhe zhvillimin e bazës ligjore: Urdhër nr. 370, datë 11.6.2019 “Për miratimin e statutit tip të Organizatës së Përdoruesve të Ujit”, Urdhër nr. 535, datë 27.9.2019 “Për miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor”, Udhëzim nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat

81 Urdhër i Kryeministrit nr.127, datë 16.09.2015 «Mbi masat për decentralizimin e funksioneve të reja»

82 Burim: Raport në Performancës e funksioneve të reja të decentralizuara (O. Shapo, dldp, 2018)

83 Tregues të performancës: mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi të NJVV; nevojat për ujë për ujitje që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar; Fonde për rehabilitim dhe rikonstruksion të infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja në zonat e banuara, etj.


dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, Urdhër nr. 97, datë 30.12.2019 “Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit”. Siguria e digave të rezervuarëve të ujitjes që administrohen nga bashkitë problem është një problem i evidentuar që kërkon vëmendje dhe burime teknike dhe financiare⁸⁴.

Sipas ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”, bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje dhe që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar. Gjithashtu, brenda zonës së vet të shërbimit, bashkia pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitëse, shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe të kullimit, rehabiliton dhe rindërton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja në zonat e banuara, dhe detyra të tjera.

Në nivel kombëtar, në periudhën 2020-2021, investimi në ujitje është realizuar nëpërmjet 67 projekteve, gjithsej 3.6 miliard lekë; **59 projekte i përkasin bashkive, me impakt – 10,000 ha tokë më infrastrukturë ujitëse të përmirësuar**, ndërsa për vitin 2021 parashikohet një përmirësim në 8,000 ha.

Në mbrojtje nga përmytjet është ndërhyrë, me mbështetjen e 15 projekteve (2020-2021), në segmentet më të rrezikuara në lumenjtë Vjosë, Seman, Drinos, Drin i Zi, Shkumbin, Osum, duke mundur rehabilitimin/ndërtimin e rreth 15 km argjinatura të mbrojtjes nga përmytja dhe është sistemuar rreth 10 km kanale të ujërave të larta. Zonat ku janë realizuar ndërhyrjet i përkasin bashkive Dibër, Durrës, Lushnje, Gjirokastrë, Mallakastër, Fier, Tepelen, Berat, Elbasan dhe Kurbin⁸⁵.

Grafik 30: Financimi për vaditjen dhe kullimin, 2020



Burim: Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020 (MBZHR)

Megjithë investimet e kryera, fermat e vogla dhe të fragmentuara e bëjnë sistemin e ujitjes të vështirë për t'u menaxhuar si dhe ndërtimet e paligjshme mbi sistemet e ujitjes. Siguria e digave të rezervuarëve të ujitjes që administrohen nga bashkitë është një problem i evidentuar që kërkon vëmendje dhe burime teknike dhe financiare.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Treguesit e performancës së shërbimit për vaditjen dhe kullimin nga NJVV janë pesë: (i) Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %); (ii) Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %);(iii) Kosto mesatare për mirëmbajtjen e 1 km linear kanal vadites dhe kullues (buxheti/Km linear); (iv) Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar); (v) Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar).


84 Burim: Raporti i Monitorimit SNDQV (MB, 2021)

85 Burim: Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020 (MBZHR)


Treguesi: Rrjeti kullues dhe vaditës i mirëmbajtur nga bashkitë

Në vitin 2020, **shkalla e mirëmbajtjes/pastrimit të rrjetit kullues** të bashkive kundrejt totalit të rrjetit që i përket bashkisë ndryshon në një diapazon të gjerë siç paraqitet në grafikun më poshtë, por **mesatarisht ka qënë në nivelin 31%**, për bashkitë raportuese të kampionit krahasuar, me 33% të raportuar për vitin 2019 (n=25).


Grafik 31: Rrjeti kullues i mirëmbajtur kundrejt rrjetit total të administruar nga NJVV, 2020 (në %)



Grafik 32: Rrjeti kullues i mirëmbajtur (ndryshimi 2020/2019)




Grafik 33: Rrjeti vaditës i mirëmbajtur kundrejt rrjetit total të administruar nga NJVV, 2020



Në 2020, **shkalla mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit të ujitjes**, nga bashkitë raportuese të kampionit (N=29/36), ka qënë në nivelin **36%**, krahasuar me 37% për vitin 2019 (ose 1 p.p. më pak).


Grafik 34: Mirëmbajtja e rrjetit vaditës nga NJVV (ndryshimi 2020 / 2019)



Treguesi: Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me ujitje dhe kullim (ndryshimi në vit) (standart shërbimi)

Bashkitë raportojnë se në vitin 2020, është rritur sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me ujitje me 16,731 ha në krahasim me vitin 2019 (n=16). Gjithashtu, bashkitë raportojnë rritje të sipërfaqes së tokës bujqësore të mbuluar me rrjetin e kullimit funksional me 6,972 ha kundrejt vitit 2019 (n=13); të dy treguesit janë në kategorinë standart.

Grafiku 35: Mirëmbajtja e sistemit të vaditjes dhe kullimit, ndryshimi 2020 / 2015



Shpenzimet e programit “Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit” - 04240


Funksioni për administrimin dhe menaxhimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit u transferua tek NJQV-të në vitin 2015 nga Drejtoritë Rajonale të Ujitjes dhe Bordet e Kullimit në 61 bashkitë e vendit, i shoqëruar me transferimin e punonjësve dhe bazës materiale. Pra, burim kryesor i financimit per programin janë transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat nga tarifat e shërbimit. Por, bashkitë mund të financojnë për shërbimin edhe nga burimet e tjera të veta.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht më 11% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Shpenzimet e programit zënë mesatarisht 3% të shpenzimeve total të bashkisë. Mbi mesataren janë 42% e bashkive, midis tyre bashkitë Cerrik, Maliq (7%), Finiq, Libohovë, Këlcyrë (6%).



Treguesi eficientë: 000 lek kosto korente/km rrjet ujtes dhe kullues të mirembajtur

Referuar treguesit kosto-eficientë, mbi 400 mijë lek/km kanal të pastruar, janë bashkitë Malësia e Madhe, Shijak dhe Patos, ndërsa me tregues më të ulët nën 100 mijë lek/km janë rreth 50% e bashkive (8 bashki nga 16 të bashkive raportuese). Në krahasim me vitin 2015 (kosto 131 mijë lek), disa bashki shpenzojnë më pak ndërsa disa bashki shpenzojnë më shumë, ndërsa në krahasim me vitin 2016-2018⁸⁶ (kosto 38-39 mijë lek), aktualisht kosto e mirëmbajtjes ka qënë më e lartë në vitin 2020.


Grafik 36: Kosto për mirëmbajtjen e 1 km të rrjetit vaditës dhe kullues të bashkisë, 2020



86 Studim mbi performancën e funksioneve të reja (O. Shapo, 2018)

Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)


Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes kanë peshë në program (zene 48%). Vlen të përmenden disa bashki, ku investimet kanë peshë të konsiderueshme si bashkia Librazhd (91%), Himarë dhe Dibër (87%), Fushë-Arrëz (82%) dhe Mirdita (77%).



Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Rreth 47% e të anketuarve (ose 1,477 persona) shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë shërbimin e administrimit të ujëtjes dhe kullimit, ndërsa 41% e tyre (1,285 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimeve nga ana e bashkive për këtë program. Ndërsa, vetëm 5% e popullsisë (154 persona) ka votuar për uljen e shpenzimeve.

Grafik 37: Çfarë mendoni për shpenzimet e shërbimit vaditje dhe kullimi?



Lidhur me performancën e shërbimit, rezultatet e sondazhit tregojnë se, rreth 37% e të anketuarve (1,120 persona) shprehen të kënaqur, ndërsa 26% (796 persona) e vlerësojnë jo mirë performancën e tij dhe 37% janë neutralë/ose “nuk e di”. Bashkitë të cilat kanë shifrat më të larta të qytetarëve të kënaqur me shërbimin ndaj totalit të të intervistuarve janë: Vau Dejës me 72% (62 persona), Puka me 57% (40 persona), Dropulli me 55% (32 persona) dhe Kolonja me 53% (77 persona), ndërsa bashkia që shfaqet e pakënaqur me nivelin e performancës së këtij shërbimi, në masën më të madhe, është Bashkia Durrës me 57% (97 persona).

Lidhur me **gadishmërinë për të paguar më shumë taksa/tarifa për ofrimin e shërbimit**, vihet re se pjesa më e madhe **63% e të anketuave (5,318) nuk janë dakort lidhur me rritjen e mundshme të taksave dhe tarifave**, ndërsa 37% e tyre shprehet pozitivisht për të paguar më shumë përkundrejt shërbimit më të mirë.

Gjetje dhe rekomandime

- **Reforma Administrative dhe Territoriale ka patur impakt pozitiv në përmirësimin e ushtrimit të shërbimit për infrastrukturën e vaditjes dhe kullimit.** Bashkitë kanë përmirësuar performancën e shërbimit lidhur me mirëmbajtjen e rrjetit të vaditjes dhe kullimit nga vit në vit dhe në krahasim me vitin 2015/2016 (vit i transferimit të funksionit nga QQ në vetëqeverisjen vendore).
- Ka skema të ujitjes dhe kullimit të cilat janë marrë sipas inventarit por nuk ekzistojnë. Kërkohej bashkëpunim institucional me Drejtoritë Rajonale të Kullimit dhe bashkive për auditimin dhe përditësimin e inventarit të rrjeteve.
- Një pjesë e bashkive nuk kanë vendosur shpenzime shtesë nga buxhetet e tyre për realizimin e shërbimit.
- Referuar analizës kosto-efiçencë, 50% e bashkive raportuese kanë shpenzuar më pak se 100 mijë lek për 1 km rrjet të mirëmbajtur (pastruar), ndërsa 3 bashki (19% e bashkive raportuese (n=16) kanë një tregues efiçencë mbi 400 mijë lek/km kanal të pastruar (131 mijë lek kosto e mirëmbajtjes së 1 km rrjet kanal në vitin 2015)
- Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 11% krahasuar me v.2019 dhe përbëjnë rreth 3% të shpenzimeve totale të bashkisë. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes kanë peshë në program duke përbërë rreth 48% të buxhetit të programit.
- Rekomandohet rritja e investimeve për shërbimin nga buxheti vendor krahas fondit të transfertës së kushtëzuar.
- 47% e të anketuarve, në kuadër të sondazhit, (1,477 persona) shprehen se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për shërbimin e ujitjes dhe kullimit.
- Lidhur me sigurinë e digave, MBZHR rekomandon: krijimin/konsolidimin pranë çdo bashkie të grupit përkatës për ruajtjen dhe monitorimin e sigurisë së digave, trajnimin e stafit që mbulon monitorimin e sigurisë së digave sipas akteve ligjore dhe nënligjore, grantet e pakushtëzuara për bashkitë dhe investimet për rehabilitimin e digave, të kenë prioritet dhe të jenë zë më vetë në buxhetin e bashkisë⁸⁷.
- Bazuar mbi disa norma shërbimi sipas strategjisë mund të vendoset dhe treguesi 'numri i punonjësve specialistë/sipërfaqe toke bujqësore, ndërsa bazuar edhe në objektivat strategjike mund të vendosen treguesi (i) për mbulimin e kostos së shërbimit nga tarifat, dhe (ii) të ardhura të planifikuara/të ardhurave të realizuara; gjithashtu rekomandohet ndarje e buxhetit /shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit vaditës dhe rrjetit kullues.

3.11 Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; Administrim i fondit pyjor dhe kullor publik; Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje pemësh; Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë; Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes.

⁸⁷ Raporti i Monitorimit SNDQV (MB, 2021)

Referenca ligjore dhe politika sektoriale

Funksioni për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave u decentralizua ndërmjet pesë funksioneve të tjera në vitin 2015⁸⁸⁹, përfshirë transferimin e aseteve, personelit dhe buxhetin për fondin e pyjeve si dhe rekomandimin për zhvillimin dhe plotësimin e bazës ligjore dhe udhëzimeve për menaxhimin efektiv të funksionit dhe të shërbimeve përkatëse, qartësimin të kompetencave dhe kapaciteteve të monitorimit. Bashkitë kryejnë funksione manaxheriale dhe operacionale në administrimin e fondit pyjor dhe kullor brenda kufijve territorialë administrativë të saj. Bashkia është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor publik, përfshirë menaxhimin, kontrollin / inspektimin, shërbime teknike dhe këshillimi, për fondin kombëtar pyjor në pronësi; bashkitë ndërveprojnë insitucionalisht me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve⁹⁰¹ (AKP) /4 drejtori rajonale dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Rritja e efikasitetit të shërbimeve vendore për administrimin e fondit pyjor dhe kullor është prioritet i SNDQV dhe PV 2020-2023 (C1.7). Dy masa kryesore të planifikuara për arritjen e objektivit janë: (i) Mbështetje me asistencë teknike dhe financime për hartimin e planeve të reja të menaxhimit të pyjeve e kullotave në nivel vendor; dhe (ii) Dhënia e kompetencave për sanksione administrative direkte për bashkitë në lidhje me shkelje në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve e kullotave⁹². Në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, nën Kriterin III “Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit”, vlerësimi i progresit për menaxhimin e pyjeve bazohet në analizën e disa treguesve⁹³.

Në 2020, për mbrojtjen e pyjeve është miratuar nga Parlamenti Ligj 57/2020 “Për Pyjet”, i cili parashikon krijimin e kufijve dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar, dokumentin hartimin e Dokumentit të politikave për pyjet (DPP) dhe Programin Kombëtar të Pyjeve (PKP).

Numri i punonjësve në strukturën përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor (a) një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta; b) një specialist pyjesh për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulëta dhe shkurret sipas ligjit. Për inspektimet, rol kanë inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet dhe strukturat komunitare në fshat.

88 Administrimi i rrejtësive dhe kullorëve, administrimi i rrugëve dytësore dhe terçiale, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, arsimiti parauniversitar, shërbimi social (qendrat rezidenciale)

89 Urdhër i KM (nr.127, datë 16.09.2015) në masat për zbatimin e SNDQV

90 AKP është krijuar me VKM Nr. 570, datë 17.7.2019. “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”


91 AKP është një autoritet që garanton performancën dhe efikasitetin e sektorit, përcakton standarde dhe metodologji për aktivitetet e sektorit, angazhon palët e interesuara dhe krijon një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e informacionit dhe transferimin e njohurive.

92 Raporti i Monitorimit të SNDQV nuk jep informacion mbi progresin lidhur me aktivitetet e parashikuara në PV

93 Raporti Bashkitë në Proçesin e Integritimit Evropian (projekt i financuar nga IPA (BE)): Plan Veprimi vendor për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor, Numri i specialistëve të administrimit të fondit pyjor në bashki në raport me numrin e specialistëve sipas kërkesave të legjislativitetit, krijimi i database mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet mbi fondin pyjor dhe kullor të Bashkisë.


Rezultatet e performancës së shërbimit

Grafik 38: Numri i punonjësve për 1000 m² pyje, 2020




Në 2020, mesatarisht, **numri i punonjësve për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve** nga NJVV (kërkesë ligjore për shërbimin (Ligj 57/2020 “Për pyjet”), ka qënë **1.9 punonjës /ha**, krahasuar me 1 punonjës/ha (shkalla mesatare për vitin 2019), ose **0.39 punonjës/1000 m²**⁹⁴ në vitin 2018.

Grafik 39: Numri total i punonjësve të shërbimit pyjor dhe kullësor në NJVV, 2020



Në 2020, janë kryer gjithsej 10,475 kontrolle/inspektime nga punonjës të shërbimit pyjor dhe kullësor të NJVV (n=26).


Grafik 40: Inspektime të kryera nga shërbimi i fondit pyjor dhe kullësor të NJVV, 2020



Numri i inspektimeve për ha është rritur nga 13.8 mesatarisht në 2019 në 14.58 inspektime/ha të realizuara gjatë vitit 2020. Bashkia Delvinë, Skrapar dhe Cërrrik kanë kryer më shumë inspektime për ha krahasuar me bashkitë e tjera.


94 Raport “Performanca e Bashkive në administrimin e funksioneve të transferuara, O.Shapo (2018)

Grafik 41: Numri i inspektimeve për 1 ha (ndryshimi 2020 / 2019)



Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullor në 2020 rezulton të jetë ulur me 2.56 ha krahasuar me vitin 2019, përkatësisht bashkitë Maliq, Bashkia Klos, Bashkia Has dhe bashkia Patos kanë raportuar sipërfaqe më të vogël.

Grafik 42: Sipërfaqe e fondit pyjor dhe kullor sipas NJVV (2020/2019)



Analiza në kuadër të Raportit të vlerësimit (2018) të disa funksioneve të reja transferuara në vetëqeverisjen vendore në 2015⁹⁵, tregoi se bashkitë⁹⁶ kishin harxhuar më shumë për menaxhimin e fondit pyjor në 2018 krahasuar me 2016 (197 lekë/ha për administrimin e pyjeve në 2018 kundrejt 104 lekë/ha në 2016).

Shpenzimet e programit “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”, 04260

Burim financimi për “Administrimin e pyjeve dhe kullotave” është transferta e pakushtezuar sektoriale. Sipas ligjit bashkia mbledh/perfiton të ardhurat nga tarifat e përcaktuara me VKM për veprimtaritë që zhvillohen në sektorin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të saj. Pjesë tjetër e financimit mund të jenë dhe të ardhurat nga burimet e tjera të veta të bashkisë.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)


Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht më 18% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Programi zë një përqindje të vogël ndaj totalit të buxhetit të bashkisë, mesatarisht 1%. Janë rreth 56% e bashkive ku shpenzimet e programit zënë mbi 1% të totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe bashkitë me përqindje më të lartë 4-6%, janë Kolonjë, Klos, Fushe Arrëz, Malësi e Madhe dhe Pukë.


95 Raport mbi Performancën e disa funksioneve të reja të vetëqeverisjes vendore (dldp, O.Shapo, 2018)

96 Kampioni n=15



Shpenzimet e Personalit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)


Pagesat e punonjësve zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve të programit (mesatarisht 82%). Në nivele të ulta janë dhe investimet, pra për veprimtarinë ripërlëzuese dhe rehabilitimet e sipërfaqes pyjore dhe kullimore – që përbëjnë vetëm 8%.



Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Për programin Administrim i pyjeve dhe kullotave, u mundësuan të dhëna vetëm nga 3 bashki: Fushë Arrëz, Kavajë dhe Skrapar. Rezultatet e sondazhit evidentojnë se për pyetjen lidhur me nivelin aktual të shpenzimeve, nga 211 të anketuar, rreth **39%** e tyre (82 persona) shprehen se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, **36%** (76 persona), janë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve dhe **17%** (35 persona) janë të mendimit se duhen ulur shpenzimet. Në analizën e preferencave të secilës bashki, vihet re se bashkia me numrin më të lartë të përgjigjeve për një rritje të financimit të këtij programi është Fushë Arrëz në masën 60% (46 persona), ndërsa bashkia me numrin më të lartë të banorëve të cilët janë dakort me nivelin aktual të financimit për këtë program është Skrapari në masën 49% ose 23 persona. Ndërsa, sa i takon uljes së shpenzimeve, këtë opsion në masë të madhe e ka përzgjedhur bashkia Kavajë, krahasimisht me bashkitë e tjera, në masën 25% (22 persona).


Grafik 43: Çfarë mendoni lidhur me shpenzimet për programin “Administrim i pyjeve dhe kullotave”?



Pyetjes se si e gjykojnë qytetarët performancën e shërbimit, rezultatet e sondazhit tregojnë se, rreth **36%** e të anketuarve (69 persona) janë **të pakënaqur** me cilësinë e ofruar, **29%** e të anketuarve ose 55 persona kanë përzgjedhur opsionin “**neutral**”, **25%** e të anketuarve ose 48 persona janë **të kënaqur** me cilësinë e këtij shërbimi dhe vetëm 10% kanë përzgjedhur opsionin “nuk e di”.

Bashkia Fushë-Arrëz ka patur 45% të të anketuarve (ose 35 persona) “të pakënaqur” krahasuar me 40% (ose 31 persona) “të kënaqur” me nivelin e performancës së këtij shërbimi, duke u renditur dhe si bashkia me numrin më të lartë të të anketuarve që janë të kënaqur me këtë shërbim, krahasimisht me rezultatet e dy bashkive të tjera.


Grafik 44: Mendimi i banorëve për performancën e programit “Administrim i pyjeve dhe kullotave”



Sa i takon pyetjes lidhur me mundësinë për të paguar më shumë taksa ose tarifa, rezultatet janë përftuar dhe grupuar për disa shërbime së bashku si p.sh. për mbrojtjen nga zjarri, parkimin, përdorimin e hapësirave publike dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave.

Nga rezultatet, vëmë re se rreth **62%** (5,314 persona) janë **kundër opsionit për të paguar më shumë taksa**, ndërsa **38%** (3,249 persona) janë **dakort**. Ndër bashkitë të cilat nga rezultatet paraqiten jo të gatshme për të paguar më shumë taksa janë: Belshi në masën 100% (4 persona), Poliçani në masën 100% (2 persona), Libohova në masën 79% (33 persona), Skrapari në masën 78% (21 persona), Kuçova në masën 76% (246 persona), etj. Bashkitë të cilat janë pro opsionit për të paguar më shumë taksa lidhur me këtë shërbim, janë: Himara në masën 67% (94 persona), Bulqiza në masën 62% (197 persona) dhe Maliqi në masën 57% (109 persona), etj.

Grafik 45: Mendimi i qytetarëve për të paguar më shumë taksa për shërbime cilësore



Gjetje dhe rekomandime

- Në 2020, **numri i punonjësve për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve nga NJVV është rritur kundrejt vitit 2019**, si dhe krahasuar me nivelin e vitit 2016 (0.39 punonjës /1000 m2 pyje)⁹⁷. **Referuar kërkesave të ligjit për pyjet, rezultojnë se një pjesë e bashkive kanë numër më të vogël të punonjësve/specialist të pyjeve**⁹⁸.
- Sipërfaqe e fondit pyjor dhe kullor është ulur pak në 2020 krahasuar me vitin 2019; shkak mund të jenë zjarret.
- Bashkitë duhet të rrisin numrin e punonjësve/specialistëve të pyjeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe të respektojnë kriteret e përcaktuar në bazën ligjore në proceset e rekrutimit të punonjësve të rinj.
- Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 18% krahasuar me v.2019 dhe përbëjnë rreth 1% të buxhetit të bashkisë; Me peshë më të lartë, rreth 4-6%, janë bashkia Kolonjë, Klos, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe dhe bashkia Pukë.
- Pagesat e punonjësve zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve të programit (mesatarisht 82%) ndërsa investimet rreth 8% të buxhetit të programit.
- **39%** e të anketuarve shprehen se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, **36%** janë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve.
- Referuar pyetjes mbi performancën e shërbimit, rezultatet ishin **36%** e të anketuarve ishin të pakënaqur me cilësinë e ofruar, **29%** “neutral”, **25%** e të anketuarve ishin të kënaqur me cilësinë e shërbimit.

Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore; Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore.

97 Raport mbi Performancën e Bashkive në administrimin e funksioneve të transferuara (dldp, O.Shapo, 2018)

98 Ligj 57/2020 “Për pyjet”

3.12 Ndërtimi, Rehabilitimi dhe Mirëmbajtja e Rrugëve Lokale dhe Transporti Publik

Referenca ligjore dhe politika sektoriale

Në nivel të qeverisjes qendrore, zhvillimi i infrastrukturës rrugore për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit është prioritetizuar në dokumente strategjike si Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020⁹⁹, Strategjia për Sigurinë Rrugore dhe Strategjia për Aplikimin e Sistemeve Inteligjente në Transportin Rrugor¹⁰⁰. Ndër prioritetet kombëtare dhe rajonale afat-mesme janë investimet në rrjetin e transportit 'core' dhe korridoret/akset dhe zhvillimin e rrjetit të transportit ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Në nivel vendor, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor sekondar dhe rrugëve lokale (urbane dhe rurale ndërmjet fshatrave (ose terciare), si aset publik, është funksion i NJVV bazuar në Ligj 139/2015, neni 23, pika 4, dhe Urdhër i Kryeministrit (nr. 127/2015) mbi masat për zbatimin e SNDQV dhe transferimin e gjashtë (6) funksioneve, një nga të cilët është funksioni i menaxhimit të rrugëve të kategorisë II dhe III, si dhe VKM nr. 915/2015 për transferimin e rrjetit rrugor rural dhe aseteve nga Këshilli i Qarkut tek bashkitë. Normat dhe karakteristikat e rrugëve rregullohen me ligj nr.8378/1998 "Kodi rrugor i RSH".

Komponentë të funksionit dhe shërbimeve të ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale, përfshijnë ndër të tjera i) klasifikimin e rrjetit rrugor, ii) krijimin e hartave të rrugëve dhe kadastrës së rrjetit rrugor në administrimin e NJVV, iii) autorizimin dhe lejet për ndërtimin dhe mbrojtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, kanalet e ujit, iv) linjat e energjisë, telekomunikacionit, deklasifikimin e rrugëve lokale, v) instalimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit/sinjalistikës rrugore dhe plotësimin e detyrimeve për sinjalistikën rrugore, vi) identifikimin e dëmtimeve në ndërtimin dhe mbrojtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, vii) përcaktimin e normave për përmasat, karakteristikat dhe vendosjen e mjeteve të reklamimit¹⁰¹.

Transporti Publik

Ligji Nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportin rrugor", përcakton kategoritë e linjave që administrohen nga MTI dhe NJVV-ja. Transporti publik është funksion i NJVV në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (Ligj 139/2015, neni 23, pika 6).

Synimet e politikës të përcaktuara në SNDQV dhe PV 2020-2022 (ref. C1.5) për rritjen e efikasitetit të transportit synojnë i) rishikimin e rolit të këshillit bashkiak dhe kryetarit në përcaktimin e organizimit të transportit qytetas dhe ndër-qytetas, ii) rishikimin e ligjit për transportet rrugore dhe përcaktimi i autoritetit rregullator dhe monitorues të NJVV, dhe (iii) përgatitjen e kuadrit rregullator për kompesimin e tarifave të transportit publik për kategori të veçanta¹⁰².

Në kuadër të procesit të integritit evropian, vlerësimi i performancës së NJVV në fushën e transportit publik është pjesë e kapitullit 14, i cili mbi bazën e disa treguesve lidhur me rritjen e sigurisë rrugore (8 tregues), përmirësimin e transportit publik (2 tregues), dhe promovimi i ecjes në këmbë dhe me biçikleta (3 tregues¹⁰³).

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore: Kontraktimi i shoqërive private të

99 Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 16.11.2016

100 URDHËR Nr. 185, datë 18.6.2020 (Fletore Zyrtare nr. 123, dt 02/07/2020 <http://qzb.gov.al/eli/urdher/2020/06/18/185>)

101 Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore (2019), EU funding, URI (AL)

102 Draft Raporti i Monitorimit të SNSDQV 2021, C1.5

103 Raporti Vlerësimi i performancës së NJVV në procesin e Integritit Evropian (projekt IPA (BE)): Plan i transportit publik të bashkisë i publikuar në stacione të autobusëve, fondi i Bashkisë për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit publik në raport me fondin total për sektorin e transportit në vitin e raportimit (në %), km rrugë për biçikleta në zonat urbane të Bashkisë në raport me km rrugë totale në zonat urbane, fushata promovimi të ecjes në këmbë dhe me biçikleta të ndërmarra nga Bashkia.


transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal; Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshëtisë së shërbimeve etj.); Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit; Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Treguesi: Rrjeti i rrugëve urbane dhe rurale në km (ndryshimi 2020/2019)


Në 2020, është raportuar një **ndryshim i rrjetit rrugor (total)**, që përfshin si rrjetin urban ashtu edhe rrjetin rural i cili administrohet nga bashkia, në një nivel të shtuar **159 km** në krahasim me vitin 2019 (N=33/36 bashki). Bashkitë me rritje të rrjetit rrugor kanë qënë Cërrik (+34 km), Bulqizë (223 km), Kolonjë 65 km, ndërsa Bashkia Himarë (-49 km), në 2020.

Grafik 46: Rrjeti rrugor urban/rural (në km, ndryshimi 2020/2019)



Treguesi: Rrugë të asfaltuara kundrejt totalit të rrjetit rrugor të administruar nga bashkia

Grafik 47: Rrjeti rrugor urban/rural i asfaltuar kundrejt rrjetit total rrugor, 2020




Ndonëse, disa bashki kanë raportuar kryerjen e investimeve në ndërtimin e rrugëve në 2020, pjesa e rrjetit rrugor të asfaltuar nga bashkitë raportuese rezulton të jetë deri në 89.3% (Bashkia Tepelenë), por shkalla **mesatare e rrjetit të asfaltuar ka qënë 19.1% e rrjetit rrugor sekondar/tercial** (N=11 nga 36 bashki të kampionit).

Treguesi: Rrugë të mirëmbajtura kundrejt totalit të rrjetit rrugor

Treguesi i performancës (cilësi/mbulim i shërbimit) i **mirëmbajtjes së rrugëve i shprehur në përqindje kundrejt gjatësisë së rrjetit rrugor** (urban/rural) për bashkitë raportuese është **50.4%** mesatarisht në 2020 (N=14 nga 36 bashki të kampionit).


Grafik 48: Rrugë të mirëmbajtura kundrejt totalit të rrjetit rrugor, urban/rural, 2020 (në %)




Grafik 49: Rrugë të mirëmbajtura nga NJVV (ndryshimi 2016-2020)

Shkalla e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor nga bashkitë është rritur nga 32% (2016) në 50% (2020).

Në 2020, nga të dhënat e raportuara rezultojnë që **performanca e shërbimit të transportit publik** në lidhje me **dimensionin 'ndryshimi i numrit të linjave interurbane të transportit publik** kundrejt 2019, për rreth 78% të bashkive të kampionit është në të njëjtin nivel. Bashkia Tepelenë dhe Bashkia Pukë ka shtuar 2 linja interurbane në 2020.




Grafik 50: Linjat interurbane në NJVV (ndryshimi në numër 2020/2019)



Numri i automjeteve të transportit publik ndërurban për 67% të bashkive të kampionit ka qënë në të njëjtin nivel me vitin 2019, ndërsa tre bashki kanë shtuar mjetet e transportit publik, si: Bashkia Malësi e Madhe (10 mjete), Bashkia Shkodër dhe Pukë (2 mjete).

Grafik 51: Numri i automjeteve të transportit publik ndërurban (ndryshimi në numër 2020/2019)



Shpenzimet e programit “Rrjeti rrugor” (04520)

Me VKM 915/2015 u transferuan pranë bashkive rrugët rurale rajonale dhe të ish komunave (rrugë dytësore dhe terciare). Sipas Kodit rrugor, tashmë të gjitha rrugët në territorin e bashkisë quhen rrugë urbane dhe lokale. Për rrugët e transferuara në 2015, bashkitë financohen nga transferta e pakushtëzuar sektoriale; ky program financohet edhe nga burimet e veta të bashkisë.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 36% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Shpenzimet e programit zënë mesatarisht 12% ndaj totalit të shpenzimeve të bashkive. Bashkia Kamëz konsideron si prioritet rrugët, sepse zënë 41% të totalit të shpenzimeve. Mbi mesataren 12%, shpenzimet për programin evidentohen në rreth 39% të bashkive, ndërsa në vitin 2019 kanë qënë në nivelin 8.56% për mirëmbajtjen e rrugëve¹⁰⁴.

Grafik 52: Shpenzimet e programit për rrugët nën administrimin e Bashkive, 2020



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Shpenzimet për investime zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve të programit (mesatarisht 69%). Por, ka bashki ku investimet kanë patur peshë më të madhe se mesatarja, si Kamëz (99%), Cërrik 96%, Belsh dhe Korçë (88%).




104 Raport i Performancës së bashkive – BpE (BE/IPA, 2020)

Rezultatet e sondazhit me qytetarët


Në përgjigje të pyetjes nëse duhet shtuar buxheti i NJVV për shërbimin e mirëmbajtjes dhe ndërtimit të rrjetit rrugor të administruar nga bashkitë, **rreth 56%** e të anketuarve (2,487 persona) shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa **33%** e tyre (1,441 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit nga ana e bashkisë për këtë shërbim (funksion).

Grafik S3: Mendimi i qytetarëve mbi nivelin e shpenzimeve për “rrjetin rrugor sekondar dhe tercial”



Në përgjigje të pyetjes, nëse janë të kënaqur me performancën e shërbimit gjatë vitit 2020, rezultatet e sondazhit tregojnë se, rreth **41%** e të anketuarve (ose 1,763 persona) shprehen të pakënaqur, ndërsa **29%** (1,256 persona) e vlerësojnë “të kënaqur”.

Grafik S4: Mendimi i qytetarëve mbi performancën e shërbimit “rrjeti rrugor”



Për programin “Transport publik” (04570), janë marrë të dhëna gjatë anketimit vetëm për bashkinë Libohovë, çka tregon se banorët e Libohovës janë të vetmit që i janë përgjigjur pyetjeve lidhur me këtë shërbim por edhe se bashkia Libohovë mund të jetë e vetmja që këtë shërbim e trajton më vete.

Megjithatë, nga rezultatet e sondazhit vëmë re se për këtë bashki, përgjigjet e marra në total për këtë shërbim janë 44, nga të cilat **57%** (25 persona) shprehen se duhen shtuar shpenzimet për këtë shërbim dhe **30%** (13 persona) janë dakort me nivelin aktual. Ndërsa vetëm 5% (2 persona) kanë votuar për uljen e shpenzimeve. Ndërsa, sa i takon mendimit të banorëve lidhur me performancën, rezultatet në **67%** (28 persona) të tyre, tregojnë se nuk janë të kënaqur, **19%** (8 persona) kanë përzgjedhur opsionin “neutral” dhe **10%** (4 persona) janë të kënaqur me cilësinë e ofruar të këtij shërbimi.

Shpenzimet e programit “Transporti publik”, 04570

Këshilli bashkiak përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet dhe miraton tarifën e udhëtimit / biletën, por vetem disa bashki të medha akordojnë fondet nga burimet e veta për këtë program, qoftë dhe për subvencionim të shërbimit. Vetëm Bashkitë Elbasan, Shkodër dhe Korçë kanë struktura dhe raportojnë shpenzime në këtë program.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 27% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Ndaj totalit të buxhetit të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht vetem 0.2% por ka bashki me shpenzime më të mëdha për këtë shërbim, si bashkia Elbasan 2%, bashkia Korçë 0.5% dhe bashkia Shkodër 0.3%.

Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Si shpenzimet e personelit zënë 48% të totalit të shpenzimeve të programit, por edhe shpenzimet e tjera korente zënë mesatarisht po 48% të shpenzimeve brenda programit.

Për programin “Projekte zhvillimi për investime rrugësh”

Për programin “Projekte zhvillimi për investime rrugësh”, të dhënat janë të vlefshme vetëm për bashkinë Pogradec. Në sondazh, përgjigjet e marra nga banorët e kësaj bashkie, për këtë shërbim janë 267, nga të cilat **65%** (174 persona) shprehen se janë dakort për rritjen e shpenzimeve, **27%** (72 persona) janë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve për këtë shërbim, 4% (11 persona) kanë votuar për uljen e shpenzimeve dhe 4% (10 persona) kanë vendosur të përgjigjen me “nuk e di”.

Ndërsa, sa i takon mendimit të banorëve lidhur me performancën e shërbimit (programit), **35%** (94 persona) janë të kënaqur, **31%** (82 persona) kanë shprehur pakënaqësi, **30%** (79 persona) kanë përzgjedhur kategorinë “neutral” dhe 4% (12 persona) janë përgjigjur “nuk e di”.

Shpenzimet e programit “Projekte Zhvillimi”, 04740

Në këtë program kryen shpenzime për aktivitete që kënen të bëjnë me nxitjen e projekteve zhvillimore të bashkisë si: ndërtim, mirëmbajtje, zgjerim, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatëse me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore.

Bashkitë nuk kanë raportuar shpenzime në këtë program, megjithëse shumë bashki kanë shpenzuar fonde nga FZHR për zbatim projektsh zhvillimi, sepse raporti nuk përfshin fondet e kushtëzuara.

Vetëm Bashkia Patos ka raportuar shpenzime në këtë program për v.2020. Ndërsa në v.2019 kanë raportuar shpenzime në këtë program dhe Bashkia Mirditë, Durrës (janë fonde nga burimet e vet bashkisë).

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 66% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Shpenzimet e programit zënë 0.1% të shpenzimeve totale të bashkive.

Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Përderisa janë projekte zhvillimi, investimet zënë peshën kryesore në program (mesatarisht 80%)

Gjetje dhe rekomandime

- **Ndryshim i rrjetit rrugor** (rrugë të ndërtuara urbane dhe rurale), i cili administrohet nga bashkitë, është rritur në vitin 2020 me **159 km** në krahasim me vitin 2019; **19.1%** e rrjetit rrugor është e asfaltuar.
- *Është përmirësuar performanca e NJVV në drejtim të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor (urban/rural)*; Norma mesatare e mirëmbajtjes së rrugëve ka qënë **50.4%** në 2020 (krahasuar me 32% në 2016).
- Mesatarisht shpenzimet për këtë program përbëjnë rreth 12% të shpenzimeve totale të bashkisë, dhe në vitin 2020 janë ulur mesatarisht me 36% krahasuar me vitin 2019.
- Për shërbimin e transportit publik, shpenzimet janë ulur mesatarisht me 27% krahasuar me vitin 2019. Ulja e shpenzimeve për shkak të situatës Covid-19 ka detyruar bashkitë të ulin shpenzimet në disa shërbime publike.
- **Numri i linjave interurbane të transportit publik** në krahasim me vitin e kaluar (2020/2019) **ka qënë i njëjtë për 78%** të bashkive të kampionit. Numri i automjeteve të transportit publik ndërurban për 67% të bashkive të kampionit ka qënë në të njëtin nivel me vitin 2019, ndërsa **33% e bashkive të kampionit kanë shtuar numrin e mjeteve të transportit publik në 2020.**
- Referuar rezultateve të sondazhit, **rreth 56%** e të anketuarve (2,487 persona) shprehen se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program.
- Pyetjes, sa jeni të kënaqur me performancën e shërbimit, **41%** e të anketuarve shprehen të pakënaqur, ndërsa **29%** e vlerësojnë “shumë mirë” shërbimin gjatë vitit 2020.
- Për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të administruar nga NJVV, buxheti i alokuar ka qënë 38,000 lekë/km rrugë rurale në vitin 2018¹⁰⁵, krahasuar me 131,000 lekë/km rrugë në vitin 2015¹⁰⁶.
- Të dhënat për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor dhe nivelin e asfaltimit të rrugëve duhet të jenë diskrete, për rrjetin urban dhe rrjetin rural.
- Rekomandohet përmirësim i të dhënave nga Bashkitë mbi bazën e përdorimit të klasifikimit dhe inventarizimit të rrugëve dhe trotuareve sipas Kodit Rrugor të RSH, dhe planifikimi i buxhetit në PBA për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve të zonave rurale për të rritur aksesin e banorëve, si dhe për të përmirësuar cilësinë e transportit publik.

3.13 Menaxhimi i Mbetjeve

Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; Pastrimi i rrugëve, parqeve, etj.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Grumbullimi, transportimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake është përcaktuar funksion i NJVV (Ligji 139/2015, neni 23/10). Roli dhe detyrat e NJVV në këtë fushë harmonizohen dhe mbështeten në dy ligje

105 Shpjegim: Nuk ka patur të dhëna të mjaftueshme për të llogaritur koston e mirëmbajtjes për 1 km rrugë (urbane/rurale) për vitin 2020/2019.

106 Raport (dldl, O. Shapo, 2018)

kryesore: Ligj 10463/2011 "Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, Ligj 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Vendimi për Miratimin e Masave për kostot e MIM (319/2018)¹⁰⁷ dhe dokument i politikave strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035 (miratuar me Vendim Nr. 418/2020), dhe Strategjia ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2023.¹⁰⁸

Gjithashtu, në SNDQV dhe PV 2020-2022 është përcaktuar masa C1.4 "rritja e cilësisë dhe dhe efikasitetit të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve" e përberë nga aktivitete, si asistencë teknike për zbatimin e VKM-së nr. 319, datë 31.5.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"; hartimin e planeve me qëllim zbatimin e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike në fushën e mbetjeve; negocim me QQ për impiantet e trajtimit të mbetjeve; vlerësim dhe shqyrtimi i planeve të përmirësimit për landfilllet e mbetjeve; ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë edhe mbledhjen e diferencuar dhe riciklimin; përcaktimi i standardeve kombëtare minimale".

Raportohet fillimi i punimeve në ndërtimin e landfill rajonal të Vlorës (Sherishtë). Gjithashtu, në 2020, me financim nga buxheti i shtetit dhe projekte me financim të huaj, kanë qënë në proces zbatimi disa projekte për ndërtim të landfill/venddepozitimeve dhe inceneratorë¹⁰⁹.

Në kuadër të procesit të aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, legjislacioni kombëtar në fushën e mbetjeve është përafshuar me direktivat dhe rregulloret e BE-së por sfidë mbetet zbatueshmëria e tyre. Vlerësimi i performancës së NJVV në fushën e menaxhimit të mbetjeve është pjesë e kapitullit 27 "Mjedisi dhe ndryshimi i klimës" sipas disa synimeve: Edukimi i brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes (1 tregues - nr. i fushatave të ndërgjegjësimit), dhe përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve (7 tregues të performancës¹¹⁰).

Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve¹¹¹ përmban 61 tregues monitorimi, nga të cilët 33 tregues ose 61% e tyre duhet të raportohen nga bashkitë dhe Ministrinë e Linjës. Roli i bashkive për menaxhimin e mbetjeve përmban ndër të tjera: i) hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve për organizimin dhe ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit, depozitimitin e mbetjeve bashkiake; ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit; vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhjen e të ardhurave; organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vetë bashkinë/ ose në bashkëpunim me bashki të tjera, lëshon leje personave fizike/ose juridikë (nënkontrakt operatorë) për ofrimin e shërbimit të operacioneve për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Referuar raporteve të monitorimit të PKMIM, evidentohet se 30% e banorëve rezidentë nuk mbulohen me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, 40% e mbetjeve të gjeneruara nuk grumbullohen akoma nga bashkitë

107 <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/Vendimi-nr.319-datë-31.5.2018-Për-kostot-dhe-tarifën-e-mbetjeve.pdf>

108 Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet (ref. Obj.11/6: Të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera).

109 Burim: Raporti i Monitorimit/Relacion i MIE, 2021 - 1. Projekti "Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier", 2. Projekti "Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit)", 3. Projekti "Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, Pogradec (parashikuar të përfundojë në 2021). 4. Projekti "Ndërtim venddepozitimi i Bushatit (faza II)", që zbatohet nga Bashkia Vau i Dejës dhe nuk është paraqitur ndonjë problematikë në MIE. 6. Projekti "Punime shtesë të impiantit të trajtimit të ujërave dhe shtresave të landfillit Bajkaj" (Projekti nuk ka pasur realizim financiar, pasi kontrata nga Qarku Vlorë është lidhur në datën 10.12.2020 me operatorin fitues) 7. Projekti "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit". 8. Projekti "Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës". 9. Projekti "Mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta, EKOPark Durrës". 10. Projekti "Projekti në fushën e mbetjeve të ngurta financuar në kuadrin e Ekonomisë Cirkulare". 11. Projekti "Ndërtimi i stacioneve të transferimit të mbetjeve sipas parashikimeve të Masterplanit të Mbetjeve", 12. Projekti "Projekte për mbështetjen e zbatimit të Masterplanit të Mbetjeve të Ngurta". 13. Projekti "Ndërtimi i landfillit rajonal Berat dhe masa shoqëruese"; <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Relacion-Monitorimi-MIE-2020.pdf>

110 Raporti "Bashkitë në procesin e Integritimit Evropian"- Raporti i performancës për vitin 2019 – projekt i financuar nga IPA (BE): Plan vendor i MIM i hartuar, planifikuar në PBA, Mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë bëhet në mënyrë të rregullt sipas Planit vendor të MIM, Mbetjet e riciklueshme të territorit të bashkisë riciklohen sipas objektivave të Planit MIM vendor, Numri i venddepozitimeve të paautorizuara në territorin e bashkisë, Numri i vend-depozitimeve të autorizuara / landfill ose incenerator në territorin e bashkisë, Mbetjet ndahen në burim në rryma sipas legjislacionit, Largësia e qendrës së bashkisë nga landfilli më i afërt.

111 Miratuar me VKM Nr. 418/2020

dhe 20% e mbetjeve nuk hidhen në venddepozitime të kontrolluara dhe të lejuara. Aktualisht ekzistojnë 5 sisteme të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngritura në zbatim të hierarkisë së mbetjeve¹¹². Si rezultat i disa projekteve pilot, qytetarët janë bërë pjesë e masave për përmbushjen e objektivave të planeve vendore dhe rezultati është, që 30% e popullsisë ndan mbetjet në burim ndërsa për riciklim shkon vetëm 17% e mbetjeve¹¹³.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Programi monitorohet nga Bashkia përkundrejt 13 treguesve të performancës nga të cilat tre (3) tregues financiar: buxheti për ofrimin e shërbimit, shuma totale e faturuar dhe të ardhurat nga tarifa e shërbimit të mbetjeve në raport me shpenzimet e kryera për ofrimin e shërbimit.

Treguesit specifikë të performancës së shërbimit matin aspekte cilësore dhe sasiore të ofrimit të shërbimit, si frekuenca e grumbullimit të mbetjeve në qytet dhe në NJA, popullsia e mbuluar me shërbim, sasia totale e mbetjeve e grumbulluar në vit (qytet/NJA), mbulimi i sipërfaqeve të rrugëve e shesheve me fshirje etj. Analiza në raport përfshin vetëm treguesit që lidhen me mbledhjen, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve.


Treguesi: Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve/tregues

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane është realizuar në të njëjtin nivel përsa i përket frekuencës së grumbullimit të mbetjeve në 2020 krahasuar me 2019, me ndryshime të lehta për disa bashki. Bashkitë që kanë raportuar grumbullimin/transportin 7 herë në javë përbëjnë 50% të kampionit (Bashkia Elbasan, Shkodër, Cërrik, Belsh, Librazhd, Mat, Klos, Kamëz, Kukës, Lezhë, Shijak, Kurbin, Delvinë, Këlcyrë, Malësi e Madhe, Mallakastër, Memaliaj dhe Skrapar); frekuenca e grumbullimit për bashkitë e tjera ndryshon nga 1¹¹⁴ në 6.

Gjithashtu, edhe **në zonat rurale nuk ka patur ndryshim të frekuencës së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve** në 2020 krahasuar me vitin 2019; frekuenca ndryshon nga 1 ditë në javë (p.sh. Bashkia Bulqizë), në 2-3 për shumicën e bashkive; 4 herë në javë është frekuenca e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale për Bashkinë Himarë dhe 7 herë në javë raportuar nga Bashkia Memaliaj.

Treguesi: Mbulimi me shërbimin (standard)

Grafik 55: Popullata e mbuluar me shërbimin e largimit të mbetjeve, 2020



Shkalla mesatare e mbulimit të popullatës nga bashkitë e kampionit ka qënë 67% në vitin 2020 (rritje me


112 Landfilli Bajkaj/Sarandë, Maliq/Korçë, Bushat/ Shkodër, Sharrë/Tiranë, ËtE Elbasan

113

114 Bashkia Maliq dhe Bashkia Has

1 p.p krahasuar me vitin 2019 (66% shkalla mesatare). Rreth 15 % e bashkive plotësojnë standardin (Bashkia Elbsan, Belsh, Kamëz dhe Lezhë). Devijim të thellë nga standardi me mbi 50% kanë Bashkitë Klos, Dropull dhe Himarë (63%-65%) dhe Memaliaj (54%).


Grafik 56: Popullsia e mbuluar me shërbimin e largimit të mbetjeve (krahasuar me standardin (kundrejt 90% të mbulimit))¹¹⁵



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=27 nga 36)

Duke ju referuar INSTAT, shkalla e mbulimit të popullatës me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ka qënë në nivelin **86.9% në 2020** krahasuar me 87.9 (ose – 1 p.p.)


Grafik 57: Shkalla e mbulimit të popullatës, 2013 - 2020



Treguesi: Mbetje të grumbulluara dhe të transportuara

Krahasuar me vitin 2019, **treguesi sasior i shërbimit “mbetje të grumbulluara/transportuara në ton)” rezulton me rritje dhe përkatësisht me 3445 ton mbetje më shumë në 2020.** Bashkitë Kamëz, Kukës dhe Klos kanë patur rritje të ndjeshme të sasisë së mbetjeve, ndërsa Bashkitë Shkodër dhe Roskovec kanë patur ulje të sasisë së mbetjeve në 2020 krahasuar me vitin 2019. Duke ju referuara të dhënave nga INSTAT, sasia e mbetjeve urbane (solide) është ulur me 4% në 2020 / 2019 (burim INSTAT) ose **1,047,852 ton në 2020.**


Grafik 58: Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në vit, ndryshimi vjetor në ton (2020 / 2019)



Mesatarisht, **shkalla e mbulimit të territorit me shërbimin e mbetjeve ka qënë 32% ne vitin 2020 (n=14 RP).**

¹¹⁵ Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035

Grafik S9: Mbulimi i territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve nga NJVV (në % të sipërfaqes së bashkisë) – burim RP



Duke qënë se në Shqipëri nuk ka ende grumbullim të diferencuar të mbetjeve, përveç disa projekteve pilot, nuk është analizuar treguesi që lidhet me këtë aktivitet, megjithëse industria e riciklimit ka një kapacitet prej 41,540 ton/muaj (sipas PKMIM).

Shpenzimet e programit “Menaxhimi i mbetjeve”, 05100


Burim financimi për menaxhimin e mbetjeve janë të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve dhe të ardhurat e tjera të veta të bashkisë. Nga 36 bashki të studimit, janë 13 bashki ose 36% e tyre që nuk kanë raportuar shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve për vitin 2020. Pra, këto bashki i përfaqësojnë shpenzimet e këtij programi, tek programi buxhetor i shërbimeve publike. Mungesa e të dhënave në programin e duhur nuk na mundëson krahasueshmërinë dhe nuk mund të analizojmë buxhetin, treguesit e programit, mbulimin e kostos apo efikasitetin sipas aktiviteteve të programit.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 7% krahasuar me v.2019.


Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Shpenzimet e programit zënë mesatarisht 6% të shpenzimeve total të bashkisë. Bashkitë me shpenzime më të larta të programit ndaj totalit janë bashkitë Durrës (16%) dhe Himarë (18%).



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)


Peshën më të lartë në program e kanë shpenzimet operative & mirëmbajtjes (64%), sepse bashkitë në përgjithësi e kanë të kontraktuar shërbimin me kompani private. Bashkitë investojnë pak për shërbimin, vetëm 3% mesatarisht. Peshë të konsiderueshme të investimeve kanë patur Bashkitë Klos (28%), Fushë Arrëz (16%) dhe Pukë (12%) të shpenzimeve të programit, në vitin 2020.



Rezultatet e sondazhit me qytetarët


Rezultatet e marra të sondazhit, e rendisin këtë shërbim nga NJVV ndër më të rëndësishmit sa i takon pikëpamjes së banorëve. Vihet re se **43%** e të anketuarve (1,266 persona) shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë shërbim, ndërsa **42%** (1,239 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit nga ana e bashkisë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Grafik 60: Çfarë mendoni lidhur me shpenzimet për shërbimin Menaxhimi i Mbetjeve?



Ndërsa, sa i takon pyetjes nëse banorët janë të kënaqur me performancën e këtij shërbimi, në nivel të përgjithshëm të bashkive ku u realizua sondazhi, rezultatet evidentojnë që **35%** (911 persona) shprehen të pakënaqur, ndërsa **31%** (825 persona) janë të kënaqur me shërbimin e ofruar. Bashkitë Durrës dhe Peqin kanë nivelin më të lartë të banorëve të pakënaqur me cilësinë e këtij shërbimi, ndërsa bashkitë të cilat janë të kënaqura me nivelin e performancës së këtij shërbimi, janë bashkia Shkodër me 63% (95 persona) dhe Patosi me 51% (59 persona).

Grafik 61: Jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për shërbimin?



Edhe pse për këtë program banorët shprehen të pakënaqur me cilësinë e ofrimit të shërbimit, sërish pyetjes lidhur me gadishmërinë e tyre për të paguar më shumë taksa, shumica e banorëve i është përgjigjur negativisht në masën 61% totalit të përgjigjeve (5,283).

Gjetje dhe rekomandime

- Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane është realizuar në të njëjtin nivel përsa i përket frekuencës së grumbullimit. Kjo performancë rezulton edhe për zonat rurale.
- Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ndonëse ka patur trend rritës të mbulimit të shërbimi të popullatës, 2013- 2019 (në 2020 ka patur ulje të lehtë me -1 p.p /2019), shërbimi nuk ka arritur ende synimin e politikës (90% mbulim të popullatës).
- Niveli i riciklimit të mbetjeve urbane është shumë i vogël (pothuajse jo ekzistent); po kështu edhe ndërgjegjësimi i popullatës për ndarjen e mbetjeve në burim.
- Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në 2020 kanë në nivelin 1,047,852 ton (ose 4% më pak kundrejt vitit 2019).
- Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 7% krahasuar me vitin 2019, duke përberë mesatarisht rreth 6% të shpenzimeve totale të bashkisë. Bashkitë investojnë pak për shërbimin, mesatarisht 3% të fondit të programit.
- 43% e të anketuarve shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë shërbim, ndërsa 42% shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit për shërbimin.
- Referuar pyetjes mbi performancën e këtij shërbimi, rezultatet e tregojnë që 35% e të anketuarve shprehen 'të pakënaqur', ndërsa 31% janë 'të kënaqur' me shërbimin e ofruar.
- Rreth 61% e të anketuarve nuk janë të gatshëm të paguajnë tarifa më të larta për shërbimin përkundrejt përmirësimit cilësor të tij.
- Ndonëse riciklimi i mbetjeve është një prioritet i politikës në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, nuk ka tregues për këtë aktivitet në raportet e performancës të bashkive. Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve është përgjegjësi e vetëqeverisjes vendore dhe mbetet ende një sfidë për vendin (Zgjidhjet teknike dhe teknologjike për rrymat e ndryshme të mbetjeve duhet të përmbushin standardet minimale nga NJVV).
- Ka vështirësi në llogaritjen e treguesve të efikasitetit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve, sepse mungon informacioni i shpenzimeve sipas qendrave të kostos; NJVV duhet të ndajnë kostot sipas qendrave të tyre dhe kjo do të disiplinojë dhe vendosjen e tarifave të shërbimit.
- Domosdoshmëri është ngritja e sistemit të matjes, menaxhimit dhe raportimit të mbetjeve bashkiake¹¹⁶.

116 Referuar VKM nr.687, datë 29.5.2015, "Për miratimin e rregullave mbi mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave mbi

Sfidë mbetet ende nevoja e një sistemi për të kontrolluar saktësinë e të dhënave që vijnë nga bashkitë dhe sidomos vendosja e detyrimit për peshimin e mbetjeve, për matjen dhe analizën e përbërjes së tyre merceologjike (mbi sasine dhe rrymat e mbetjeve).

- Është e nevojshme përfshirja e disa treguesve të tjerë, të cilët duhet të raportohen nga bashkitë edhe në kuadrin e monitorimit të PKMIM.
- Rishikimi i planeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, bazuar në objektivat e PKMIM deri në vitin 2025 është domosdoshmëri dhe rekomandim.
- Për një analizë më të plotë të shërbimit, është e nevojshme që bashkitë të ofrojnë të dhëna të tjera, si:
 - Të ardhura të mbledhura nga tarifa kundrejt kostos totale të shërbimit (mbullimi i kostos së shërbimit)¹¹⁷.
 - Tarifa e mbledhur kundrejt shumës së planifikuar / faturimit (në %)
 - Kosto totale e programit të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të bashkisë (nga të ardhurat e veta + fonde të tjera)
 - Investime ndaj totalit të buxhetit të programit (në %).

3.14 Planifikimi Urban

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik; Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave; Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore; Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin; Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit; Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësisve banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit; Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Shërbimi për planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit është pjesë e funksioneve të bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (Ligj 139/2015, neni 23, pika 14), Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe Rregullore e planifikimit të territorit (miratuar me VKM Nr. 686/2017), si dhe dokumenti strategjik për planifikimin e territorit 2015-2020, i cili sugjeron iniciimin e matjeve të treguesve sasiorë dhe cilësorë nga të gjithë autoritetet e planifikimit.

Planifikimi dhe zhvillimi i territorit është synim i politikës së qeverisë për decentralizim dhe qeverisjen vendore, e shprehur në objektivin A1 të SNDQV PV 2020-2022 për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve strategjike dhe masën ‘harmonizimi dhe zbatimi i planeve të zhvillimit të territorit (aktiviteti a).

mbetjet”. i cili ka hyrë në veprim në janar 2019, bashkitë janë përgjegjëse për të raportuar të dhënat mbi mbetjet sipas formularëve bashkëlidhur vendimit.

¹¹⁷ Bashkia vendos tarifa për koston totale të menaxhimit të mbetjeve ku përfshin dhe koston e tjera të aktiviteteve si pastrimi i rrugëve dhe shesheve, larja e rrugëve, dizinfektimi i kontenjerëve etj. Nuk ka tarifa të veçanta për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve.

Në planifikimin urban të territorit të tyre, NJVV duhet të planifikojnë ndërhyrjet dhe zhvillimin në përputhje me Planin e Zhvillimit të Territorit (PZHT), ose Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV).

Në fund të vitit 2020, gjithsej janë hartuar dhe miratuar 48 PZHT për NJVV, ndërsa janë në proces 13 plane të tjerë; gjithashtu 50 PPV janë zhvilluar dhe miratuar nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore dhe 11 të tjerë janë në proces hartimi/miratimi. Një sistem elektronik 'e-platforma' është në proces zhvillimi nga AKPT, i cili do të lehtësojë planifikimin dhe vendimmarrjen me pjesëmarrje të gjerë publike (konsultimin publik) në mbështetje të bashkive; sistemi merr në konsideratë strukturën e dokumentacionit të planifikimit të kërkuar si nga autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe nivel vendor¹¹⁸.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Performanca e shërbimit të planifikimit urban është vlerësuar me treguesin e kategorisë "cilësi / mbulim me shërbim" përkatësisht me *numrin e lejeve të miratuara të zhvillimit* në përputhje me planet e detajuara të zhvillimit kundrejt numrit total të lejeve të miratuara për vitin e raportimit (në %).

Në vitin 2020, janë **miratuar 611 leje**¹¹⁹, nga të cilat bashkia Lezhë ka patur 500 leje ndërtimi. Nëse nuk përfshijmë bashkinë Lezhë, **mesatarja e numrit të lejeve të ndërtimit** nga 8 bashki ka qënë **14 leje** ndërtimi (shih tabelën më poshtë).


Tabelë: Numri i lejeve të miratuara që përputhen me PZHT, 2020

| | Elbasan | Cërrik | Belsh | Bulqiza | Kukës | Has | Lezhë | Kolonjë | Himarë | MM | Roskovec | Skrapar |
|--|---------|--------|-------|---------|-------|-----|-------|---------|---------|------|----------|---------|
| | 12% | 92% | | 100% | 100% | | 167% | 100% | | 100% | 100% | 100% |
| Leje të miratuara që përputhen me PZHV | 13 | 24 | N/A | 15 | 3 | N/A | 500 | 5 | N/A | 17 | 22 | 12 |
| Nr. Total i Lejeve të Zhvillimit të miratuara nga NJVV | 107 | 26 | 26 | 15 | 3 | 13 | 300 | 5 | 6119476 | 17 | 22 | 12 |

Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=12)

Shkalla e lejeve të miratuara nga NJVV në përputhje me PZHT të detajuara varion nga 12% në 100%; **shkalla mesatare e lejeve të ndërtimit në përputhje me PZHT** ka qënë **87%** në vitin 2020 krahasuar me 97% në vitin 2019; Vetëm Bashkia Elbasan ka dhënë 12% të lejeve të ndërtimit në përputhje me PZHT gjatë 2020¹²⁰, ndërsa treguesi për bashkitë e tjera ndryshon nga 92% në 100% (n=12).

Grafik 62: Shkalla e lejeve të miratuara në përputhje me PZHT, 2020



118 Raporti i Monitorimit SNDQV PV 2020-2022 (MB, 2021)

119 Nuk është përfshirë e dhëna e raportuar për bashkinë Himarë (raportohet shifër tepër e lartë e lejeve të ndërtimit 6119476 në 2020).

120 Mund të ketë pasaktësi në raportimin për këtë tregues nga bashkia Elbasan sepse rezultoi një shkallë e ulët e konformitetit me PZHT.

Shpenzimet e programit “Planifikimi Urban Vendor”, 06140

Në program raportohen shpenzime kryesisht për strukturat për hartimin dhe monitorimin e planeve strategjike vendore, por edhe për lëshimin e lejeve për ndërtime të reja, zhvillimin e tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën.

Nuk kanë raportuar shpenzime për programin 26 bashki ose 64% e tyre, kur në fakt struktura të planifikimit urban ka në çdo bashki.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 2% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Shpenzimet e programit zënë mesatarisht 1% të totalit të shpenzimeve të bashkive. Mbi këtë mesatare, programi zë përqindje të lartë tek bashkia Skrapar (4%), Cerrik dhe Kamëz (3%).

Grafik 63: Buxheti i programit “Planifikimi Urban” (në % ndaj buxhetit total të bashkisë)



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)


Mesatarisht, peshë të rëndësishme në program kanë pagesat e personelit (89%). Shpenzimet e raportuara në program kanë paqartësi, siç është rasti me Elbasanin që raporton investime në masën 100% të programit.



Rezultatet e sondazhit me qytetarët


Për programin Planifikim urban vendor, kemi të dhëna vetëm për 3 bashki. Konkretisht, për Cërrikun, Devollin dhe Skraparin. Nga rezultatet, vihet re se rreth **44%** e të anketuarve (60 persona) është dakort me nivelin aktual të shpenzimeve për këtë program, **25%** (34 persona) kërkojnë rritjen e shpenzimeve, 17% (23 persona) kanë zgjedhur të përgjigjen me “nuk e di” dhe 13% (158 persona) janë të mendimit se duhen ulur shpenzimet. Të treja këto bashki janë shprehur në masën më të madhe të tyre dakort me nivelin aktual të shpenzimeve, më konkretisht: Skrapari me 51% (19 persona), Cërriku me 43% (3 persona) dhe Devulli me 42% (38 persona).

Grafik 64: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Planifikim urban vendor



Lidhur me pyetjen mbi performancën e shërbimit, rreth **36%** e të anketuarve (45 persona) kanë patur mendim neutral, **28%** (35 persona) ‘jo mirë’, **25%** (31 persona) “shumë mirë” dhe **11%** (14 persona) kanë zgjedhur opsionin “nuk e di”.

Grafik 65: Mendimi i banorëve për performancën e programit Planifikim urban vendor



Gjetje dhe rekomandime

- Mesatarisht, në 2020 shkalla e përputhshmërisë së lejeve të ndërtimit ka qënë 97%
- Shkalla mesatare e lejeve të ndërtimit ka qënë tetë (8) në vitin 2020; nëse në analizë përfshijmë edhe të dhënë e raportuar nga bashkia Lezhë, atëherë mesatarisht janë dhënë 68 leje ndërtimi (n=9).
- Rezultatet e sondazhit evidentojnë se rreth **44%** e të anketuarve kanë qënë *dakort me nivelin aktual të shpenzimeve* për këtë program, **25%** (34 persona) *kërkojnë rritjen e shpenzimeve* për programin; pjesa tjetër e të anketuarve, kanë zgjedhur ‘duhet shpenzuar më pak’ ose ‘nuk e di’.
- Mbi performancën e shërbimit, rreth **36%** e të anketuarve kanë patur mendim neutral, **28%** ‘jo mirë’, dhe rreth **25%** “shumë mirë”.

3.15 Administrimi dhe Menaxhimi i Parqeve dhe Hapësirave Publike (shërbime publike vendore)

Përshkrimi i programit buxhetor: Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësor që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve; Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Shërbimi i menaxhimit të parqeve publike dhe hapësirave publike është pjesë e funksionit të bashkive në fushë e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (Ligj 139/2015, neni 23, pika 9 dhe pika 7, neni 23, pika 8 për shërbimin e dekorit). Menaxhimi i këtij funksioni nga NJVV bazohet edhe në dokumentin për planifikimin e territorit, 2015-2020, dhe ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (i ndryshuar me ligj nr. 73/2015), rregulloren e planifikimit të territorit (kërkesat/standartet për shërbime të ndryshme), dhe kodi rrugor (ligj 8378/1998) për përcaktimin e trotuarëve”.

Rezultatet e performancës së shërbimit


Rezultatet e shpenzimeve buxhetore për shërbimin vlerësohen nga 3 tregues të performancës: (i) Hapësira të gjelbërta për frymë bazuar në standard (metra katror hapësirë e gjelbër për banor); (ii) Numri i pemëve të mbjella (ndryshimi vjetor në numër), (iii) trotuare në km linear (ndryshimi vjetor).

Në 2020, për treguesin ‘ndryshim vjetor i rrjetit të trotuareve (në km)’ për vitin e raportimit 2020 kundrejt 2019, 17 bashki kanë ofruar të dhëna nga 36 (kampioni). Të dhënat tregojnë se bashkitë nuk kanë investuar shumë në shtimin e trotuarëve gjatë 2020; ndryshimi është zero midis 2020/2019 për disa bashki; Bashkia Memaliaj ka investuar në shtimin e 9 km linear trotuarë në 2020, Bashkia Roskovec (6.5 km), Malësi e Madhe 2 km, dhe bashkitë e tjera 0.5km -1.5 km si bashkia Himarë, bashkia Këlcyrë (0.5 km), Patos (1.1km).

Bashkitë nuk kanë ofruar të dhëna të mjaftueshme për të analizuar performancën e shërbimeve publike për hapësirat e gjelbra, e shprehur në “Hapësira të gjelbërta për frymë” (metra katror hapësirë e gjelbër për banor); Për bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Librazhd, Mat, Klos, Maliq, Shijak, Fushë Arrëz dhe Himarë ishte 0,001 ha/frymë, Bashkia Delvine dhe Këlcyrë (0,0006 ha/frymë të popullsisë), Bashkia Dropull (0.004 ha/frymë).

Bashkitë kanë mbjellë më shumë pemë në 2020 kundrejt 2019 (1341 pemë më shumë), ose mesatarisht 416 pemë (n=9).

Grafik 66: Numri i pemëve të mbjella në hapësirat publike të bashkisë, ndryshimi 2020/2019



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=20)

Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Gjetje dhe rekomandime

- Të dhënat për sipërfaqe të gjelbëruara (në ha) nuk kanë qënë të plota për të nxjerrë një përfundim të përgjithësuar, por për disa bashki (n=10), ka qënë 0,001 ha/frymë¹²¹ ndërsa për bashkitë e tjera ka qënë 0,004 ha/frymë - 0,0006 ha/frymë.
- Mesatarisht, bashkitë kanë mbjelle rreth 400 pemë të reja gjatë vitit 2020.
- Bashkitë nuk kanë investuar shumë në shtimin e trotuarëve gjatë 2020.

3.16 Furnizimi me Ujë

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë; Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë; Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë; Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm është pjesë e funksioneve të bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, që ka një kuadër ligjor të përcaktuar¹²². Një prioritet kryesor i reformës në sektorin ujësjellës kanalizime është ofrimi i mbështetjes dhe nxitjes së vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e shërbimit, sigurimi i qëndrueshmërisë të sistemit, rritje e aksesit me ujë të pijshëm, grumbullimin e ujërave të zeza dhe trajtimin e tyre, me fokus të veçantë zonat bregdetare, furnizimi me ujë 24 orë, si dhe reduktimi i humbjeve.

Në 2020, nga MIE është përfunduar (i) drafti final i projekt-ligjit për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimin e Ujrave të Ndotura Urbane, (ii) draft Strategjia Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030, (iii) kontratat e performancës, programi kombëtar i trajnimit & çertifikimi; (iv) ngritjen e platformës për regjistrimin dhe menaxhimin online, në kohë reale të aseteve të sha UK, e cila po pilotohet në 12 bashki, përkatësisht Bashkitë Sarandë, Shkodër, Cërrik, Peqin, Vlorë, Berat, Kavajë, Durrës, Himarë, Elbasan, Përmet dhe Gramsh.

Synimet e politikës për përmirësimin e infrastrukturës së sistemit dhe për të rritur cilësinë e shërbimit për furnizimin me ujë shprehen në treguesit e synuar:

- Furnizimi me Ujë, Nivel Kombëtar 15.1 (orë/ditë);
- Furnizimi me Ujë, Zona Urbane 18 (orë/ditë);
- Mbulimi i Popullatës, Nivel Kombëtar 81.5 (% Ujëmatësa);
- Mbulimi i Popullatës, Zona Urbane 79.7 (% Ujëmatësa);
- Mbulimi i plotë dhe me cilësi me shërbim të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive UK;

121 Për bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Librazhd, Mat, Klos, Maliq, Shijak, Fushë Arrëz dhe Himarë

122 Ligj 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore, Ligj 8102/1996 Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura, i ndryshuar, Kodi i furnizimit me ujë dhe kanalizime/Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të SHA UK (miratuar me VKM 1304/2009).


→ Investime për arritjen e furnizimit me ujë 24 orë/ditë në qendrat urbane të bashkive Delvinë, Durrës, Gramsh, Këlcyrë, Krujë, Fushë-Krujë, Malësi e Madhe, Patos, Ura Vajgurore, Vau i Dejës.¹²³

Aktualisht, në 61 bashkitë e vendit funksionojnë 57 ShA dhe 11 impiante trajtimi. Problem mbetet menaxhimi i infrastrukturës dhe asetëve të sektorit, i cili nuk ka të integruar ujësjellësat në fshatra në sistemin e Sha¹²⁴.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Performanca e shërbimit të furnizimit me ujë nga NJVV është analizuar nëpërmjet dy treguesve të raporteve të performancës: (i) Furnizimi me ujë - orë ujë në ditë (ndryshimi në orë nga viti kaluar, pra 2020 / 2019 (tregues cilësi/mbulim shërbimi), dhe (ii) Mbulimi i popullsisë me shërbimin e ujit të pijshëm (kundrejt popullsisë totale të bashkisë në %, standard/kërkesë ligjore për shërbimin).


Grafik 67: Ndryshimi i furnizimit me ujë 2020 / 2019 (në orë) në zonat urbane, krahasimi kundrejt standartit (n=22)



Në 2020, mesatarisht, bashkitë kanë ofruar një shërbim me ujë për qytetarët për 16.7 orë në ditë (rezulton që treguesi është nën standartin), por është rritur mesatarisht me +0,37 orë në 2020 kundrejt 2019. Bashkitë që kanë performuar jo mirë lidhur me këtë shërbim në 2020, kanë qënë bashkia Bulqizë (-6.5 orë në 2020/2019), Bashkia Durrës (-3.5 orë), Bashkia Cërrik (-2 orë).

Mbulimi i popullatës me shërbimin e furnizimit me ujë ka qënë mesatarisht në nivelin 59% në vitin 2020, kundrejt 70% në vitin 2010 (ose 11 p.p më i ulët). Bashkitë që kanë raportuar ulje të mbulimit të popullatës në 2020 kundrejt 2019 kanë qënë bashkia Elbasan (- 9 p.p.), Bashkia Cërrik (-29 p.p.).

Grafik 68: Popullata që përfiton nga shërbimi i furnizimit me ujë (në % të totalit të popullsisë së bashkisë), 2020



Duke ju referuar të dhënave të performancës së sektorit nga ERRU për vitin 2020, **kohëzgjatja e furnizimit me ujë** ka qënë mesatarisht 13.79 orë/ditë në 2020 nga 13.3 orë/ditë në vitin 2019, ndërsa **mbulimi i popullatës me FU ka qënë 75.8%** në 2020 nga 76.8% në 2019. **Mbulimi me kanalizime** ka qënë në nivelin 50.8% në 2020 nga 51% në 2019.

123 Raporti i Monitorimit 2020 (MIE); <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Relacion-Monitorimi-MIE-2020.pdf>

124 Shoqata e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (SHUKALB)

Shpenzimet e programit “Furnizimi me ujë”, 06330

Shpenzimet e programit përfshijnë aktivitetet për sigurimin e ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë. Shërbimi realizohet nga kompani në pronësi të bashkisë në formën e SHA dhe është Këshilli i Bashkisë që miraton dhe tarifat për ujin e pijshëm. Bashkitë, në përgjithësi, nuk përfshijnë në raportimet e buxhetit, shpenzimet e Sha-së që është në vartësi të tyre. Prandaj dhe aktualisht kemi raportim nga 18 bashki ose 50% e bashkive që raportojnë shpenzime për furnizimin me ujë, vetëm në masën e financimit nga të ardhurat e veta të bashkive.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 42% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Mesatarisht programi i furnizimit me ujë (vetëm nga të ardhurat e bashkisë) zë 2% ndaj totalit të shpenzimeve të bashkive. Tek Bashkia Memaliaj dhe Patos programi zë përkatësisht 18% dhe 22% të totalit të shpenzimeve të bashkisë.

Grafik 69: Buxheti i programit “furnizimi me ujë” ndaj buxhetit total të bashkisë (në %)



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Bashkitë kanë investuar për shërbimin e furnizimit me ujë. Mesatarisht brenda programit, investimet zënë 58% të shpenzimeve të programit, për bashkite raportuese për vitin 2020.




Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Rezultatet e sondazhit mbas anketimit tregojnë se rreth **48%** e të anketuarve (1,557 persona) janë dakort me nivelin aktual të financimit për këtë program, ndërsa rreth **42%** e tyre (1,373 persona) shprehen dakort për rritjen e shpenzimeve për këtë program dhe vetëm 4% e popullsisë (145 persona) u shprehën për uljen e shpenzimeve.


Sa i takon kategorisë të të anketuarve të cilët janë dakort me nivelin aktual të shpenzimit, shikohet se bashkitë të cilat kryesojnë renditjen janë: bashkia Belsh në masën 100% (4 persona), Poliçani në masën 100% (2 persona), Malësia e Madhe në masën 92% (82 persona) dhe Kolonja në masën 72% (105 persona). Gjithashtu, bashkitë të cilat në masën më të madhe të përgjigjeve të tyre janë dakort me rritjen e financimit për këtë program janë: Mallakastra në masën 67% (95 persona), Klosi në masën 59% (17 persona), Cërriku në masën 57% (4 persona) dhe Maliqi në masën 50% (95 persona).

Grafik 70: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Furnizim me ujë




Në përgjigje të pyetjes se sa kanë qënë të kënaqur me performancën e këtij shërbimi, rezultatet e sondazhit tregojnë se, rreth **42%** e të anketuarve (1,326 persona) kanë qënë të kënaqur, **28%** (904 persona) kanë patur mendim neutral dhe **25%** (793 persona) janë të pakënaqur.

Grafiku 71: Mendimi i banorëve për performancën e programit Furnizim me ujë



Sa i takon qasjes së banorëve lidhur me *mundësinë për të paguar më shumë taksë ose tarifa* për këtë program, vëmë re se **55%** e të anketuarve (4,731 persona) shprehen kundër ndërsa **45%** (3,872 persona) pro rritjes së tarifës së shërbimit.

Grafiku 72 : Gadishmëria e banorëve për të paguar më shumë taksë për Furnizim me ujë



Shpenzimet e programit “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, 05200

Menaxhim i ujërave të zeza dhe kanalizimeve sanitare është shërbim që realizohet nga kompani në pronësi të bashkisë në formën e SHA-së. Shpenzimet kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave të zeza dhe kanalizimeve sanitare (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur). Bashkitë aplikojne tarifa për KUZ.

Në këtë program bashkitë në përgjithësi nuk përfshijnë në raportim shpenzimet e Sha-së që është në vartësi të tyre. Prandaj dhe aktualisht kemi vetëm 5 bashki ose 14% e bashkive që raportojnë shpenzime, vetëm në masën e financimit nga të ardhurat e veta të bashkive.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 8% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Mesatarisht tek bashkitë raportuese, shpenzimet e programit, të financuar nga bashkia zënë 0.4% të totalit të shpenzimeve.

Grafik 73: Buxheti për programin UZK (në % ndaj buxhetit të bashkisë), 2020



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Sipas grafikut, bashkitë kanë investuar mesatarisht në masën 75% brenda programit. Pjesa tjetër në program janë shpenzime korrente.



Gjetje dhe rekomandime

- Mbulimi i popullatës me shërbimin e furnizimit më ujë ka qënë mesatarisht në nivelin 59% në vitin 2020¹²⁵. Treguesi është më tendecë ulje në krahasim me 2019.
- Në 2020, mesatarisht, bashkitë kanë ofruar një shërbim me ujë për qytetarët për 16.7 orë në ditë ose +0,37 orë në 2020 kundrejt 2019 (në nivel kombëtar, shërbimi është mbi standartin kombëtar por nën standartin e synuar për zonat urbane¹²⁶).
- Duke ju referuar treguesve kryesorë të performancës për vitin 2020, gjendja në sektor në krahasim me vitin 2019 paraqet një përkeqësim në drejtim të treguesve të ujit pa të ardhura, mbulimit të kostove direkte dhe normës së arkëtimit, ndërsa treguesit Mbulim me Kanalizime ka mbetur në të njëjtin nivel me 2019, por ka përmirësim në disa tregues të tjerë të performancës. Përgjithësisht, përkeqësimi i gjendjes së sektorit shpjegohet me pasojat nga pandemia dhe vazhdimësinë e shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019¹²⁷.
- Shpenzimet e programit për furnizimin me ujë janë ulur mesatarisht me 42% krahasuar me v.2019, dhe përbëjnë rreth 2% të totalit të shpenzimeve të bashkive. Brenda programit, investimet, mesatarisht, zënë rreth 58% për bashkitë raportuese, gjatë 2020.
- Shpenzimet e programit për menaxhimin e ujrave të zeza dhe kanalizimeve janë ulur mesatarisht me 8% krahasuar me v.2019 dhe përbëjnë rreth 0.4% të totalit të shpenzimeve të bashkisë.
- 48% e të anketuarve janë dakort me nivelin aktual të financimit për këtë program, ndërsa rreth 42% e tyre shprehen për rritjen e shpenzimeve për këtë program me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
- Lidhur me performancën e shërbimit, 42% e të anketuarve kanë qënë të kënaqur, 28% kanë patur mendim neutral dhe 25% të pakënaqur.
- 55% e të anketuarve shprehen kundër rritjes së tarifës së shërbimit, ndërsa 45% pro rritjes së tarifës së shërbimit.

3.17 Ndryshimi i Hapësirave Publike

Përshkrimi i programit buxhetor: Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Funksioni publik i ndriçimit i Hapësirave Publike në nivel të qeverisjes qendrore ushtrohet nga Kryeministria, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Efçencën e Energjisë. Këto institucione hartojnë dhe miratojnë politika kombëtare për zhvillimin e sektorit të energjisë, zhvillimin dhe përdorimin e burimeve të energjisë dhe efçencën e energjisë, si dhe zbatimin dhe monitorimin e programeve për përdorimin efçent të energjisë. Ligje relevante të sektorit janë Ligj Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Ligj Nr. 124 dt. 05.11.2015 Për efçencën e energjisë, dhe Ligj Nr. 7/2017 Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe dokumenti i politikave Strategjia Kombëtare e Energjisë, 2018-2030.

Në nivel vendor, administrimi dhe menaxhimi i funksionit përcaktohet në Ligjin 139/2015, neni 23, pika 5) dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor specifik të sektorit. Roli i NJVV lidhur me këtë funksion konsiston në i)

125 Koment: Bashkitë që kanë raportuar ulje të mbulimit të popullatës në 2020 kundrejt 2019 kanë qënë bashkia Elbasan (-9 p.p.), Bashkia Cërrik (-29 p.p.)

126 Furnizimi me Ujë, Nivel Kombëtar 15.1 (orë/ditë); Furnizimi me Ujë, Zona Urbane 18 (orë/ditë);

127 Burim: ERRU (Raporti Vjetor për vitin 2020)


realizimin e shërbimit të ndriçimit të mjediseve publike dhe kryerjen e investimeve, ii) marrjen e masave teknike për të përmirësuar menaxhimin dhe ruajtjen e energjisë, iii) mirëmbajtjen e paisjeve që konsumojnë çdo formë të energjisë, iv) mbikqyrjen e mënyrave të përdorimit të energjisë dhe detyra të tjera të lidhura me përdorimin racional të energjisë në ndërtesa publike dhe private dhe në industri, v) cakton menaxherin e energjisë.

Rezultatet e performancës së shërbimit

Programi i buxhetit të NJVV që mbështet funksionin Ndriçimi i Hapësirave Publike shoqërohet me katër (4) tregues të performancës, nga të cilët dy (2) janë tregues financiar – i) shpenzime për ndriçimin e hapësirave publike dhe ii) të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike dhe (2) tregues specifikë - sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim dhe ii) shkalla e sipërfaqes publike e mbuluar me ndriçim në raport me sipërfaqen gjithsej të bashkisë (në %).

Në vitin 2020, norma mesatare e sipërfaqës publike të mbuluar me ndriçim ka qënë 15.5% krahasuar me 16% të raportuar për vitin 2019, pra 0.5 p.p. më pak¹²⁸.


Grafik 74: Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)



Në kuadër të agjendës së integritimit evropian dhe detyrimeve që rrjedhin nga kriteri “aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit (kapitulli 15 për energjinë), në vitin 2019 vetëm 14% e bashkive kishin caktuar menaxherin për eficientë e enegjisë¹²⁹, si detyrime që rrjedhin edhe nga PV 2019-2030 SKEE¹³⁰.

Shpenzimet e programit “Shërbime publike vendore”, 06260

Shpenzimet e programit duhet të përfshijnë kryesisht shpenzimet për menaxhimin e hapësirave të gjelbërta, trotuareve për ecje, menaxhimin e varrezave publike, dekorit të qytetit. Janë shërbime që zakonisht ofrohen nga burimet e veta të bashkisë, ku perfshihen dhe tarifat e gjelbërimit, të cilat aplikohen nga disa bashki. Tek shpenzimet e këtij programi, disa bashki përfshijnë edhe shërbime të tjera, si mirëmbajtjen e kanalizimeve, menaxhimin e mbetjeve etj. Kjo është karakteristikë për ato bashki që i menaxhojnë me njësi shpenzuese/ndërmarrje publike këto shërbime. Është e domosdoshme ndarja e kostove dhe ky program duhet të përfshijë vetëm 3-4 shpenzimet e cituara më lart.



128 Bashkia Kelcyrë ka raportuar një

129 Burim: Raporti “Bashkitë në procesin e integritimit evropian” (për vitin 2019)

130 Strategjia Kombëtare për Eficientë e Energjisë (SKEE)


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 18% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Krahasueshmeria nuk garanton saktësi, për arsyt e cituara më sipër. Megjithatë mesatarisht shpenzimet e programit zënë 10% ndaj totalit të shpenzimeve të bashkive. Bashkitë Finiq dhe Këlcyrë kanë përqindje të programit ndaj totalit të shpenzimeve më të lartë (27%).

Grafik 75: Shpenzimet e programit “shërbime publike vendore” (në % ndaj buxhetit total), 2020



Shpenzimet e Personalit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Peshë të rëndësishme në program zënë pagesat e personalit (45%). Krahas mirëmbajtjes së shërbimeve, vihet re që mesatarisht është investuar në masën 16% të shpenzimeve të programit. Peshë investimesh të larta brenda programit kanë bashkitë Libohovë, Shijak dhe Fushë Arrëz.



Shpenzimet e programit “Ndriçimi publik”, 06440

Ndriçimi publik është një shpenzim që mbështetet nga të ardhurat e veta të bashkisë, ku përfshihen dhe të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik që paguajnë familjet dhe biznesi, prandaj ndriçimi me kosto sa më të ulët dhe më efçente është objektiv për bashkitë.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 11% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Programi ndaj shpenzimeve total të bashkisë zë mesatarisht 3%. Por, ka Bashki që vlerësojnë më shumë këtë program dhe shpenzimet ndaj totalit zënë peshën më të lartë. Nga Bashkitë Elbasan, Lezhë dhe Shkodër shpenzimet e programit zënë 6% të shpenzimeve total të bashkisë.

Grafik 76: Buxheti i programit “Ndrëimi publik” ndaj buxhetit total të bashkisë (në %), 2020



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)


Pesha e shpenzimeve operative dhe mirëmbajtjes zë 75% të shpenzimeve të programit. Kuptohet, se programi ka shpenzime të konsumit të energjisë për ndriçimin publik dhe mirëmbajtjes së rrjetit. Bashkitë të cilat kanë normë më të lartë të investimeve se mesatarja 15%, janë Himara (100%) dhe Lezha (60%).



Rezultatet e sondazhit me qytetarët


Për programin Ndrëim rrugësh, nga rezultatet e sondazhit, vihet re se rreth 49% e të anketuarve (559 persona) shprehet se duhen rritur shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa rreth 43% (489 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit për këtë program. Ndërsa, një masë e vogël prej vetëm 5% e popullsisë (57 persona) ka votuar për uljen e shpenzimeve.

Grafik 77: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Ndriçim rrugësh




Lidhur me performancën e këtij shërbimi, rreth 36% e të anketuarve (406 persona) shprehen ‘të pakënaqur’ ndërsa 35% (393 persona) e të anketuarve shprehen ‘të kënaqur’. Sa i takon pjesës tjetër, 28% (313 persona) kanë përzgjedhur opsionin “neutral”.

Grafiku 78: Mendimi i banorëve për performancën e programit Ndriçim rrugësh



Sa i takon qasjes së banorëve lidhur me mundësinë për të paguar më shumë taksa ose tarifa për këtë program, vëmë re se 59% e popullatës së anketuar (1,735 persona) shprehet kundër ndërsa 41% pro (1,225 persona). Ndër bashkitë të cilat nga rezultatet paraqiten jo të gatshme për të paguar më shumë taksa janë: Gjirokastra në masën 72% (53 persona), Fieri në masën 71% (383 persona), Kuçova në masën 71% (234 persona), etj, ndërsa bashkitë të cilat janë pro opsionit për të paguar më shumë taksa lidhur me këtë shërbim, janë: Himara në masën 66% (91 persona), Roskoveci në masën 59% (57 persona), Patosi në masën 59% (64 persona), etj.

Grafik 79: Gadishmëria e banorëve për të paguar më shumë taksa për Ndriçim rrugësh



Gjetje dhe rekomandime

- Mesatarisht, bashkitë kanë një sipërfaqe të ndriçuar rreth 8%, por treguesi ndryshon në një shkallë të gjerë midis bashkive.

- Shpenzimet e programit për hapësirat e gjelbërta Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 18% krahasuar me vitin 2019. Pagat e personelit zënë rreth 45% të buxhetit të programit dhe investimet mesatarisht rreth 16%.
- Shpenzimet e programit/shërbimit për ndriçim të rrugëve janë rritur mesatarisht me 11% krahasuar me vitin 2019, dhe përbëjnë rreth 3% të totalit të shpenzimeve të bashkisë; Pesha e shpenzimeve operative dhe mirembajtjes zë 75% të shpenzimeve të programit.
- Në vitin 2019, vetëm 14% e bashkive kishin caktuar menaxherin për efçencën e enegjisë. Të gjitha bashkitë duhet të caktojnë menaxherin për efçencën në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.
- **49%** e të anketuarve shprehet se duhen rritur shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa rreth **43%** shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit.
- Lidhur me *performancën* e këtij shërbimi, rreth **36%** e të anketuarve shprehen të pakënaqur ndërsa **35%** e tyre shprehen të kënaqur.
- Pyetjes se si banorët gjykojnë për të paguar më shumë taksa ose tarifa për këtë program, rreth **59%** e popullatës së anketuar (1,735 persona) shprehet kundër ndërsa **41%** pro rritjes së tarifës së shërbimit.
- Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e legjislacionit për efçencën e enegjisë dhe performancën e enegjisë në ndërtesat që po rindërtohen pas tërmetit¹³¹.
- Plani i Veprimit Kombëtar për EE (efçencën e enegjisë) i përditësuar të përmbajë targets lidhur me ndriçimin e hapësirave publike si një sektor i përcaktuar si konsumator i gjerë i enegjisë¹³².
- Për arsye të mungesë së të dhënave, nuk u mundësua analiza financiare e shërbimit për vitin 2020 (si, mbulimi i kostos së ndriçimit publik nga tarifa e shërbimit (në %), dhe kosto mesatare për ndriçimin e 1 km katror hapësirë publike (Mijë lekë/km²).

3.18 Arsimi parauniversitar

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve. Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollor.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Prioritetet afatmesme të politikave për sistemin arsimor parauniversitar janë: (i) sigurimi i një arsimit cilësor me synim plotësimin e standardeve Europiane për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies; (ii) pjesëmarrje për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar; (iii) Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave digjitale për kurrikulën e arsimit bazë; (iv) Përmirësimi i infrastrukturës (rehabilitimi/dhe ndërtimi i kopshteve e shkollave sipas standardeve) dhe shtrirja e shërbimit të punonjesit social dhe psikologut në shkollat e sistemit arsimor parauniversitar. Zhvillimi dhe miratimi i standarteve për projektimin e shkollave dhe kopshteve/çerdheve dhe standarteve të tjera të funksionit është përgjegjësi e institucioneve qëndrore (Kryeministrisë dhe MASR). Është miratuar draft Strategjia kombetare e Arsimit parauniversitar, 2021-2026.

Në 2020, objektivat për arsimin gjithpërfshirës kanë synuar që 100% e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin bazë, rritja e rregjistrimit me 10-15 % të fëmijëve të pakicave rome dhe egjiptiane, dhe 5-10% për nxënësit me AK; rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me AK dhe ulja e braktisjes së shkollës në 0.56%. Synime të tjera të politikës për arsimin parauniversitar për vitin 2020:

¹³¹ Raport Progresi i KE për Shqipërinë, 2020

¹³² Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjës Vendore, 2019 (projekt i financuar nga IPA, URI, 2019)

- Nga rreth 98% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë, rreth 65% e tyre të rregjistrohen në një nga format e arsimit të mesëm, dhe 35% të rregjistrohen dhe ndjekin arsimin profesional;
- Deri në vitin 2022 synohet të përmiresohet rezultati dhe renditja e Shqipërisë në vlerësimin ndërkombëtar PISA.
- Raporti nxënës për klasë, 2019-2020; synohet arritja e standardit evropian, jo më shumë se 28 - 30 nxënës për klasë në zonën urbane në vitin 2022, jo më shkolla me dy turne apo ora mësimorë paradite dhe pasdite.

Në kuadër të agjendës së integritimit evropian dhe detyrimeve që rrjedhin nga kritëri III “Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimin” (kapitulli 26 – arsimit dhe kultura), bëhet vlerësimi i progresit të NJVV në këtë fushë sipas një grupi treguesish: Rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor (7 tregues¹³³), Rritja e pjesëmarrjes në institucionet e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e grupeve të marxhinalizuara (3 tregues), Përmirësimi i infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar (2 tregues), Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes duke krijuar një komunikim shkollë-prindër-qeveri (2 tregues).

Në 2020, fondi i buxhetit në fushën e arsimit kanë qënë 7.66% e shpenzimeve publike ose 2.27% ndaj PBB; fondet grant të buxhetit për shërbimin në arsimin parashkollor si dhe për burimet njerëzore për këtë shërbim janë të decentralizuar dhe administrohen nga bashkitë. U mundësua financimi për 72 projekte/kontrata të miratuara në vitin 2018-2019, dhe kontrata në vazhdim nga viti 2019, me vlerë të plotë financimi 4 miliard e 459 milion lekë¹³⁴. Për vitin 2020 kanë përfituar tekste shkollore falas, 231,540 nxënës me një efekt financiar prej 863.7 milion lekë, nga të cilët 215,434 nxënës në arsimin 9-vjeçar dhe 16,106 nxënës në arsimin e mesëm të lartë. Ofrimi i kuotës ushqimore dhe bursa me fonde të buxhetit të shtetit, për rreth 1300 -1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë (fondi 94.6 milion lekë në vit); 482 fëmijë nga pakicat rome dhe egjiptiane u përjashtuan nga pagesa në arsimin parashkollor gjatë 2020 (174 vajza dhe 308 djem)¹³⁵.

Në nivel vendor, administrimi i funksionit nga bashkitë në fushën e arsimit parauniversitar dhe sistemin parashkollor (pa përfshirjen e shkollave profesionale) bazohet në Kushtetutën e RSH, Ligj nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, Ligj 139/2015, neni 23, pika 11 dhe 12 dhe akte të tjera nënligjore dhe vendime të Këshillit të Ministrave (Vendim i Kryeministrit nr. 127/2015) dhe vendimet e Ministrisë së Arsimit (nr. prot. 10799/2015 dhe nr. 11166/2015) mbi transferimin e dokumentacionit për edukatorët dhe punonjësit mbështetës të sistemit parashkollor dhe mësuesit dhe punonjësit mbështetës të sistemit shkollor parauniversitar dhe fondin përkatës.

Roli dhe detyrat e bashkive lidhur me funksionin përfshijnë propozim për ndërtimin e godinave të reja të sistemit para-universitar / ose rehabilitimin e godinave ekzistuese, përgatitjen e projektit dhe aplikimit për financim (nëse ndërtimi/ose rehabilitimi i godinës do të financohet nga fondet e qeverisë), mbikqyr zbatimin e projekteve për ndërtimin dhe rehabilitimin e godinave të sistemit parauniversitar, realizon mirëmbajtjen dhe shërbimet higjieno-sanitare dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit, garanton ruajtjen e godinave nga dëmtimet dhe shkeljet dhe bashkëpunon me ZAV për rregjistrimin e fëmijëve në sistemin shkollor të detyrueshëm. Gjithashtu, bashkitë bazuar në propozimin e strukturës për arsimin dhe ZAV, ofrojnë mbështetje për nxënësit e familjeve në nevojë, nxënësit me rezultate shumë të larta, trajnimin e mësuesve dhe paisjen me bazë materiale të institucioneve të arsimit parauniversitar.

133 BpE (projekt IPA): Raporti Bashkitë në procesin e IE: numri i kopshteve dhe kapaciteti i tyre, fushata ndërgjegjësimi për rregjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç, fond i investimit, etj; Parashikimi i infrastrukturës PAK në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashki, Nisma të bashkisë për të mbështetur ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri, etj.

134 Burim:Raporti i Monitorimit (MAS, 2020); http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/12-Raporti-i-Monitorimi-12_M-Janar-31-Dhjetor-2020_Final-01.03.2021_FN.pdf


135 Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane (PKIRE), 2021

Rezultatet e performancës së shërbimit

Në fushën e arsimit parashkollor, progres është realizuar në hartimin dhe miratimin e Standarteve Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit të Arsimit Parashkollor dhe hartimin e programeve të kualifikimit për mësuesit e arsimit parashkollor; Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor është plotësuar dhe janë hartuar Standardet e zhvillimit dhe të nxënimit për programet e moshës 3-4 vjeç.


Në vitin shkollor 2019-2020, **niveli mesatar i rregjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-6 vjeç në sistemin parashkollor** ka qënë **81%** për 28 bashki që kanë ofruar të dhëna në raportet e performancës për vitin 2020, krahasuar me nivelin 80% për vitin 2019, ose 82%-83% në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020 sipas raportimit të MASR.

Grafik 80: Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç, viti shkollor 2019-2020



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=28)

Grafik 81: Numri i fëmijëve për grup në sistemin parashkollor, 2019-2020




Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=20)

Vlera mesatare për numrin e fëmijëve për grup në kopshtë ka qënë 12 në vitin 2020, kundrejt 15 në vitin 2019 (n = 20).

Një tjetër treguesi i performancës së shërbimit lidhet me numrin **mësues/edukator për grup fëmijësh në sistemin parashkollor**. Të dhënat e vlefshme nga bashkitë (n=18) për 2020, evidentojnë që mesatarisht në


sistemin parashkollor ishte **një (1) mësues për 12 fëmijë** në sistemin parashkollor kundrejt raportit 1 mësues për 15 fëmijë në vitin 2019; vlera minimale raportohet në Bashkinë Mat (1 mësues për 5 fëmijë), Bashkia Fushë Arrë (1 mësues për 6 fëmijë) dhe max në Bashkinë Bulqizë (1 mësues për 20 fëmijë).

Grafik 82: Mësues në Sistemin parashkollor për grup fëmijësh, 2019-2020



Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë për vitin shkollor 2019-2020 ka qënë **14** kundrejt **15** nxënës për klasë në vitin shkollor **2018-2019** (13 bashki të kampionit), pra ky tregues rezulton të jetë më i vogël për bashkitë raportuese kundrejt synimit të politikës që në vitin 2022, të arrihet standardi evropian, jo më shumë se 28 - 30 nxënës për klasë në zonën urbane.


Grafik 83: Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë, 2020 (standard)



Përputhshmëria me Standardet Kombëtare të Arsimit Parashkollor

Bashkive u kërkohet të përmbushin një numër standardesh dhe kërkesash në të gjitha fushat përkatëse të funksionit të arsimit parashkollor të vendosura nga qeveria qendrore. Situata e përputhshmërisë monitorohet nga anketimi kombëtar i arsimit parashkollor i cili është krijuar për të mbledhur, përshkruar dhe vlerësuar përputhshmërinë e bashkive dhe agjencive të tjera të dekoncentruara me standardet kombëtare dhe kërkesat ligjore në ofrimin e shërbimit të arsimit parashkollor. Disa bashki përmbushin më shumë se 80% të standardeve. Në përgjithësi, 22 bashki përmbushin më shumë se 60% të standardeve, ndërsa shtatë bashki përmbushin më pak se 40% të standardeve¹³⁶.

¹³⁶ Rezultatet e sondazhit MASR, 2019/2020 - Anketimi kombëtar i gjendjes së arsimit parashkollor në bashkitë shqiptare mbështetet në një hulumtim intensiv të akteve ligjore dhe rregulloreve, si dhe standardeve që përcaktojnë kontributin, procesin dhe rezultatet e ofrimit të arsimit parashkollor. Të dhënat u grumbulluan duke përdorur një pyetësor, të cilët u plotësuan nga punonjësit e Zyrave Arsimore Vendore dhe punonjësit përgjegjës të njëjësive të administratës në bashki. U përgjigjën 60 nga 61 bashki, përveç kësaj 51 ZVAP-e dhe 4 DRAP-e gjithashtu dhanë informacion.



- Vetëm për standardin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, gati të gjitha bashkitë i përmbahen standardit kombëtar.
- Duke iu referuar standardeve “udhëzimit për numrin e fëmijëve për grup”, vetëm 41 bashki (ose 67%) janë në përputhje me standardin.
- 24 bashki (39%) nuk kanë një punonjës social për fëmijët në arsimin parashkollor; në disa bashki të tjera, ka 1 psikolog për rreth 63 deri në 2085 fëmijë.
- Duke iu referuar standardit “Sipërfaqja e brendshme e kopshtit” prej 2.5m² për fëmijë, rreth 20 bashki (ose 32.8%) nuk janë në përputhje me standardin. Aksesit për fëmijët me aftësi të kufizuara sigurohet në shkallë të plotë vetëm nga 6 bashki (më pak se 10% e tyre) ¹³⁷.

Shpenzimet e programit “Arsimi bazë dhe parashkollor, 09120

Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat që vijnë nga transfertat specifike (Fondet për personelin mësimor në kopshte në arsimin parashkollor), transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme që ka si kriter numrin e fëmijëve dhe të nxënësve në arsimin bazë dhe nga transfertat e kushtëzuar për trajtimin e disa kategorive të veçanta në nevojë dhe aktiviteteve si ushqimi në shkollë. Pjesa tjetër neto e shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat e veta të bashkisë ku përfshihen dhe të ardhurat nga tarifa e ushqimit në kopshte.

Arsimi parashkollor është përgjegjësi e plotë e NjVV-së. Transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme diferencojnë arsimin parashkollor dhe llogaritet për çdo bashki bazuar në kriterin e numrit të fëmijëve në arsimin parashkollor, i kombinuar me numrin e personelit mësimor në arsimin parashkollor (60% mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatorëve pranë këtyre kopshteve).

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 0.1% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 18%. Janë 9 bashki, ku shpenzimet e programit zënë nga 20%-22% të totalit të buxhetit të bashkisë. Ndërsa me normë shumë të ulët deri 6%, buxheti i programit zë tek bashkitë Dropull, Finiq, Fushë Arrëz, Këlcyrë.

Grafik 84: Buxheti i programit të arsimit bazë dhe parashkollor, 2019-2020




137 Burimi: Anketimi Kombëtar për Arsimin Parashkollor në Bashkitë Shqiptare (2019-2020)

Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit, mesatarisht 73%, ndërsa shpenzimet e tjera korente dhe investimet zënë përkatësisht 13% dhe 14% të shpenzimeve.


Grafik 85: Struktura e shpenzimeve të Programit sipas klasifikimit ekonomik



Treguesi 000 lek shpenzime/nxënës të arsimit bazë dhe parashkollor të regjistruar

Mesatarisht tek çdo nxënës në arsimin bazë dhe parashkollor publik kanë shkuar 54 mijë lek/nxënës. Rreth 48% e bashkive janë nën mesataren e shpenzimeve/nxënës.

Grafik 86: Shpenzime për nxënës në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, 2019-2020



Arsimi i përgjithshëm

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore; Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; Shpenzimet për paga për stafin mbështetës; Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave; Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.

Për të matur performancën e shërbimit në nivel vendor për arsimin e përgjithshëm janë zgjedhur tre tregues: (i) Kosto mesatare e bashkisë për një nxënës në shkollën e mesme (mijë Lekë/nxënës/vit); (ii) Numri i nxënësve të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm publik kundrejt numrit total të nxënësve që përfundojnë arsimin bazë (9 vjeçar), dhe (iii) Numri mesatar i nxënësve në klasë.


Treguesi: Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm kundrejt numrit të plotë të nxënësve që përfundojnë arsimin bazë (9 vjeçar).

Ka patur mungesë të dhënash nga bashkitë për të mundësuar llogaritjen e shkallës së regjistrimit të fëmijëve në arsimin e mesëm (të përgjithshme).

Treguesi: Numri mesatar i nxënësve në klasë në arsimin e përgjithshëm

Në vitin shkollor 2019-2020, numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin e përgjithshëm ishte 17 nxënës/klasë për 24 bashki që kanë ofruar të dhëna të vlefshme, kundrejt 25 nxënës për klasë për vitin 2018-2019. Siç paraqitet në grafikun më poshtë, treguesi varion në një fushë të gjerë, nga 5 nxënës për bashkitë Mat dhe Vau i Dejës, Bashkia Cërrik (36 nxënës/klasë) dhe Bashkia Lezhë (42 nxënës/klasë).


Grafik 87: Numri mesatar i nxënësve në klasë në arsimin e përgjithshëm



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=24)

Bashkitë raportuese janë bashki të kategorisë së mesme dhe të vogla; vetëm dy bashki kanë patur numër të lartë të nxënësve për klasë kundrejt standartit të synuar për vitin 2022 (28 -30 nxënës/klasë në zonat urbane).

Grafik 88: Nxënës për klasë në arsimin e mesëm, 2020/2019



Shpenzimet e programit “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” – 09230

Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat që vijnë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për pagesat e personelit, transfertat e kushtëzuar për pagesën e nxënësve bursistë dhe transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme që bashkitë e përfitojnë bazuar në numrin e nxënësve fakt në shkollën e mesme të përgjithshme. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulojnë nga të ardhurat e veta të bashkisë dhe përdoren për të siguruar dhe mirëmbajtur objektet shkollore dhe paguar rrogat e stafit mbështetës.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 11% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 4%. Nën këtë vlerë janë 22 Bashki, ose 63% e tyre. Programi me % më të ulët, nga 0-1% të totalit, paraqitet tek 10 Bashki ose 29% te 4 tyre.


Grafik 89: Buxheti i programit të arsimit të mesëm (në lek) dhe ndaj buxhetit të bashkisë, 2019-2020



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit, mesatarisht 52%, ndersa shpenzimet e tjera korente dhe investimet zënë përkatësisht 23% dhe 25% të shpenzimeve.

Grafik 90: Struktura e shpenzimeve të programit të arsimit të mesëm



Shpenzimet e programit “Arsimi i mesem profesional” – 09240


Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat që vijnë nga transferta e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe nga tarifa nga mensat e konvikteve. Ndërsa shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera të veta të bashkisë për funksionin e arsimit profesional. Shkollat e mesme profesionale u përkasin Bashkive Dibër, Lezhë, Mirditë, Shkoder, Vau Dejës.

- Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 7% krahasuar me v.2019.
- Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 0.3%.
- Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit, mesatarisht 83%, ndërsa shpenzimet e tjera korente dhe investimet zënë përkatësisht 15% dhe 2% të shpenzimeve.

Rezultatet e sondazhit me qytetarët


Rreth 51% e të anketuarve (4,603 persona) shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa 37% e popullsisë (3,384 persona) shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit nga ana e bashkisë për këtë program; vetëm 4% e popullsisë (403 persona) ka votuar për uljen e shpenzimeve. Rezultatet e marra evidentojnë rëndësinë e këtij programi në për qytetarët.

Grafik 91: Mendimi i qytetarëve lidhur me shpenzimet për programin “Arsimi parashkollor dhe arsimit bazë”



Ndërsa, sa i takon pyetjes lidhur me performancën e këtij shërbimi, në nivel të përgjithshëm, rezultatet e sondazhit na tregojnë se rreth 35% (3,207 persona) kanë përzgjedhur opsionin ‘neutral’ për të shprehur vlerësimin e tyre, ndërsa 34% (3,057 persona) janë të kënaqur me shërbimin e ofruar.

Grafik 92: Mendimi i banorëve për performancën e programit Arsim parashkollor/arsimit bazë




Sa i takon qasjes së banorëve lidhur me mundësinë për të paguar më shumë taksa ose tarifa për këtë program, vëmë re se diferenca mes përgjigjeve pro dhe kundër është shumë e vogël. Rreth 51% e popullatës së anketuar (4,364 persona) shprehet kundër rritjes së buxhetit ndërsa 49% pro rritjes së fondit për këtë program (4,247 persona).

Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

Për programin Arsim i mesëm i përgjithshëm, nga të dhënat e marra vihet re se ky program nuk ka rezultate për të gjitha bashkitë. Megjithatë, nga përgjigjet e marra, rezulton se rreth **48%** (1,103 persona) ka qasje pozitive lidhur me rritjen e shpenzimeve për këtë program dhe po ashtu një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve në masën **42%** (965 persona) shprehen dakort me nivelin aktual të shpenzimeve nga ana e bashkive për këtë program.


Bashkitë të cilat janë shprehur në masën më të madhe të tyre pozitivisht lidhur me rritjen e shpenzimeve, janë: Gjirokastra me 66% (59 persona), Shkodra me 66% (101 persona), Korça me 56% (22 persona), Vlora me 55% (204 persona), Durrësi me 54% (91 persona), Kuçova me 54% (191 persona), Tepelena me 48% (39 persona) dhe Fushë Arrëzi me 43% (33 persona). Gjithashtu, dakort me nivelin aktual të shpenzimeve janë bashkitë: Mirditë në masën 64% (49 persona), Patos në masën 61% (71 persona), Lezhë në masën 55% (86 persona), Kolonjë në masën 54% (79 persona), dhe Skrapar në masën 49% (18 persona).

Grafiku 93: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Arsim i Mesëm i Përgjithshëm



Sa i takon vlerësimit të banorëve lidhur me performancën e këtij shërbimi, rreth **36%** e të anketuarve (819 persona) kanë shprehur 'shumë mirë', **34%** (793 persona) kanë mendim neutral dhe **23%** (536 persona) janë të pakënaqur.

Grafiku 94: Mendimi i banorëve për performancën e programit Arsim i mesëm i përgjithshëm



Gjetje dhe rekomandime

- Regjistrimi dhe rezultatet në shkollat e mesme dhe në universitete janë rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë dekadës së fundit, megjithatë nivelet e përgjithshme të arsimit dhe shpenzimeve publike për arsimin mbetën nën mesataren e vendeve të OECD-së dhe të BE-së⁹⁵.
- Në vitin shkollor 2019-2020, niveli mesatar i rregjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-6 vjeç në sistemin parashkollor ka qënë **81%** në bashkitë e kampionit (82% -83% raportimi nga MASR). Norma mesatare ka qënë 1 Mësues/edukator për 13 fëmijë në grup në sistemin parashkollor në 2020.

- Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë për vitin shkollor 2019-2020 ka qënë **14** në vitin shkollor 2019-2020 për bashkitë e kampionit. Synimi i politikës së qeverisë është që numri i nxënësve të jetë jo më shumë se 28 - 30 nxënës për klasë, në zonat urbane.
- Gjatë 2 viteve të fundit, regjistrimet në arsimin parashkollor (në vlerë absolute), të mesëm dhe të lartë kanë rënë lehtë. Shkak është ulja e lindshmërisë dhe migracioni¹³⁸.
- 24 bashki (39%) nuk kanë një punonjës social për fëmijët në arsimin parashkollor; në disa bashki të tjera, ka 1 psikolog për rreth 63 deri në 2085 fëmijë¹³⁹.
- Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin e përgjithshëm ishte 17 nxënës/klasë për 24 bashki që kanë ofruar të dhëna të vlefshme, në vitin shkollor 2019-2020 (treguesi ndryshon midis bashkive). Faktorë ndikues mund të jenë migrimi i popullsisë dhe mungesa e dallimit të treguesit për shkollat në zonat urbane dhe zonat jo urbane, si dhe mungesa e të dhënave nga të gjitha bashkitë e kampionit për të arritur një përfundim përgjithësues.
- Për arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, rreth **51%** e të anketuarve shprehet se duhen shtuar shpenzimet nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa 37% shprehet dakort me nivelin aktual të shpenzimit.
- Lidhur me performancën e shërbimit (arsimi parashkollor dhe arsimi bazë) rreth **35%** e të anketuarve kanë qënë 'neutral' për të shprehur vlerësimin e tyre, ndërsa **34%** të kënaqur. Mbi pyetjen si e gjykojnë dobinë për të paguar më shumë taksa ose tarifa për këtë program përkundrejt përmirësimit të shërbimit, **51%** e popullatës së anketuar shprehet kundër rritjes së buxhetit, ndërsa **49%** pro rritjes së fondit për shërbimin.
- Për programin Arsim i mesëm i përgjithshëm, rreth **48%** ka qasje pozitive lidhur me rritjen e shpenzimeve për këtë program ndërsa **42%** shprehen dakort me nivelin aktual të shpenzimeve.
- Lidhur me performancën e shërbimit për arsimin e mesëm të përgjithshëm, rreth **36%** e të anketuarve e vlerësojnë 'shumë mirë', **34%** neutral dhe **23%** janë të pakënaqur.
- Bashkitë, në kuadër të raporteve të performancës ose RMZB të ofrojnë të dhëna të plota për shpenzimet për programet në fushën e arsimit për të mundësuar një analizë të plotë të shpenzimeve buxhetore dhe analizës kosto eficientë.
- Treguesit për programin e arsimit të jenë diskretë për zonat urbane dhe rurale.

3.19 Funkcionet e Bashkive në fushën e shërbimeve sociale

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Shërbimet sociale (të kujdesit shoqëror) përfshijnë zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës, përkujdesje sociale me standarte të përmbushura dhe përfshirje sociale e grupeve në nevojë (vulnerabël), ndërsa në nivel të vetëqeverisjes vendore ofrojnë (i) krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj (skema e ndihmës ekonomike (NE), pagesat e aftësisë së kufizuar, shërbimet e kujdesit social në qendra ditore dhe qendrat rezidenciale) (ii) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, (iii) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore; (iv) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj¹⁴⁰. Kujdesi social udhëhiqet nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 dhe SKZHI, 2015-2020.

138 Raport Progresi i KE për Shqipërinë (2020)

139 Rezultatet e sondazhit MASR (2019-2020)

140 Ligj 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 24

Rritja e efijencës për ofrimin e shërbimeve sociale me fokus (a) hartimin dhe miratimin e standarteve të shërbimeve dhe kostove për njësi, (b) ngritja e kapaciteteve të NJVV për planifikimin e shërbimeve sociale (identifikimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të shërbimeve sociale), dhe (c) plotësimi i paketës rregullatore për mënyrën e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, (ç) rishikimi i skemës së jashtëkontraktimit dhe prokurimit të shërbimeve të kujdesit social nga NJVV, dhe rishikimi i ligjit për shërbimet sociale për të siguruar efijencë më të lartë të procedurave vendimmarrëse brenda NJVV për menaxhimin e shërbimeve sociale janë aktivitete të planifikuara në PV 2020-2022 të SNDQV (C1.10).

Në kuadër të agjendës së integritit evropian dhe detyrimeve që rrjedhin nga kritëri III “Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit” (kapitulli 19 – Politikat sociale dhe punësimi), bëhet vlerësimi i progresit të NJVV në këtë fushë sipas një grupi treguesish: 1. Mbrojtja sociale në nivel vendor (10 tregues), 2. Përfshirja sociale në nivel vendor (6 tregues), 3. Mbështetja për programet aktive të punës (7 tregues)¹⁴¹.

Në 2020, progres është arritur në hartimin e standarteve të shërbimit të emergjencës së sigurt, standartet për ri-integrimin e viktimave të trafikimit, si dhe të shërbimit lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara; trajnime me administratorët shoqërorë dhe stafin e strukturave përkatëse lidhur me Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore, mbi menaxhimin e rastit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (në bashkëpunim me ASPA); Plotësimi me akte nënligjore të ligjit të ri të prokurimeve (miratuar në dhjetor 2020) për mënyrën e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror pritet të hartohet nga Agjencia e Prokurimeve dhe MSHMS (2021-22)¹⁴².

Kuadri ligjor është i gjerë, por **kërkesat ligjore në ofrimin e shërbimeve në fushën e shërbimeve sociale** janë:

- Çdo njësi administrative (NJA) e bashkisë duhet të ketë një (1) administrator shoqëror (Ligj 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”);
- Numri i punonjësve socialë në bashki përcaktohet sipas Ligj 121/2016 “Për shërbimin social” – një (1) punonjës social / 10,000 banorë;
- Njësia e Vlerësimit të Nevojave ngrihet për çdo NJA (Ligj 121/2016);
- Numri i punonjësve PMF në NJVV përcaktohet sipas kërkesës - Një (1) punonjës për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve (PMF) për 3000 fëmijë (Ligj 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.

Shërbimet e kujdesit social

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë; Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike; Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t’i ndihmuar në detyrat e përditshme; pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të PAK, shërbime dhe përfitime të ndryshme, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse; Vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.

Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në RSH”, neni 8 përcakton kategoritë e përfituesve për aftësinë e kufizuar dhe invalidët e punës. Gjithashtu, Ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në RSH” dhe VKM nr. 597/2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike”, përcakton rregullat për aplikim për të përfitur nga skema e ndihmës ekonomike dhe mënyrën e ankimimit. Për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror i njësisë administrative, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien

141 BpE (projekt IPA): Raporti Bashkitë në procesin e IE (2020)

142 Raport i Monitorimit SNDQV, PV 2020-2022 (MB 2021)

e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe/ose me fonde të tjera të buxhetit vendor.

Në vitin 2020, fondi i shpenzuar për përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike ishte 5,434,290,505 lekë dhe për PAK ishte 18,453,169,382 lekë¹⁴³.

Tabela 4: Mesatarja vjetore e përfituesve sipas pikëzimit

| Viti | Nr. Aplikimeve | Nr. Përfituesve | Raporti përfitues/aplikime (%) | Nr.aplikime kategoria NE | Nr. përfituesve familje në nevojë | Refuzuar total (NE) | Nga këta refuzuar për mospërputhje |
|------------------------------|----------------|-----------------|--------------------------------|--------------------------|-----------------------------------|---------------------|------------------------------------|
| 2019 | 67141 | 62002 | 92.3% | 65491 | 60439 | 5052 | 2090 |
| 2020 | 66841 | 62821 | 93.98% | 65248 | 61190 | 3919 | 1927 |
| Ndryshimi (2020/2019) | (300) | 819 | | | 751 | (1133) | (163) |

Burim: SHSSH¹⁴⁴

Në vitin 2020, përsa i përket trajtimit të familjeve me fondin deri në 6%, mesatarja vjetore për 2020 është 3700 familje në nevojë, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2019. Nga viti 2019 në 2020, numri i individëve që përfshihen në pagesën e aftësisë së kufizuar, është rritur me 2,887 persona. Përsa i përket zbatimit të legjislacionit të pagesave të NE dhe pagesat e PAK, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kontrolluar 134 njësi vendore në 2020, ku janë konstatuar 1275 raste në kundërshtim me legjislacionin dhe janë propozuar 109 masa, 22 masa administrative dhe 11 raste gjobë.

Tabela 5: Përfituesit e PAK në qarqe, 2018 – 2020


| 12 Qarqet | Individë me pagesën e AK (2018) | Individë me pagesën e AK (2019) | Individë me pagesën e AK (2020) |
|--------------|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| TOTAL | 69,743 | 72,183 | 73,200 |

Rezultatet e performancës së shërbimit

Treguesi: Numër personash të mbështetur me pagesë invaliditeti dhe paaftësie (ndryshimi vjetor në numër)

Në 2020, niveli mesatar i ndryshimit të numrit të personave të sëmurë dhe të trajtuar me pagesë invaliditeti në krahasim me vitin 2019 ishte 175 persona (2020/2019, për bashkitë e kampionit (N=11). Bashkia Korçë ka patur një ndryshim të konsiderueshëm të numrit (+1107), ndjekur nga bashkia Elbasan (+457) për vitin 2020.

Grafik 95: Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti (ndryshimi vjetor në numër 2020/2019)



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=12)

143 (50) Burim: MFE dhe SHSSH; <http://www.shërbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/ANALIZA-VJETORE-2020.pdf>


144 Burim: MFE dhe SHSSH; <http://www.shërbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/ANALIZA-VJETORE-2020.pdf>

Siç tregohet në grafikun e mësipërm, Bashkia Elbasan ka mbështetur me pagesë invaliditeti 457 më shumë individë në 2020 krahasuar me 2019, Bashkia Bulqizë (135), Bashkia Lezhë (90), ndërsa bashkitë e tjera kanë ofruar mbështetje për një numër shtesë individësh nga 8-55, ndërsa Bashkia Klos ka patur 8 individë më pak (ose -8) në 2020/2019 dhe Bashkia Kukës (-40).

Për treguesin ‘numri i individëve të mbështetur me ndihmë ekonomike dhe fondi përkatës’


Ndryshimi gjithsej i numrit të personave të mbështetur me ndihmë ekonomike ka qënë 43 persona më shumë të mbështetur në vitin 2020 kundrejt vitit 2019 (n=12). Vihet re se disa bashki kanë raportuar një numër të konsiderueshëm më të ulët të personave të mbështetur në 2020/2019, si Bashkia Cërrik (-311), Delvinë (-480), Bashkia Këlcyrë (+600), Bashkia Pukë (+821).

Grafik 96: Persona të mbështetur (pa.pu) me asistencë sociale, ndryshimi 2020/2019



Në vitin 2020, fondi social ndryshon në një fushë nga 19,591 lek për bashkinë Delvinë në 201,402 lek për Bashkinë Roskovec.

Grafik 97: Fond social për personat e papunë, 2020 (në lek)



Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 28 institucione publike të përkujdesit social, nga të cilat 11 janë në varësi të Shërbimit Social dhe pjesa tjetër (17) janë në varësi të pushtetit vendor. Në nivel kombëtar, në 2020, numri i personave të moshuar në IPSH ishte 301 (ose 17 persona më pak kundrejt vitit 2019¹⁴⁵).

Në nivel bashkie, për treguesin ‘**Familje dhe fëmijë të mbështetur me kujdes social (ndryshimi në numër)**’, janë ofruar të dhëna nga 5 bashki për 2020 dhe 2019 ndërsa 3 bashki kanë ofruar të dhëna të pjesëshme. Edhe për treguesin ‘**shpenzime për moshën e tretë në qendrat rezidenciale / numrin e personave të shërbyer**’, vetëm 2 bashki kanë ofruar të dhëna të vlefshme.


Treguesi: Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale (ndryshimi në numër)

Në 2020, nuk ka patur ndryshim të numrit të çerdheve dhe kopshteve funksionale në krahasim me 2019 bazuar në informacionin nga pesë bashki raportuese, si Bashkia Librazhd, Bulqizë, Bashkia Mat, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Shijak.

145 Burim: SHSSH, Analiza Vjetore 2020

Treguesi: Numri i fëmijëve të shërbyer në kopshte dhe çerdhe (ndryshimi në numër 2020/2019)

Grafik 98: Ndryshimi i numrit të fëmijëve të shërbyer në kopshte dhe çerdhe, 2020/2019



Burim: Raportet e Performancës së Bashkive, 2020 (n=6)

Bashkia Bulqizë dhe Bashkia Lezhë ka raportuar numër më të vogël të fëmijëve të shërbyer në kopshte dhe çerdhe në vitin 2020 kundrejt 2019, ndërsa bashkitë e tjera kanë patur numër më të lartë fëmijësh.

Treguesi: Numri i fëmijëve pa përkujdes prindëror që kanë perfituar nga shërbimet e shërbimit social (ndryshimi i numrit në krahasim me vitin e mëparshëm)

Për treguesin e performancës ‘Ndryshimi i numrit të fëmijëve pa përkujdes prindëror që kanë perfituar nga shërbimet e shërbimit social (ndryshimi 2020/2019), pak bashki kanë raportuar të dhëna, si: Bashkia Elbasan (13 fëmijë përfitues më shumë), Bashkia Cërrik (10 fëmijë përfitues më shumë), Bashkia Lezhë dhe Bashkia Mat (pa ndryshim të numrit të fëmijëve 2020/2019). Në nivel kombëtar, në 2020 kanë perfituar 229 fëmijë pa përkujdes prindëror (ose 11 fëmijë më shumë kundrejt 2019)¹⁴⁶.

Shpenzimet e programit “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe PAK” – 10140


Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat që vijnë kryesisht nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale dhe transfertat e kushtëzuar (për qendra të trajtimit të PAK, që kanë kaluar në vartësi të bashkisë), ku përfshihet dhe fondi social. Ndërsa shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 4% krahasuar me v.2019.

Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute


Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 1%. Në Bashkinë Bulqizë programi zë përqindjen më të madhe (6% të totalit të buxhetit).



146 Raporti vjetor (SHSSH, 2021)

Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

53% e bashkive nuk kanë planifikuar fare buxhet për këtë program. Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit, mesatarisht 63%, ndërsa shpenzimet e tjera korente dhe investimet zënë përkatësisht 24% dhe 14% të shpenzimeve.



Shpenzimet e programit “Sigurimi Shoqëror” – 10220


Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat e veta të bashkisë për dhënien e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Për qendra rezidenciale për të moshuar, që i kanë kaluar bashkisë, shërbimi financohet edhe nga transfertat e kushtëzuar.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 9% krahasuar me v.2019.


Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 0.2%. Shumica e bashkive nuk shpenzojnë fonde për këtë kategori sociale, as për shërbime të vogla ditore.



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Vetëm 6 bashki ose 14% e tyre kanë planifikuar buxhet për këtë program. Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit, mesatarisht 54%, ndërsa shpenzimet e tjera korente dhe investimet zënë përkatësisht 45.5% dhe 0.5% të shpenzimeve totale.



Shpenzimet e programit “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” – 10430

Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat që vijnë nga transferta e kushtëzuar (pagesat kesh për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesat e paafësisë për personat PAK), transferta e pakushtëzuar sektoriale për qendrat e kujdesit që kanë kaluar në vartësi të bashkisë. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbuloohen nga të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë (ku përfshihen tarifat nga çerdhet, tarifat e personave që trajtohen në qendra dhe pagesat nga fondi rezervë i bashkisë për familjet jashtë skemës së trajtimit nga QQ si dhe ofrimi i shërbimit parashoqëror 72 orësh, sipas paketës ligjore).


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur mesatarisht me 28% krahasuar me v.2019.


Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 478,013 mijë lek ose 2% të totalit të buxhetit. Me përjashtim të bashkive të medha, ku ky program zë 4-6% të totalit, ndërsa për 50% e Bashkive, programi zë nga 0%-1%.

Grafik 100: Buxheti i programit “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, 2020



Shpenzimet e personelit kanë peshën më të rëndësishme të shpenzimeve të programit, mesatarisht 65%, ndërsa shpenzimet e tjera korente dhe investimet zënë përkatësisht 31% dhe 4% të shpenzimeve.




Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Për programin *Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara* vëmë re se, rreth **48%** (639 persona) është dakort me nivelin e aktual të financimit të këtij programi nga ana e bashkive të tyre, **37%** (497 persona) kërkojnë rritjen e shpenzimeve për këtë program, **9%** (124 persona) “nuk e di” dhe **5%** (72 persona) kërkojnë të ulen shpenzimet.


Bashkitë të cilat janë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve, nga përgjigjet e banorëve të tyre, janë: Puka me 70% (49 persona), Mati me 67% (104 persona), Shijaku me 55% (78 persona), Lezha me 55% (86 persona), Devolli me 47% (43 persona), Kurbini me 34% (17 persona) dhe Dibra me 42% (103 persona). Gjithashtu, shprehur në masën më të madhe të tyre pozitivisht lidhur me rritjen e shpenzimeve, janë bashkitë: Gramshi në masën 64% (58 persona), Librazhdi në masën 54% (7 persona) dhe Bulqiza në masën 48% (153 persona).

Grafiku 101: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara




Sa i takon vlerësimin të banorëve lidhur me performancën e këtij shërbimi, rezultatet e sondazhit tregojnë se, rreth **39%** (503 persona) kanë vlerësuar me ‘shumë mirë’, **29%** (375 persona) kanë vlerësim neutral, **23%** (295 persona) me ‘jo mirë’ dhe vetëm **8%** (104 persona) janë shprehur me “nuk e di”.

Grafiku 102: Mendimi i banorëve lidhur me performancën për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara



Kujdesi social (përkrahja sociale)

Grafik 103: Mendimi qytetar lidhur me shpenzimet për kujdesin/përkrahjen sociale, 2020



Rreth **56% e të anketuarve** (3,935 persona) shprehet se është dakort me nivelin e financimit nga ana e bashkive për këtë program të përkrahjes sociale, 24% (1,693 persona) është për rritje të nivelit të financimit nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa, një masë e vogël prej vetëm 11% e të anketuarve (770 persona) është për uljen e shpenzimeve.


Për pyetjen “Si e gjykoni performancën e këtij shërbimi të ofruar nga bashkia”, rreth **40%** (2374 individë) shprehën të kënaqur, **37% janë neutralë “nuk e di”**, dhe 14% janë të pakënaqur.

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Për programin *Kujdesi social për familjet dhe fëmijët*, rezultatet e sondazhit tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë së anketuar, **56%** (3,935 persona) shprehet se është dakort me nivelin e financimit nga ana e bashkive për këtë program. Po ashtu, rreth **24%** e popullsisë ose 1,693 persona shprehen për rritjen e nivelit të financimit, ndërsa, rreth **11%** e popullsisë (770) janë për uljen e shpenzimeve.

Nëse shqyrtojmë preferencat e secilës bashki, vihet re se bashkitë me numrin më të lartë të përgjigjeve për dakortësinë me nivelin aktual të financimit janë: Fushë Arrëzi në masën 90% (69 persona), Shkodra në masën 78% (119 persona) dhe Librazhdi në masën 77% (10 persona). Bashkitë me numrin më të lartë të banorëve të cilët janë dakort me rritjen e nivelit të financimit për këtë program janë: Durrësi në masën 73% (123 persona), Kavaja në masën 69% (60 persona) dhe Gramshi në masën 64% (58 persona).

Grafiku 104: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët




Pyetjes mbi performancën e këtij shërbimi, rreth 40% (2,374 persona) shprehen të kënaqur, ndërsa 14% (829 persona) janë të pakënaqur me shërbimin e ofruar. Megjithatë ajo që bie në sy është se, edhe kategoria ‘neutral’ është votuar nga rreth 37% e të të anketuarëve (2,156 persona).

Nivelin më të lartë të banorëve të kënaqur me cilësinë e këtij shërbimi e kanë bashkitë: Poliçan në masën 100% (2 persona), Malësia e Madhe me 90% (75 persona), Fushë Arrëzi me 79% (61 persona) dhe Vau i Dejës me 78% (67 persona), ndërsa bashkitë të cilat janë të pakënaqura me nivelin e performancës së këtij shërbimi, në masën më të madhe, janë: Peqini me 55% (6 persona), Durrësi me 52% (88 persona) dhe Libohova me 49% (21 persona). Ndër bashkitë të cilat në masën më të madhe të tyre paraqiten me qëndrim neutral sa i takon vlerësimit të performancës janë Belshi me 75% (3 persona), Gramshi me 65% (59 persona) dhe Kukësi me 51% (1007 persona); 9% e popullsisë (522 persona) paraqitet e painformuar ose nuk ka një mendim konkret lidhur me të.

Rezultatet e sondazhit flasin për një performancë të kënaqshme në ofrimin e këtij shërbimi nga ana e bashkisë. Megjithatë rol në interpretim luajnë edhe përgjigjet e kategorisë ‘neutral’ duke qënë se përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përgjigjeve.

Grafiku 105: Mendimi i banorëve për performancën e programit Kujdesi social për familjet dhe fëmijët



Gjetje dhe rekomandime

- Në 2020, progres është arritur në hartimin e standarteve të shërbimit të emergjencës së sigurt, standartet për ri-integrimin e viktimave të trafikimit, si dhe të shërbimit lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Ligj i ri për prokurimin publik (162/2020), kërkon rritjen e aftësive të bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile për prokurimin e shërbimeve sociale të parashikuar në një kapitull në ligj.
- Në vitin 2020, përsa i përket trajtimit të familjeve në nevojë me fondin deri në 6%, mesatarja vjetore e mbështetjes ka qënë 3700 familje (një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2019).

- Nga viti 2019 në 2020, numri i individëve që përfshihen në pagesën e aftësisë së kufizuar, është rritur me 2,887 persona.
- Nga kontrollet e Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK, lidhur me zbatimin e legjislacionit të pagesave të NE dhe pagesat e PAK, janë kontrolluar 134 njësi vendore në 2020, ku janë konstatuar 1275 raste në kundërshtim me legjislacionin dhe janë propozuar 109 masa, 22 masa administrative dhe 11 raste gjobe.
- Në 2020, nuk ka patur *ndryshim të numrit të çerdheve dhe kopshteve funksionale* në krahasim me 2019 në pesë bashki raportuese¹⁴⁷.
- *Në nivel kombëtar, në 2020 kanë përfutuar 229 fëmijë pa përkujdes prindëror* (ose 11 fëmijë më shumë kundrejt 2019).
- Rezultatet e sondazhit për programin ‘*përkrahja sociale*’, lidhur me pyetjen për nivelin e financimit nga ana e bashkive, rreth **56%** e të anketuarve (3,935 persona) shprehet se është dakort me nivelin e financimit, **24%** (1,693 persona) është për rritje të nivelit të financimit, ndërsa **11%** e të anketuarve (770 persona) është për uljen e shpenzimeve.
- Për pyetjen “Si e gjykoni performancën e këtij shërbimi të ofruar nga bashkia”, rreth **40%** (2374 individë) shprehën të kënaqur, **37%** janë “neutralë ose “nuk e di”, dhe **14%** janë të pakënaqur.
- Për programin *Kujdesi social për personat e sëmurë*, rreth **48%** kanë qënë dakort me nivelin e aktual të financimit, **37%** rekomandojnë rritjen e shpenzimeve për këtë program.
- Pyetjes mbi performancën e shërbimit *Kujdesi social për personat e sëmurë*, rreth **39%** kanë vlerësuar me ‘shumë mirë’, **29%** ‘neutral’, **23%** (295 persona) me ‘jo mirë’.
- Për programin *Kujdesi social për familjet dhe fëmijët*, rezultatet e sondazhit tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë së anketuar, **56%** shprehet se është dakort me nivelin e financimit nga ana e bashkive për këtë program, ndërsa **24%** janë për rritjen e nivelit të financimit, dhe **11%** janë për uljen e shpenzimeve.
- Rezultatet e sondazhit flasin për një performancë të kënaqshme në ofrimin e këtij shërbimi nga ana e bashkisë, por një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë qënë ‘neutral’ (**37%**); **40%** e të anketuarve ‘të kënaqur’, ndërsa **14%** ‘të pakënaqur’ me shërbimin e ofruar.

3.20 Shërbimi i punësimit

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm; Pagesa për grupe të shenjuara në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë; Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje; Trajnim profesional për personat pa punë ; Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Punësimi është funksion institucioneve të qeverisë qendrore, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe institucioneve të varësisë (12 Drejtori Rajonale dhe 24 zyra vendore të punësimit), Drejtori Rajonale të Formimit Profesional (10)¹⁴⁸ dhe Shkollat e Mesme të Arsimit Profesional, si edhe i NJVV të cilat hartojnë politika dhe programe për zhvillim ekonomik dhe për të rritur shanset dhe mundësitë e punësimit për të gjithë kategoritë e popullsisë dhe në mënyrë të veçantë për grupet në nevojë përfshirë pakicat rome dhe egjiptane. Politikat në fushën e punësimit përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi PV 2019-2022 “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt”, dhe Strategjia kombëtare

147 Në Bashkinë Librazhd, Bulqizë, Mat, Bashkinë Lezhë dhe Bashkinë Shijak.

148 Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Shkodër, Vlorë, Nr.1 Tiranë dhe Nr. 4 Tiranë dhe Qendra e Lëvizshme për Zonën Verilindore

për migracionin dhe PV 2019-2022.

Në 2020, është përmirësuar kuadri ligjor dhe rregullator (referuar Ligj nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”. Janë hartuar disa udhëzues¹⁴⁹ që përmirësojnë cilësinë e ofrimit të shërbimeve ndaj punëkërkuësve dhe punëdhënësve dhe është ngritur një Sistem Informatik i ri për Shërbimet e Punësimit.

Ndonëse në vitin 2019 pati rritje të punësimit me 2.4% kundrejt 2018, në vitin 2020 pati rënie e lidhur me situatën Covid-19. Ka pjesëmarrje të rritur të krahut të punës që ka nxitur rritjen e ofertës së punës, por popullsia në moshë pune vazhdon të ulët që nga 2015 për shkak të niveleve të ulta të lindshmërisë dhe migracionit¹⁵⁰. Shkalla e pa.pu. në 2020 për grupmoshën 15-29 ishte 20.9% ose 0.6 pikë përqind më e ulët kundrejt 2019. Hendeku midis niveleve të pjesëmarrjes së burrave dhe grave ishte 14.6% më i lartë për burrat; hendeku u ngushtua nga 0.7 pikë përqindje në 2020 kundrejt 2019 për grupmoshën 15+¹⁵¹.


Rezultatet e performancës së shërbimit

Për t'i orientuar anëtarët e familjeve në nevojë dhe të papunë (pa.pu) por në moshë aktive pune drejt tregut të punës, të cilët përfitojnë nga skema e NE, shërbimet e bashkive orientojnë individët e pa.pu. të regjistruhen në zyrat vendore të punësimit dhe formimit profesional (kërkesë për të qënë përfitues i NE). Në nivel kombëtar, për shkak të situatës Covid-19, në 2020, ka patur një ulje të numrit të anëtarëve të familjeve të NE të orientuar drejt punësimit, me 669 të punësuar dhe 153 drejt formimit profesional, krahasuar me vitin 2019; nga këta 1324 anëtarë të punësuar të familjeve të NE dhe 439 anëtarë janë orientuar drejt kursit të formimit profesional në 2020¹⁵².

Treguesi: Numri i personave të pa.pu. të mbështetur me asistencë sociale (NE) _ ndryshimi 2020/2019

Në 2020, mesatarisht është ofruar asistencë sociale për 120 individë të papunë nga 13 bashki të kampionit që kanë ofruar të dhëna të vlefshme. Bashkitë që kanë ofruar asistencë sociale për numër më të lartë individësh të papunë në 2020 kundrejt 2019 kanë qënë Bashkia Këlcyrë, Pukë dhe Shijak.

Grafik 106: Ndryshimi i numrit të personave (të papunë) të mbështetur me asistencë sociale (2020/2019)



Burim: Raportet e Performancës të Bashkive, 2020 (n=13)

149 AKPA: Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkuësit dhe punëkërkuësit e papunë

- Udhëzuesi i Këshillimit drejt Punësimit
- Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëdhënësin
- Udhëzuesi mbi procedurat për pajisjen me librezën e vullnetarizmit
- Udhëzuesi për Orientimin në Karrierë dhe Formim Profesional
- Udhëzuesi për plotësimin e vendit të lirë të punës
- Udhëzuesi mbi planifikimin e proceseve të punës
- Udhëzuesi i pagesës së papunësisë
- Udhëzuesi për marrëdhëniet e punës

150 Raporti i Progresit i KE për Shqipërinë

151 INSTAT: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës (2020)

152 Burim: AKPA; <http://www.shkp.gov.al/publikime-shkp/>

Mesatarisht, **fondi i shpenzuar për asistencë sociale për individ të papunë** në 2020 ishte 69,286 lekë për tetë (8) bashki¹⁵³, por ka ndryshim të treguesit kosto/individ në vit për bashki të ndryshme të cilat kanë ofruar të dhëna për treguesin: Bashkia Roskovec (201,402 lekë), Bashkia Tepelenë dhe Fushë Arrëz dhe Mallakastër nga 73,219 - 75,760 lekë/vit, ndërsa bashkitë Delvinë, Këlcyrë dhe Pukë (19,591 – 22,057).

Shpenzimet e programit “Papunësia, arsim dhe aftësim” – 10550

Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat e veta të bashkisë, sepse papunësia paguhet nga qeveria sipas nivelit të përcaktuar me ligj. Bashkia, nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtorinë Rajonale të Punësimit, përgatit dhe aftëson të papunët afatgjatë për punësim, ose të punësuarit për ruajtjen e vendit të punës.

Faktikisht rezultojnë se për këtë program, bashkitë nuk kanë struktura apo shpenzime për papunësinë, arsimin dhe aftësimin e të papunëve. Vetëm Bashkia Shijak ka një punonjës për këtë program, por pa aktivitete të tjera buxhetore.

Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Për programin *Papunësia, arsimit dhe aftësimi*, u mundësuan të dhëna vetëm për bashkinë Kurbin. Në sondazh, përgjigjet e marra nga banorët e kësaj bashkie, për këtë shërbim janë 50, nga të cilat **74%** (37 persona) shprehën se janë dakort *për rritjen e shpenzimeve*, **12%** (6 persona) janë dakort me *nivelin aktual të shpenzimeve* për këtë shërbim, **10%** (5 persona) “nuk e di” dhe vetëm **4%** (2 persona) kanë votuar për uljen e shpenzimeve.

Ndërsa, sa i takon mendimit të banorëve lidhur me performancën, rreth **68%** (34 persona) “të pakënaqur”, **22%** (11 persona) “neutral”, **8%** (4 persona) “të kënaqur” me cilësinë e ofruar të këtij shërbimi dhe **8%** (4 persona) janë përgjigjur me “nuk e di”.

Gjetje dhe rekomandime

- Në nivel kombëtar, për shkak të situatës Covid-19, në 2020, ka patur një ulje të numrit të anëtarëve të familjeve të NE të orientuar drejt punësimit.
- Në 2002, mesatarisht është ofruar asistencë sociale për 120 individë të papunë nga 13 bashki të kampionit.
- Mesatarisht, *fondi i shpenzuar për asistencë sociale për individ të papunë* në 2020 ishte 69,286 lekë për tetë (8) bashki¹⁵⁴.
- Për programin *Papunësia, arsimit dhe aftësimi*, rreth **74%** e të anketuarve (37 / nga 50 persona), janë dakort *për rritjen e shpenzimeve*, **12%** (6 persona) janë dakort me *nivelin aktual të shpenzimeve* për këtë shërbim, **10%** (5 persona) “nuk e di” dhe vetëm **4%** (2 persona) kanë votuar për uljen e shpenzimeve.
- Lidhur me performancën, **68%** “të pakënaqur”, **22%** “neutral”, **8%** (4 persona) “të kënaqur”.
- NJVV duhet të krijojë mekanizma efektivë konsultimi me bizneset dhe partnerët socialë për të siguruar transparencë dhe parashikueshmëri të masave mbështetëse dhe legjislacionit.
- Duhet të krijohen stimuj për bizneset dhe punonjësit në sektorin e ekonomisë informale për transferim në ekonominë formale.
- Përmirësimi cilësor i arsimit dhe aftësimin profesional për punësimin janë faktorë të rëndësishëm për punësimin dhe integrimin në tregun e punës të personave në nevojë dhe të papunë.

153 Për bashkitë Delvinë, Fushë Arrëz, Këlcyrë, Mallakastër, Patos, Pukë, Roskovec, Tepelenë

154 Për bashkitë Delvinë, Fushë Arrëz, Këlcyrë, Mallakastër, Patos, Pukë, Roskovec, Tepelenë

3.21 Strehimi Social

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore; Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë; Perfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;


Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Hartimi i politikave dhe strategjive të cilat synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës për shtresat në nevojë, përmes financimit të programeve sociale të strehimit, rritjen e aksesit në strehim të të rinjve dhe shtresës së mesme të shoqërisë, nxitjen e programeve të ripërtëritjes urbane dhe mirëmbajtjes së banesave, zhvillimin e mekanizmave financiar të strehimit dhe partneritetet midis sektorit shtetëror e atij privat bankar është funksion i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pjesë e objektivave të politikës është edhe përmirësimi i performancës së njësive të ngarkuara (NJVV) me zbatimin e këtyre politikave lidhur me efikasitetin dhe efektivitetin e fondeve dhe arritjen e grupeve të synuara.

Kuadri ligjor dhe i politikave përbëhet nga Ligj nr. 22/2018 “Për Strehimin social” dhe më shumë se 14 akte nën.ligjore, VKM dhe Udhëzime për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitim të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit dhe Strategjia e Strehimit Social (2016-2025). Ndërtimi dhe administrimi i banesave sociale për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, është shërbim i funksioneve të NJVV në fushën e shërbimeve sociale (Ligj 139/2015, neni 24, pika 2). Plotësimi i kuadrit ligjor për skemat e strehimit social, financimi në rritje për skemat e strehimit social (pëfshirë investime) janë dy aktivitete të PV 2020-2022 SNDQV (C1.10). Plotësimi me akte nën.ligjorë i ligjit për strehimin social është arritur rreth 90%¹⁵⁵.

Në vitin 2020, buxheti për programet e strehimit ishte rreth 1,6 miliard lekë, i ndarë në investime, subvencionim të interesave të kredive dhe bonus të qirasë.

Grafik 107: Fondet për strehimin për vitin 2020 (në milion lekë)



Burim: MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit¹⁵⁶

Në lidhje me zbatimin e ligjit “Për strehimin social”, romët dhe egjiptianët aktualisht po përfitojnë nga kuota prej 5% e parashikuar nga ligji; rreth 30% e përfituesve të projekteve të vitit 2019 ishin familjet rome dhe egjiptiane, ndërsa 19% e tyre ishin përfitues në lidhje me subvencionin e qirasë dhe programet e subvencionit me shumë fiksë. Qeveria ka miratuar Deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Proçesin e Zgjerimit të BE (Deklarata e Poznanit). Ka filluar hartëzimi i shtëpive rome.


¹⁵⁵ Raport i Monitorimit SNDQV, PV 2020-2022 (MB 2021)

¹⁵⁶ MFE, shkresa nr.2060, 30.01.2020

Rezultatet e performancës së shërbimit

Në vitin 2020, mesatarisht janë dhënë 14 pagesa më shumë për përfituesit e programeve të strehimit social (për bonus qiraje) nga NJVV, 62 individë (mesatarisht) në 2020 kundrejt 49 përfituesve (mesatarisht) në 2019.

Grafik 108: Numri i familjeve përfituese nga bonuset për qira të banesave sipas bashkive



Burim: Raportet e Performancës të Bashkive, 2020 (n=10)

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe strukturat e tyre (Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Shërbimit Social) kontribuojnë në zhvillimin e projekt-propozimeve/aplikimeve për fonde të qeverisë (fondi për strehimin social), dhe donacione nga projekte në përmirësimin e kushteve të banimit për kategoritë në nevojë dhe ndërtimin e banesave sociale dhe administrojnë pjesën e fondit për strehim social të dhënë nga qeveria.

Programi ka si burim financimi kryesisht të ardhurat e veta të bashkisë, sepse papunësia paguhet nga QQ sipas nivelit të përcaktuar me ligj. Bashkia, nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtorinë Rajonale të Punësimit, përgatit dhe aftëson të papunët afatgjatë për punësim, ose të punësuarit për ruajtjen e vendit të punës.

Faktikisht rezultojnë se për këtë program bashkitë nuk kanë struktura apo shpenzime për personat e pa.pu., dhe për aftësimin e të papunëve. Vetëm Bashkia Shijak ka një punonjës për këtë program, por pa aktivitete të tjera buxhetore.

Shpenzimet e programit “Strehimi social” – 10661

Programi ka si burim financimi kryesisht transfertën e kushtëzuar (subvencionim për personat në nevojë për sigurimin e një banese sociale) dhe të ardhurat e veta të bashkisë për rikonstruksion banesash apo trajtime të tjera sociale.


Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë rritur gati 2.5 herë më shumë krahasuar me v.2019, por u përket vetëm 10 bashkive ose 28% të bashkive të studimit.


Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë, shpenzimet e programit zënë mesatarisht 0.3%. Janë 72% e bashkive që nuk shpenzojnë për këtë program, bile rezultojnë dhe pa struktura organizative për këtë program.

Grafik 109: Buxheti i programit për strehimin social ndaj buxhetit të bashkisë, 2020



Shpenzimet e investimit zënë pjesën më të rëndësishme të programit, mesatarisht 67%.




Rezultatet e sondazhit me qytetarët (10661)

Për programin *Planifikim urban vendor (strehimi social)*, kemi të dhëna vetëm për 4 bashki. Konkretisht, për Dibër, Kurbin, Librazhd dhe Vau Dejës. Nga rezultatet, vihet re se rreth **39%** e të anketuarve (163 persona) kanë qënë *dakort me nivelin aktual të shpenzimeve* për këtë program, **33%** (139 persona) *kërkojnë rritjen e shpenzimeve*, **15%** (62 persona) *“nuk e di”* dhe **13%** (52 persona) *‘duhen ulur shpenzimet’*.

Bashkitë, që janë shprehur në masën më të madhe të tyre dakort me nivelin aktual të shpenzimeve, janë: Librazhdi me 46% (19 persona), Cërriku me 43% (6 persona) dhe Dibra me 42% (104 persona), ndërsa, dakort me mundësinë për rritjen e shpenzimeve për këtë program, paraqitet vetëm bashkia Vau Dejës me 48% (50 persona), ndërsa lidhur me mundësinë për uljen e shpenzimeve, vetëm banorët e bashkisë Kurbin kanë zgjedhur këtë opsion (52% e të anketuarve ose 26 persona).


Grafik 110: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin *Strehim social*



Lidhur me pyetjen mbi performancën e shërbimit, rezultatet e sondazhit tregojnë se, **36%** e të anketuarve (142 persona) vlerësojnë më ‘shumë mirë’, **33%** (131 persona) kanë përzgjedhur opsionin “neutral”, **26%** (102 persona) ‘jo mirë’ dhe **6%** (22 persona) kanë zgjedhur opsionin “nuk e di”.

Banorët e bashkisë Vau Dejës janë shprehur në shumicën e tyre me vlerësim maksimal për cilësinë e ofrimit të këtij shërbimi nga ana e bashkisë së tyre, në masën 64% (55 persona). Banorët e bashkisë Kurbin janë shprehur në shumicën e tyre me vlerësim jo të kënaqshëm për cilësinë e ofrimit të këtij shërbimi nga ana e bashkisë së tyre, në masën 36% (18 persona), ndërsa, banorët e bashkive Librazhd dhe Dibër janë shprehur në shumicën e tyre me vlerësim neutral për cilësinë e ofrimit të këtij shërbimi me përkatësisht, 46% (6 persona) dhe 37% (91 persona).

Grafiku 111: Mendimi i banorëve për performancën e programit Strehim social



Gjetje dhe rekomandime

- Në vitin 2020, mesatarisht, 62 individë kanë përfituar nga bonusi i qirasë kundrejt 49 përfituesve (mesatarisht) në 2019.
- Rreth 30% e përfituesve të projekteve të vitit 2019 ishin familje rome dhe egjiptiane, ndërsa 19% e tyre ishin përfitues në lidhje me subvencionin e qirasë dhe programet e subvencionit me shumë fiksë.
- Për programin *Planifikim urban vendor (strehimi social)*, rezultatet e sondazhit tregojnë se **39%** e të anketuarve janë *dakort me nivelin aktual të shpenzimeve* për këtë program, **33%** (139 persona) kërkojnë rritjen e shpenzimeve.
- Mbi performancën e shërbimit, **36%** e të anketuarve vlerësojnë me ‘shumë mirë’, **33%** “neutral”, **26%** ‘jo mirë’.
- Rekomandohen të shtohet Treguesi ‘Familje përfituese të strehimit social ndaj totalit të familjeve që plotësojnë kriteret (në %).
- Kanë munguar të dhënat e vlefshme për analizën financiare të shërbimit përkundrejt dy treguesve (totali i shpenzimeve buxhetore për programin kundrejt totali i të ardhurave (përfshirë të ardhurat e veta, QQ dhe donacione).
- Anticiganizmi dhe gjuha e urrejtjes mbeten çështje që duhet të trajtohen sistematikisht në Shqipëri brenda shoqërisë më të gjerë, organeve të barazisë dhe strukturave dhe sistemeve qeveritare¹⁵⁷.

3.22 Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Program buxhetor “Sport dhe Argëtim” përfshin: Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive; mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtari të sportive;

¹⁵⁷ Raport Progresi i KE për Shqipërinë (2020)

Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.); Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe ose konkures apo lojtarë individual.

Për programin buxhetor “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”, bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike; Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e të ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar; Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave; Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerts, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.); Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore; Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokale.

Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve, organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, dhe administrimi i institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve është pjesë e funksioneve të NJVV në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese (Ligj 139/2015, neni 25).

Ngritja e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor është pjesë e PV 2020-2022 të SNDQV. Raportohet se realizimi i investimeve në 2020 ishte në masën 84% (Ministria e Kulturës është institucioni kryesor përgjegjës).

Në kuadër të agjendës së integritit evropian dhe detyrimeve që rrjedhin nga kritëri III “Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit” (kapitulli 26 – arsimit dhe kultura), bëhet vlerësimi i progresit të NJVV në këtë fushë sipas dy nënfushave: 1. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale (3 tregues): Numri i shkeljeve dhe ndërtimeve të jashtëligjshme në zona pjesë të trashëgimisë kulturore të bashkisë në vitin e raportimit, numri i masave të ndërmarra ndaj këtyre shkeljeve, fondi i buxhetit vendor të miratuar për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të bashkisë (në % të buxhetit), dhe 2. Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë (2 tregues) - numri aktiviteteve kulturore për promovimin e kulturës së zonës, dhe fondi vendor për aktivitete kulturore në raport me buxhetin e bashkisë¹⁵⁸.


Rezultatet e performancës së shërbimit

Performanca e shërbimeve në fushën e kulturës dhe sporteve vlerësohet bazuar në disa tregues: (i) numri i shfaqjeve/evente (ndryshimi kundrejt vitit të mëparshëm), (ii) Të ardhura nga eventet sportive dhe argëtuese në mijë lekë (ndryshimi 2020/2019); (iii) shpenzime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe numri i institucioneve të trashëgimisë kulturore (iv) shpenzime për veprimtarinë sportive në mijë lekë / numrin e banorëve rezidentë.

¹⁵⁸ BpE (projekt IPA): Raporti Bashkitë në procesin e IE (2020)

Treguesi: Numri i eventeve të mbështetura me fondet e bashkisë (ndryshimi 2020/2019)

Grafik 112: Numri i eventeve të mbështetura me fondet e bashkisë, 2020



Burim: Raportet e Performancës të Bashkive, 2020 (n=24)

Në vitin 2020, për shkak të situatës Covid-19, **numri mesatar i shfaqjeve** (eventeve) argëtuese dhe sportive ishte më i vogël, **5 evente** mesatarisht kundrejt 11 eventeve në 2019, po ka patur bashki, të cilat kanë raportuar për organizimin e më shumë eventeve në 2020 krahasuar me vitin 2019.

Shpenzimet e programit “Sport dhe argëtim”, 08130


Burim fondesh për shpenzimet e këtij programi janë kryesisht të ardhurat e veta të bashkisë, ku përfshihen dhe të ardhurat nga biletat për ndjekjen e ndeshjeve sportive. Shpenzimet mbështesin strukturat për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.), mbështetjen për ekipet vendore në veprimtari të sportive, funksionim ose mbështetje për ambiente që përdoren për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje etj.).

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 11% krahasuar me v.2019.


Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Mesatarisht programi zë 2% ndaj totalit të shpenzimeve të bashkive, por ka bashki, ku programi zë deri 6% të shpenzimeve totale të bashkive, përkatësisht tek bashkitë Shijak, Pukë dhe Shkodër.



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Mesatarisht, rreth 57% të shpenzimeve të programit e zënë pagesat e personelit, investimet zënë mesatarisht 11% të shpenzimeve të programit; Vihet re që ka bashki ku pesha e investimeve është e konsiderueshme. Tek Bashkia Dropull investimet zënë 91% të shpenzimeve, ndërsa tek Bashkia Korçë zënë 42%.




Rezultatet e sondazhit me qytetarët

Për programin *Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore* vihet re se, **49%** (609 persona) ka qasje pozitive lidhur me rritjen e shpenzimeve për këtë program dhe po ashtu një pjesë e madhe e të anketuarve në masën **41%** (508 persona) shprehen dakort me nivelin aktual të shpenzimeve nga ana e bashkive për këtë program. Ndërsa, vetëm **4%** (54 persona) shprehen se duhet të ulen shpenzimet dhe **7%** (83 persona) me “nuk e di”.

Bashkitë të cilat janë shprehur në masën më të madhe të tyre pozitivisht lidhur me rritjen e shpenzimeve, janë: Gjirokastra me 70% (62 persona), Lushnja me 55% (95 persona), Durrësi me 54% (91 persona) dhe Fieri me 46% (269 persona). Gjithashtu, dakort me nivelin aktual të shpenzimeve janë bashkitë: Patos në masën 54% (63 persona), Berati në masën 47% (41 persona) dhe Korça në masën 41% (16 persona).


Grafiku 113: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin *Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore*



Sa i takon vlerësimit të banorëve lidhur me performancën e këtij shërbimi, rezultatet e sondazhit tregojnë se, **36%** e të anketuarve (449 persona) kanë mendim *neutral*, ndërsa **31%** (385 persona) kanë vlerësim ‘*shumë mirë*’ dhe **25%** (307 persona) janë të pakënaqur.

Bashkitë të cilat sipas këtij sondazhi paraqiten me mendim *neutral* për këtë shërbim janë: Korça me 44% (17 persona), Lushnja me 41% (70 persona) dhe Fieri me 39% (226 persona), ndërsa, performancën e këtij shërbimi e kanë votuar shumë mire në një masë të konsiderueshme Patosi me 46% (53 persona), Gjirokastra me 41% (36 persona) dhe Berati me 39% (34 persona).

Grafiku 114: Mendimi i banorëve për performancën e programit Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore



Gjetje dhe rekomandime

- Në 2020, **numri mesatar i shfaqjeve** (eventeve) argëtuese dhe sportive ishte më i vogël, **5 evente** mesatarisht kundrejt 11 eventeve në 2019, po ka patur bashki, të cilat kanë raportuar për organizimin e më shumë eventeve në 2020 (faktor ndikues ka qënë situata e pandemisë covid-19).
- Rezultatet e sondazhit për këtë program, tregojnë se **49%** e të anketuarve kanë patur qasje pozitive lidhur me rritjen e shpenzimeve, ndërsa **41%** shprehen dakort me nivelin aktual të shpenzimeve.
- Vlerësimi i banorëve lidhur me performancën e shërbimit kanë qënë **36%** e të anketuarve 'neutral', **31%** 'shumë mirë' dhe **25%** 'të pakënaqur'.
- Nuk ka patur të dhëna të vlefshme në raportet e performancës për të kryer një analizë financiare të fondit të alokuar dhe shpenzimeve për disa tregues, si: të ardhura nga eventet sportive dhe argëtuese (ndryshimi 2020/2019) dhe totali shpenzime për veprimtarinë sportive përkundrejt numrit të banorëve të bashkisë.
- Shpenzimet e programit për sport dhe argëtim janë ulur mesatarisht me 11% krahasuar me v.2019, dhe shpenzimet për programin e trashëgimisë kulturore janë ulur mesatarisht me 6% krahasuar me v.2019.

3.23 Programi Çështje Financiare dhe Fiskale

Bashkitë kanë bërë progres në administrimin e të ardhurave, por aftësia për të ofruar shërbime publike cilësore mbetet e limituar¹⁵⁹.

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet kryesisht: Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj. Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

Referenca ligjore dhe politikat sektoriale

Treguesit standard dhe krahasueshmeria me politikat strategjike dhe ligjet specifike

Tabela paraqet tekstin e standartit dhe treguesit bazuar në dokumentat strategjike, Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, Ligj bazë 139/2015, Ligj nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Ligj nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH".

¹⁵⁹ Raporti i progresit të KE për Shqipërinë, 2020

Çështje financiare dhe fiskale

Treguesit:

T1. Totali i të ardhurave minus shpenzimet totale (lekë në vit)

T1. Realizimi i të ardhurave të veta (ndryshimi në % ndaj vitit të kaluar)

Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore

Neni 34/6: NJVV-ja miraton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa defičit, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore

Sipas dokumentave strategjike

-Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave publike 2019-2022

Objektivi 3: Mbledhja e të ardhurave duke rritur efikasitetin në mbledhjen e tyre sipas burimeve dhe uljen e evazionit fiskal; Rritje e të ardhurave të veta

Objektivi 4: Ekzekutim efikas i buxhetit; Detyrime të prapambetura të minimizuara

Sipas ligjeve specifike

-Ligji 68/2017 Për financat e NJVV-së

Neni 2/4. Autonomi fiskale e NJVV-ve, nëpërmjet së drejtës për të vendosur e mbledhur taksa dhe tarifa vendore.

Gjendje normale financiare¹⁶⁰

Neni 55: Stoku i detyrimeve financiare ndaj shpenzimeve buxhetore të miratuara, dhe që janë në një afat nën 60 ditë kalendarike =15%

-Ligji 9936/2008 Për menaxhimin financiar

Neni 6: Buxheti vendor është i balancuar¹⁶¹ në termat e arkëtimeve dhe të pagesave.

Neni 29/d: MFE paraqet brenda datës 1 nëntor në kuvend detyrimet kontingjente të qeverisjes së përgjithshme dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës.

Të ardhurat e veta të bashkive

Burim i rëndësishëm për të mbeshtetur politikat vendore, pra realizimin e objektivave sipas programeve buxhetore, të përcaktuara saktësisht në buxhetin vjetor, të miratuar nga Këshilli i Bashkisë dhe të konfirmuar edhe nga qytetarët, janë të ardhurat e veta të bashkisë dhe burimet qendrore: transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme, sektoriale dhe transfertat e kushtëzuar.

Buxheti, në këndvështrimin e një konsensusi të NJVV-së për të paguar edhe më shumë, për një shërbim më cilësor, sjell detyrim kryesor dhe të rëndësishëm mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat dhe rritja çdo vit e tyre për të konkretizuar shërbime të qëndrueshme për qytetarët, por edhe për të mbeshtetur politika e standarde ligjore të detyrueshme mjedisore, sociale, etj.


Të ardhurat e realizuara në vlerë dhe krahasuar me vitin 2019 për çdo bashki

Aktualisht në vitin 2020 ka një ulje mesatare prej 16% të të ardhurave të veta të bashkive të studimit krahasuar me vitin 2019, e shpjeguar kjo me situatën e jashtëzakonshme të krijuar. Nga Bashkitë e studimit, me normë të lartë të rënies të të ardhurave të veta janë bashkitë Lezhë (-57%), Kamëz dhe Skrapar (-37%), Kurbin (-36%), Fushë Arrëz dhe Vau i Dejës (-32%), ndërsa me normën të lartë të rritjes janë Bashkitë Pukë (93%), Kukës (36%), Patos (33%).

160 Udhëzimi 26/2019 Proçedura për menaxhimin e vështirësive financiare për NJVV-të

161 Përfundimisht, buxheti vendor mund të ketë defičit vetëm për shpenzimet kapitale, të financuara me hua


Grafik 115: Ndryshimi i të ardhuravë vendore sipas bashkive (2020/2019)



Të ardhurat e realizuara nga tarifat ndaj totalit të të ardhurave të veta të bashkisë (në vlerë dhe në %)

Të ardhurat nga tarifat për bashkitë e studimit përbëjnë **43% të të ardhurave të veta të bashkisë**. Ka bashki ku këto të ardhura kanë peshë shumë më të lartë ndaj të ardhurave të veta edhe se mesatarja dhe kryesisht tek bashkitë Pukë (77%), Has (73%), Bulqiza (70%), Mallakastër, Vau i Dejës, Mat (60%). Pra ka një kujdesje nga Bashkitë për të mbuluar kostot e shërbimeve nëpërmjet tarifave.

Grafik 116: Të ardhurat nga tarifat ndaj totalit të të ardhurave (në %), 2020




Shpenzimet sipas programeve

Shpenzimet e realizuara në vitin 2020 nga bashkitë, janë financuar nga burime qendrore mesatarisht në masën 70% dhe nga të ardhurat e veta në masën 30%. Por, ka bashki të cilat financohen në masën më të vogël nga QQ, si bashkia Këlcyrë (17%), Shkodër 54%, Pukë 55%, Elbasan 56%. Bashkitë që kanë përqindje të lartë të financimit nga QQ janë Lezha (95%), Himara (93%), Libohova dhe Patosi (92%).

Punonjësit e bashkisë dhe pesha e shpenzimeve të tyre sipas programeve

Bazuar në numrin total të punonjësve të 32 bashkive, që kanë raportuar për vitin 2020 dhe fondeve në total të shpenzuara prej tyre (nga burimet vendore dhe qendrore), rezulton se mesatarisht 0.6 punonjës menaxhojnë gjatë vitit 1 milion lek. Mbi këtë mesatare është bashkia Klos (3.9 punonjës për 1 milion lek), bashkia Këlcyrë (3.6 punonjës për 1 milion lek), bashkia Libohovë (2.3 punonjës për 1 milion lek).



Pagesat e personelit zënë mesatarisht më shumë se 50% të totalit të shpenzimeve të bashkive (52%). Por, ka bashki, ku pagesat e personelit zënë peshë me të lartë ndaj totalit të shpenzimeve (kryesisht tek bashkia Këlcyrë (72%), bashkia Dibër dhe Memaliaj (71%), bashkia Skrapar dhe Tepelenë (70%).




Nëse i referohemi shpenzimeve të çdo programi, pesha e pagesave të personelit është në përqindje të lartë tek programet Ndërgjegjësimi mjedisor (100%), Shërbimet bujqësore (94%), Programi i mbrojtjes së mjedisit (92%), Çështjet financiare & fiskale dhe Shërbimet e policisë vendore (91%), Planifikimi urban (89%).



Për programin “Çështje financiare dhe fiskale”, nga rezultatet e sondazhit lidhur me shpenzimet, vihet re se, 43% e të anketuarve (176 persona) janë dakord me nivelin aktual të shpenzimeve, 25% (100 persona) kanë zgjedhur të përgjigjen me ‘nuk e di’, 18% kanë qënë të mendimit se shpenzimet duhen ulur dhe 15% kanë qënë të mendimit se duhet të shpenzohet më shumë.


Të gjitha bashkitë që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje në sondazh kanë qënë dakort me nivelin aktual të shpenzimeve dhe rezultatet janë si vijon: Bashkia Skrapar me 58% (21 persona), bashkia Mirditë me 56% (43 persona), bashkia Kavajë me 48% (42 persona), bashkia Durrës me 34% (57 persona) dhe bashkia Korçë me 33% (13 persona).

Grafiku 117: Mendimi i banorëve lidhur me shpenzimet për programin Çështje financiare dhe fiskale



Lidhur me pyetjen, si e vlerësojnë performancën e shërbimit, 34% e të anketuarve (134 persona) kanë qënë “neutral” ndërsa, 26% (105 persona) janë ‘të pakënaqur’, 25% (101 persona) janë përgjigjur me “nuk e di” dhe 14% (57 persona) janë ‘të kënaqur’.

Grafiku 118: Mendimi i banorëve për performancën e programit “Çështje financiare dhe fiskale”



3.24 Analiza buxhetore për shërbime të tjera

Shpenzimet “Programet e Mbrojtjes së mjedisit”, 05320

Bashkitë shpenzojnë kryesisht për aktivitete që kënë të bëjnë me mbrojtjen e ajrit dhe e klimës, mbrojtjen e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimin e zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtjen ndaj rrezatimeve, por edhe për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes dhe edukimin e publikut.


Vetëm 4 bashki raportojnë shpenzime në këtë program, pra vetëm 11% e tyre.

Shpenzimet e programit të vitit 2020 ndaj shpenzimeve të vitit 2019 (në %)

Shpenzimet e programit janë ulur mesatarisht me 30% krahasuar me v.2019.


Shpenzimet e programit, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve të bashkisë dhe si vlerë absolute

Mesatarisht ky program zë vetëm 0.1% të shpenzimeve të bashkive që raportojnë.



Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet operative & të tjera dhe Investimet (pesha brenda programit)

Peshë e dukshme në program janë shpenzimet e personelit, mesatarisht zënë 92% të shpenzimeve të programit.



Shpenzimet e programit “Ndërgjegjësimi mjedisor”, 05630

Programi duhet të raportojë shpenzime për aktivitete që kanë të bëjnë promovimin e mbrojtjes mjedisore, përhapjen e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e publikut.

Programi nuk ka raportim shpenzimesh nga bashkitë, me përjashtim të bashkisë Korçë që paguan personel, por nuk ka shpenzime për aktivitete të tjera.

Shpenzimet e programit “Shërbimet e kujdesit parësor”, 07220

Shërbimi i kujdesit parësor është një shërbim i ndarë midis QQ/ Ministrisë së Shëndetësisë dhe Bashkive. QQ finanon personelin shëndetësor dhe pajisjet mjekësore, ndërkohë që bashkia është përgjegjëse për ndërtimin e qendrave dhe mirëmbajtjen e tyre. Të pakta janë bashkitë që financojnë për këtë shërbim.

Kanë raportuar për këtë program vetëm 4 bashki ose 11% e bashkive. Pra, bashkitë akoma nuk kanë kompetenca të transferuara për këtë shërbim, pra nuk e shikojnë si prioritet të tyre. Bashkitë që raportojnë shpenzime nga të ardhurat e tyre janë Elbasan, Dibër, Shkodër dhe Vau i Dejës. Vihet re një rritje me 90% e shpenzimeve për vitin 2020 për këtë program, por me destinacion rritjen e pagave të personelit, të cilat zënë 67% të shpenzimeve të programit.

4. Gjetje dhe Rekomandime të Përgjithshme

Treguesit dhe të dhënat

- i. Performanca e NJVV në ofrimin e shërbimeve publike nga NJVV, bazuar në analizën e treguesve të shërbimeve publike, është përmirësuar për një numër të konsiderueshëm të shërbimeve. Për më shumë shiko përmbledhjen ekzekutive.
- ii. Progres është bërë nga Bashkitë në hartimin e raporteve të performancës për shërbime të ofruara gjatë 2020 sipas fushave dhe funksioneve të vetëqeverisjes vendore. 36 bashki (59%) kanë hartuar raportet e performancës, ndërsa 100% e bashkive kanë hartuar/dhe dorëzuar në MFE raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit sipas formatit të kërkuar. Në hartimin e këtij raporti sintezë, u konstatua që bashkitë nuk kanë plotësuar në shkallë të plotë të dhënat për treguesit e performancës për vitin 2020; ka mungesa të përshkrimit narrativ dhe problematika apo sfida të bashkive në ushtrimin e funksioneve të vetëqeverisjes vendore.
- iii. Treguesit e programit administrim dhe menaxhim dhe të lidhur me burimet njerëzore të ndonjë funksioni tjetër (p.sh. administrimi dhe menaxhimi i pyjeve, etj), nuk janë raportuar të ndara sipas gjinisë (F/M). Rekomandohet ndarja (F/M) në RP për vitin tjetër të raportimit.
- iv. Ka nevojë të rishikohen disa tregues dhe përshkrimi i tyre /dhe osë të shtohen disa tregues të tjerë kuptimplotë për të vlerësuar performancën e disa shërbimeve, mbi bazën e një procesi konsultimi me ekspertë të fushës dhe shërbimet e bashkive.
- v. Funksion i NJVV në fushën e mbrojtjes së mjedisit (ligj 139/2015), neni 26, nuk është pjesë e raportit të performancës. Përgjegjësitë e bashkive në këtë fushë lidhen me (i) sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, (ii) sigurimin e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, dhe (iii) zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, e njejta mungesë vihet re për disa programe të tjera si arsimi i mesëm profesional, grante për rindërtim dhe strehim (kur është relevante), grante për rindërtim mbas tërmetit, menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimet.
- vi. Mund të konsiderohet shtimi i disa treguesve të performancës lidhur me shërbimet e lartpërmendura që nuk mbulohen në këtë raport për vitin 2020.

Çështje të kapaciteteve institucionale


- i. Mungesa e një strukture të posaçme në bashki për monitorimin e performancës së shërbimeve bazuar në një sistem të unifikuar të treguesve veshtirëson hartimin në kohë dhe me cilësi të raporteve të performancës, veçanërisht për bashki që kanë burime njerëzore dhe teknike të kufizuara.
- ii. Sektori i statistikës, në disa bashki është pjesë e drejtorisë së shërbimeve sociale, por në disa bashki është në varësi të strukturave të tjera (nuk ekziston një model i njëjtë).
- iii. Mosplotësimi në nivel të plotë i treguesve të performancës, evidenton mungesë të mekanizmave të koordinimit institucional në drejtim të rregjistrimit dhe raportimit të të dhënave për të gjithë treguesit e performancës të shërbimeve. Në disa bashki funksionojnë grupe teknike ndërsektoriale të cilat duhet të koordinojnë punën për raportimin mbi performancën dhe hartimin e RP.
- iv. Më shumë vëmendje për krijimin e një database (sistemi të standartizuar të treguesve) të bashkive të cilat do të mundësonin funksionimin e platformës së qëndrueshme të monitorimit dhe raportimit për të analizuar performancën e shërbimeve sipas fushave përkatëse dhe përkundrejt zbatimit të planeve vendorë të zhvillimit dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i politikave sektoriale, SNDQV PV 2020-2022 (A3.2)

dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

- v. Është kryer një vlerësim për ngritjen e një sistemi të unifikuar për mbledhjen periodike të info nga NJVV dhe për zbatimin e sistemit IPSIS në nivel vendor për 6 dimensione, midis të cilave ofrimi i shërbimeve publike, menaxhimi financiar, aftësitë dhe kapacitetet e administratës vendore, transparenca dhe llogaridhënia¹⁶².
- vi. Nuk ka patur progres në zbatimin e aktivitetit “Hartimi i formateve standarte për raportimin e info për zbatimin e politikave nga NJVV tek ML dhe institucionet qendrore mbi bazën e një sistemi unik të mbledhjes së të dhënave (treguesve të performancës)” për funksione dhe shërbime të NJVV të përcaktuara në ligj (PV 2020-2022, SNDQV A.3.2). Vëmendje e shtuar nga institucionet qendrore dhe AMVV për krijimin e instrumentëve të nevojshëm në drejtim të ngritjes së kapaciteteve monitoruese dhe raportuese të NJVV.
- vii. Kërkohej rritje e vëmendjes së autoriteteve të NJVV (Kryetarit të Bashkisë dhe KB) për përgatitjen cilësore të të dhënave për treguesit e performancës, si dhe sigurimi i raportimit brenda afateve të përcaktuara, që buron nga përgjegjshmëria e autoriteteve vendore dhe administratës publike vendore mbi përdorimin efikas të burimeve publike ndaj qytetarëve (menaxhimi i të gjitha burimeve bazuar në rezultate).
- viii. Përsa kohë, NJVV nuk kanë krijuar strukturën për monitorimin e performancës, duhet të ngarkojnë institucionalisht nëpunësin kryesor përgjegjës mbi raportin e performancës dhe të përmirësojnë koordinimin institucional me strukturat e bashkisë dhe institucionet e tjera në nivel vendor (zyrat vendore të punësimit, formimit profesional, etj) me qëllim lehtësimin e mbledhjes së të dhënave dhe hartimin e raporteve të performancës në ekzekutimin e buxhetit;
- ix. Vijueshmëri në ofrimin e mbështetjes me asistencë teknike për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve vendorë në mbledhjen dhe përgatitjen e raporteve të performancës nga të gjitha bashkitë e vendit; koordinimi me ASPA për mundësi për trajnime dhe mbështetje nga projekte me financim nga agjenci donatore për zhvillim të aftësive të administratës vendore.

Gjetje dhe rekomandime për analizën buxhetore

Analiza sipas programeve buxhetore të mësipërme konsiderohet e vështirë dhe nuk ka saktësi të lartë në krahasueshmëri, sepse jemi në situatën që bashkitë nuk respektojnë përfshirjen në program të shpenzimeve të atyre aktiviteteve që kërkon udhëzimi standard i përgatitjes dhe raportimit të buxhetit, sipas pershkrimit standard të tyre. Pra, është domosdoshmëri buxhetimi mbi bazë aktiviteti të çdo programi dhe llogaritja e kostos për çdo produkt apo rezultat të arritur. Kjo mënyrë buxhetimi dhe raportimi do të rezultojë në krahasueshmërinë e shpenzimeve edhe mbi bazë programi dhe efijçence, sipas skemës së mëposhtme.



¹⁶² Burim: Raporti i Monitorimit SNDQV (MB 2021), me mbështetje të projektit STAR 2

- i. Analiza e shpenzimeve sipas programeve kërkon nga bashkitë përfshirjen në programin e duhur të të gjitha kostove që lidhen me produktet që prodhon programi.** Për një krahasueshmëri të besueshme dhe korekte brenda programit, midis programeve dhe ndërmjet bashkive nevojitet ndarja e kostove të përbashketa dhe vendosja e shpenzimeve në programin përkatës. Pra, pavaresisht nga forma se si bashkia e ofron shërbimin (me njësi shpenzuese që menaxhon më shumë se një program, apo me kontraktim që përfshin më shumë se dy programe buxhetore), raportimi kërkon evidentimin e shpenzimit në programin e duhur.
- ii. Llogaritja e treguesit të efikasitetit për produktet e realizuara apo rezultatit e arritur, si detyrim ligjor.** Bashkitë, bazuar në përshkrimin e aktiviteteve sipas ligjit për procedurat standart të përgatitjes së buxhetit, duhet të evidentojnë kostot mbi bazë aktivitetesh për nivelin e shërbimit të ofruar dhe produktet specifike që prodhohen, që të mund të rritet besimi në krahasueshmëri brenda shërbimit dhe midis bashkive.
- iii. Mbajtja në mënyrë të diferencuar e të ardhurave nga tarifatat sipas shërbimeve** për të cilat janë vendosur, për të analizuar shpenzimet neto të shërbimit që mbulohehen nga të ardhurat e tjera të bashkisë si dhe mbulimin e kostos nga këto të ardhura sipas shërbimeve.
- iv. Analiza vjetore e performancës së buxhetit të programit, duhet të përfshijë të gjitha burimet e financimit të programit, bile edhe ato jashtë llogarisë së Thesarit.** Zakonisht raportet e bashkive përfshijnë vetëm shpenzimet nga burimet e veta, transfertat e pakushtëzuar dhe transfertën sektoriale/specifike. Shpenzimet nga burimet e tjera të kushtëzuara, FZHR apo donatorët trajtohen jashtë programit buxhetor, ose në disa raste ky raportim mungon. Standard për raportim mbi bazë programi buxhetor duhet të jetë akti i rakordimit me Degën e Thesarit, por kjo e fundit disa shpenzime për bashkitë i mban në kode buxhetore të veçanta, jashtë kodifikimit të 36 programeve.
- v. Instrumenti i Planifikimit Financiar (IPF), në kuadrin e informacionit financiar që prodhon, ka nevojë për shtesa të elementeve të tjerë lehtësues për bashkitë,** që të ndihmojë edhe për llogaritjen/planifikimin dhe raportimin e kostove mbi bazë aktiviteti për çdo program buxhetor, për evidentimin edhe të treguesve të efikasitetit për produktet apo rezultatet e arritura brenda programit.

5. Bibliografi dhe raporte burimore

Raportet e Performancës nga Bashkitë (v.2020)

<http://bashkitëforta.al/monitorimi-i-performancës-së-bashkive-publikime/>

Raporti mbi Financat Vendore (MFE, 2021)

Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (MFE, dhjetor 2020)

<https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/raport-monitorimi-shqip>

Rezultatet e sondazhit mbi kënaqësinë e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve nga bashkitë (BtF, Hevetas-projekt i financuar nga SDC, 2021)

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II (2015-2020)

Strategjia Ndërsektorale për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Vendore (SNDQV), PV 2020-2022

Raporti i Monitorimit të SNDQV (MB, 2021)

Strategjia Ndërsektorale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020, PV 2019-2022

Raporti i Monitorimit të Departamentit të Administratës Publike (2021)

Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitare 2015-2020

Raporti i Monitorimit (MAS, 2021)

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale PV 2019-2022

Raporti i Monitorimit të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH, 2021)

Raporti i Monitorimit (MBZHR, 2021)

Strategjia Kombëtare për MIM, PKVMIM (2019-2030)

Strategjia e Edukimit Ligjor për Publikun (ELP), PV 2020-2023

Strategjia Kombëtare për Eficiencën e Energjisë (SKEE)

Raportit të Performancës së Funksioneve të tranferuara në NJVV (dldp, Helvetas -projekt i financuar nga SDC , O.Shapo, 2018)

INSTAT

<http://www.instat.gov.al/al/statistika/>

Raport “buletini mujor statistikor” për turizmin (MTM, 2021)

Raport i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Raporti i Monitorimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE, 2021)

<https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Relacion-Monitorimi-MIE-2020.pdf>

Raporti i Progresit për Shqipërinë të Komisionit Evropian (2020)

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin e pakicave romë dhe egjiptiane (MSHMS, UNDP, CoE, 2021)

Raporti Vjetor i Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA, 2021)

<http://www.shkp.gov.al/publikime-shkp/>

Raporti vjetor ERRU (2021)

Raporti i Performancës së Bashkive në prçesin e IE – (BpE) një projekt i financuar nga IPA (BE), 2020

Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore (URI, 2019 - projekt i financuar nga IPA)

SIGMA/OECD: Principet e Administratës Publike

